Agjencia për Zbatimin e Gjuhës e RMV-së

Përmbledhje e kumtesave të konferencës shkencore

SFIDAT E PËRKTHIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mbajtur më 30.9.2019 -

Dita Ndërkombëtare e Përkthimit

Shkup, 2020

Organizuar nga:

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës e RMV-së

www.apj.gov.mk

www.azgj.gov.mk

Botuesi:
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës në RMV
www.apj.gov.mk
www.azgj.gov.mk

Editor:
Prof. dr. Ylber Sela, drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës në RMV

Dizajni:
Ariton Spahiu

Shtypi:
GRAFO PROM SHPKNJP - Manastir

Këshilli organizues:

Ylber Sela
Nerxhivane Kuqi
Llazo Matovski
Lirim Shabani
Ariton Spahiu

Këshilli shkencor:

Xhevat Lloshi
Rami Memushaj
Emil Lafe
Qemal Murati
Izer Maksuti
Asllan Hamiti
Haki Ymeri
Ajten Hajdari - Qamili
Zeqiria Ibrahimi
Berton Sulejmani
Mustafa Ibrahimi
Liljana Pandeva

Këshilli botues:

Ahmet Selmani
Arsim Jonuzi
Nebi Bilalli
Shpresa Zeqiri - Ibrahimi
Renata Ballanca - Asani
Teuta Hiseni

PËRMBAJTJA

Ajten HAJDARI – QAMILI

ZBATIMI I SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONINË E VERIUT

Izer MAKSUTI

ME RASTIN E SHËNIMIT TË DITËS NDËRKOMBËTARE TË PËRKTHIMIT

Qemal MURATI

GJEDHE TË ZVETËNIMIT GJUHËSOR TË SHQIPES NË PËRKTHIM

Demush Bajrami

MEDIAT SOCIALE SI NXITJE TË REJA NË PERCEPTIMIN E DIVERSITETIT GJUHËSOR DHE KULTUROR

Asllan Hamiti

SFIDAT E PËRKTHIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Zeqirija IBRAHIMI

PROBLEMET E PËRDORIMIT ZYRTAR TË SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONI

Berton SULEJMANI

GJUHA E MBISHKRIMEVE PRIVATE E PUBLIKE SOT

Mustafa IBRAHIMI

PËRKTHIMI I DISA FRAZEMAVE MIDIS GJUHËS SHQIPE DHE MAQEDONASE

FJALA HYRËSE

Dita Ndërkombëtare e Përkthimit ka nisur të festohet nga Federata Ndërkombëtare e Përkthimit, që nga viti 1953 dhe festohet çdo vit më 30 shtator nën emrin e Shën Jeronimit, përkthyesit të parë të Biblës, mbrojtësi i përkthyesve.

Në vitin 1991 Federata lansoi idenë e njohjes ndërkombëtare të ditës së përkthimit për të shprehur solidaritet të komunitetit mbarëbotëror të përkthimit, si një përpjekje për të promovuar përkthimin profesional në vende të ndryshme, duke mos u kufizuar vetëm në ato të krishtera. Kjo është një mundësi për të shfaqur krenarinë për këtë profesion, që njëherësh është duke u bërë gjithnjë e më i domosdoshëm në fushën e përparimit global.

Në kuadër të kësaj dite, Agjencia për Zbatimin e Gjuhës do t'i bashkohet këtë vit festimeve duke organizuar Konferencën Shkencore "Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut", ku profesorët panelistë do të trajtojnë e diskutojnë për përkthimet dhe sfidat e përkthimit. Kjo konferencë, përveç tjerash do të shërbejë si një akt nderimi ndaj përkthyesve, kontributit të tyre në komunikimin ndërkulturor, si dhe do të promovojë emrat e rinj në zejen e përkthimit, si një art krijues.

Meqë disa nga misionet e Agjencisë janë: trajnimi i përkthyesve dhe lektorëve aktualë nëpër të gjitha institucionet e vendit, bërja e politikave gjuhësore dhe unifikimi i terminologjisë administrative në bashkëpunim me ekspertë të fushës dhe institucione gjegjëse brenda dhe jashtë vendit, sigurimi dhe furnizimi me fjalë dhe shprehje softuerin e përkthimit për institucionet qendrore etj., përmes kësaj konference në një mënyrë do të promovojmë çështjet aktuale të sfidave të përkthimit me të cilat ballafaqohen përkthyesit në Republikën së Maqedonisë së Veriut.

Duke u marrë konkretisht me detyrat e Agjencisë, çdo ditë hasim probleme dhe mangësi të shumta në terren, si p.sh.: mungesa e terminologjisë së unifikuar të shqipes administrative në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë së Veriut e gjetiu, për shkak se ka laramani termash varësisht nga ndërndikimet gjuhësore në secilin shtet ndryshe, për këtë arsye na nevojiten edhe bashkëpunime me ekspertë të jashtëm, me të cilët do të sillen vendimet e termave diskutabile në konferencat vijuese.

Jemi të vetëdijshëm se kemi shumë punë për të bërë dhe se ky është vetëm fillimi, e dimë shumë mirë se do të ballafaqohemi me sfida shumë të mëdha, meqë edhe deri tash kemi pasur shumë vështirësi, por aspiratat tona dhe vullneti ynë është i madh dhe shpresojmë se do t'i arrijmë qëllimet që ia kemi vënë para vetes si Agjenci dhe si shoqëri përparimtare.

Dr. Ylber SELA

Drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës

Ajten HAJDARI - QAMILI[1]

ZBATIMI I SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONINË E VERIUT

Përkthimi është një veprimtari komplekse dhe delikate që kërkon përkushtim dhe inteligjencë. Ai nuk është thjesht përcjellja e një teksti nga një gjuhë në tjetër, sepse procesi lidhet me një sërë kriteresh e sfidash që kanë të bëjnë me kuptimin e tekstit origjinal, meqë është shkencë më vete që mban lidhje me gjuhësinë, psikologjinë, leksikologjinë dhe leksikografinë; dhe njëkohësisht është teknikë që mban lidhje me gramatikën, stilistikën dhe artin e të shkruarit. Gjatë përkthimit duhet të merren parasysh edhe kuptimet e palogjikshme të përfshira në përmbajtje, rregullat gramatikore të të dy gjuhëve, traditat e tyre gjatë shkrimit dhe idiomat. Është gabim nëse mendohet se ekziston përshtatshmëri nga fjala në fjalë ndërmjet dy gjuhëve dhe se përkthimi është një proces i thjeshtë mekanik, sepse një përkthim i tillë nuk mund ta marrë parasysh përmbajtjen, gramatikën, kuptimet e palogjikshme, idiomat etj.

Përkthyes duhet të jenë persona që i njohin shumë mirë gjuhën në të cilën përkthejnë dhe gjuhën nga e cila përkthejnë, të kenë përvojë specifike dhe të njohin kulturat e të dy gjuhëve dhe të kenë kulturë të gjerë të përgjithshme. Përkthyesi duhet të sjellë diçka të re duke kërkuar mënyrën më të mirë për të shprehur idetë që konceptojnë, duhet të jetë i njoftuar me zhargonin e përkthimit, teknikat, me teoritë fundamentale bazike, me terminologjinë e fushës përkatëse dhe me shprehjet frazeologjike.

Në këtë kumtesë do të përpiqemi vetëm të japim një pasqyrë të shkurtër mbi nivelin gjuhësor të mbishkrimeve, reklamave, fletëpalosjeve, librave shkollore dhe artikujve të ndryshëm të përkthyer në shqip në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse kjo, në pamje të parë, lë përshtypjen sikur është diçka shumë e lehtë dhe mund ta përkthejë çdokush, nga analiza në vijim do të dëshmohet e kundërta. Kështu që, do të vërehet shumë qartë se sa janë të kualifikuar këta "përkthyes". Gjatë përkthimeve, shqipes nuk i kushtohet kujdesi i merituar, sepse po bëhen

[1] Prof. dr. Ajten Hajdari – Qamili, mësimdhënëse në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare.

punët shkel e shko, vetëm sa për të thënë që zbatohet Ligji për zbatimin e gjuhëve, kurse në të vërtetë po shkaktohet një dukuri që e shtrembëron dhe e sakaton shqipen plotësisht. Prandaj, lirisht mund të themi se niveli i përkthimit është i ulët, sepse niveli i njohjes së shqipes standarde nga "përkthyesit" është i ulët, qofshin ata shqiptarë apo joshqiptarë.


Do të rrekem të pasqyroj me pak fjalë sa më shkurt e qartë përsiatjen time për këtë plagë në Maqedoninë e Veriut. Natyrisht, në një paraqitje si kjo nuk mund të trajtohen të gjitha shmangiet nga shkrimi dhe shqiptimi i drejtë, meqë kjo kërkon një vëzhgim shumëdimensional dhe hapësirë më të madhe për ta mbarështuar. Por në pika të shkurtra le të përpiqemi t'i cekim disa prej tyre. Më duhet ta theksoj se kjo kumtesë është një sintezë e disa studimeve të mia të mëparshme në sfera të veçanta, prandaj si mbështetje për këtë studim kam një mori artikujsh, mbishkrimesh, dokumente, libra shkollore etj., të cilët i kam grumbulluar në terren për një periudhë jo të shkurtër, disa prej të cilëve po i dëshmoj me fotografi në vijim. Nga këto fotografi mund të shihet qartë se sa të shumta janë gabimet, se janë në të gjitha format dhe mënyrat e mundshme dhe në të gjitha rrafshet (në atë fonetik, morfologjik, leksikor, sintaksor, logjik, teknik etj.). Gabimet që kam paraqitur në këtë kumtesë, janë vetëm një përqindje e vogël e krejt asaj që mund të haset në terren, sepse nëse i pasqyroja të gjitha fotografitë që kam mbledhur, kumtesa do të ngjasonte në një album të trashë me fotografi. Për shkaqe etike jam përpjekur që firmat e artikujve t'i heq nga fotografitë.






Fotografia nr. 1 Fotografia nr. 2

Në fotografinë e parë i tërë teksti i këtij artikulli ka një grumbull gabimesh, megjithatë ne do të veçojmë vetëm këto: *Supë pulë e kthjellt (dehidruse)* = në vend që të ishte: supë e kthjellët pule (e dehidruar), nga: кокошкина бистра супа со тестенини (дехидрирана); *zihet në zjarre te qetë 5 minuta Tue perzir koh me kohë* = në vend që të ishte: zihet në zjarr të qetë për 5 minuta (brenda 5 minutash), duke e përzier kohë pas kohe; Në fotografinë e dytë dhe të tretë po veçojmë gabimet: *Mund të përmbajnë gjurmë, të gluten soje dhe arrë produkteve* = në vend që të ishte: Mund të përmbajë gjurmë të glutenit, sojës dhe frutave me thelb; *Shitore në një cool, vend të thatë* = në vend që të ishte: Të ruhet në vend të ftohtë dhe të thatë;





Fotografia nr. 4 Fotografia nr. 3

Në artikujt në vijim, përpos gabimeve drejtshkrimore, leksikore dhe teknike, kemi përkthime të fjalëpërfjalshme dhe të palogjikshme, që me shumë siguri i ka bërë ndonjë mosnjohës i shqipes, sepse asnjë shqipfolës nuk do t'i kishte përkthyer këto togfjalësha apo fjali në këtë mënyrë, p.sh.: *soka frute* (për: lëngje frutash), *pluhur per huher* (për: pluhur hudhre ose dromca hudhre)*, ajvar zemëruar* (për: ajvar djegës, nga: лут ајвар, sepse fjala 'лут' në maqedonisht ka kuptimin edhe djegës edhe i zemëruar); *Pasta për dhëmbë ka efekt profilaktik në gojën e*

zgavërt (për: pasta e dhëmbëve bën efekt profilaktik në zgavrën e gojës); *therur perimet* (për: perime të thata / të terura / të thara) nga: *Suşeno povrće; karota* (për: karrota), *gepë* (për: qepë), *prodhimi e përmban* (për: prodhimi përmban), *geses* (për: qeses), *soje albumina* (për: albumina prej soje ose albumina të sojës), *të rruhet në frigorifer* (për: të ruhet në frigorifer), *paqetimit* (për: paketimit), *me fruta boronice të kuge* (për: me fruta boronice të kuqe), *pojačivači arome = aromatizues arome* (për: përforcues arome ose aromatizues), *therur gjeth magdanozi* (për: gjeth i thatë / i terur majdanozi); *Përmbajtje: Dromcat e misrit, vaj dimorë* (për: Përmbajtja: dromca misri, vaj bimor); *Ngjura e flokëve ju lejon të e ndritoni ose errësoni ngjyrën e flokëve juaj dhe do të pranoni* (për: Ngjyra e flokëve ju mundëson t'i bëni flokët tuaja më të ndritura ose më të errëta); *Nëse përdorni këtë ngjyrë, do të pranoni: ngjyrë të ndritshme dhe bëgatshme cila konvenon zgjidhen juaj* (për: Nëse e përdorni këtë ngjyrë, do të fitoni ngjyrë të ndritshme dhe të plotë e cila i përshtatet zgjidhjes suaj, nga: ќе добиете: светла и длабока боја која одговара на вашиот избор), *yndirës* (për: yndyrës), *gjatë tërrë ditës* (për: gjatë tërë ditës), *terapija* (për: terapia), *biskuit i butë zhele portokalli e mbshtjellur me çokolladë* (biskotë e butë me zhelatinë portokalli e mbështjellur me çokollatë), *mielle gruri* (për: miell gruri), *përbrje* (për: përbërje), *gjalp* (për: gjalpë), *përmbanë* (për: përmban), *pjer kur do të çhelet* (për: prej kur do të çelet / hapet), *veze* (për: vezë), *soya* (për: soja), *mundë* (për: mund), *futeni robat e bardha dhe lereni te lahen per nje kohe prej 30 minuti pastaj shperlajeni... dhe vazhodhet... rrobat e tuaja* (për: fusni rrobat e bardha dhe lini të lahen për një kohë prej 30 minutash, pastaj shpëlani / shpërlani...dhe vazhdohet...rrobat tuaja) etj.




Fotografia nr. 5




Fotografia nr. 6




Fotografia nr. 7



Fotografia nr. 8



Fotografia nr. 9




производ: зејтин

(македонски) 100% растително масло се произведува во нашата мелница од одбрани растителни семиња.Секоја испорака се контролира и затоа ние гарантираме најдобар квалитет.И полнењето го спроведуваме сами. Маслото содржи природен витамин Е и е едно од најомилените масла за јадење на нашето време.Се чува на собна температура.Рок на траење-втиснат на амбалажата

(shqipe) 100% Ritja e Vaitprodhohet(1) me mullirin tone(2) mbrohen ritja(3) e bimve(4).Çdo porositje(5) kontrollohet dhe per ate(6) garantojme kualitetin e mir(7).Mbushen(8) e bejme vete(9). Vajti permbane vitamina natyrore e(10).Dhe eshte njera me te perdorura vajra per haje ne kohen tone(11).Ruhet ne dhoma me temperature(12).Afati i skadimit-i shtypur ne amballazhe.

Fotografia nr. 10



Перење во полуавтоматски машини: ... студена вода. Додадете една чаша белило "Test" ... додадете ги белите алишта во машината и оставете ги да се перат 30 минути, а потоа исплакнете ги со студена вода. Промените ја водата во машината и продолжете го процесот со прашок за перење.

Larje ne gjysemautomat (Lavatrice): Mbusheni lavatricen me uje te ftohte. Hidheni 1 gote uji me belino "Test" pa hedhur detergjent per larje. Futeni rrobat e bardha dhe lereni te lahen per nje kohe prej 30 minuti pastaj shpërlajeni rrobat më uje te ftohte. Nderrohet uji lavatrices dhe vazhdohet larja me detergjent.

Usage in roller washing machine: Change the washing machine with cold water. Add one glass of "Test" bleacher and do not detergent. Insert your white laundry into the machine, wash it for 30 minutes and then rinse the laundry with cold water. Change the water of the washing machine and continue the washing process with detergent.

Перење во автоматски машини: Ставете ги белите алишта во машината за перење, ставете прашок за перење во основната преграда и пред да ја вклучите машината, изберете ја саканата програма за предперење. Потоа, во делот за предперење додадете една чаша) приближно 200 мл) од "Test". За да добиете најдобри резултати за вашите алишта, додадете од "Test" откако машината ќе го прими неопходното количество вода.

Larje në makina automatike: Rrobat e bardhe i vendosni në lavatriçe, hidhni pluhur për larje në ndarjen bazë dhe para se ta kyçni lavatriçen, zgjidheni programin e duhur për paralarje. Pastaj, në pjesen e paralarjes hidhni një gotë (përafërsisht 200ml) nga zbardhësi "Test" që të fitoni rezultate më të mira për rrobat e tuaja të bardha shtoni nga zbardhësi "Test" pasi lavatriçen do ta marr sasinë e nevojshme e ujit.

Usage in automatic washing machine: Insert your white laundry into the washing machine, place the detergent into the main drawer of the machine and run the machine by selecting a pre-washing program. Add one glass (approximately 200ml) of "Test" bleacher into the pre-wash drawer of the washing machine while the machine is being charged with water. For an optimum white laundry result, add "Test" bleacher when the charging is over.

Fotografia nr. 11

Edhe nëpër mbishkrime dhe reklama në rrugë gjejmë plot gabime në të gjitha rrafshet gjuhësore, si p.sh.: *Ndal të pish sot* = nga: престани да пушиш денеска (për: Që sot ndalo (ose pusho) së piri duhan / Që sot mos pi më duhan)*; Krejt është kur ka gjithë* = nga: целосно е кога има сé (për: E plotë është kur ka (ngërthen) gjithçka / E tërë është kur ngëthen gjithçka); XY *është çdoherë mik i juaj* = XY е секогаш ваш пријател (për: XY është çdoherë miku juaj); *duke iu faleminderuar atij ne jemi...* = благодарејќи му се нему (për: falë atij ne jemi...); *Gjyshi jonë më i mirë, lëngu jonë më i mirë* (për: gjyshi ynë më i mirë, lëngu ynë më i mirë), *Kapshti zoologjic* (për: Kopshti zoologjik), *Nëna Terëze* (për: Nëna Terezë)*, Xamia e Mustafa Pashës* (për: Xhamia)*, Filipi i II-të i Maqedonisë* (për: Filipi II i Maqedonisë / Filipi i 2-të i Maqedonisë), *Kisha Shën Spasi* (dypikëshi i shkronjës [ë] është vendosur mbi shkronjën [h]); *Paniri i tretë e prodhimeve* (Panairi i tretë i prodhimeve), pra mospërshtatja e gjinisë. Mbishkrimi në hyrjen e ndërtesës së Operës dhe Baletit të Maqedonisë ishte shkruar kështu: *Maqedonisht Operës dhe Baletit* = nga:

Македонска Опера и Балет, kurse tash e kanë hequr fare mbishkrimi shqip.



Fotografia nr. 12



Fotografia nr. 13




Fotografia nr. 14



Fotografia nr. 15




Fotografia nr. 16




Fotografia nr.17

Sipas një mbishkrimi të vendosur në korridorin e Klinikës Universitare të Syve në Shkup, që shohim në fotografinë nr. 17,

kuptojmë së kjo klinikë ka bërë një “Marrëveshje 2014-vjeçare” me Fondin e Shëndetësisë, sepse në vend që të shkruhet: *Kemi marrëveshje me Fondin e Shëndetësisë për vitin 2014,* aty është shkruar: *Kena mareveshje me fondin per 2014 vj..* Të ngjashëm e kemi rastin me një lajmërim të vendosur në Entin për punë sociale: *Japim kartona shëndetsore për 2015 vjet.* (për: Japim kartona shëndetësore për vitin 2015, nga: издаваме здравствени картони за 2015 година). Një mbishkrim në korridor të një spitali që na bën të qeshim, sepse krijohet një çift minimal (plakat ~ pllakat), është: *Plakat rshqasin* (në vend që të jetë: Kujdes, se pllakat rrëshqasin! / Kujdes, se pllakat janë të rrëshqitshme!).



Fotografia nr. 18



Fotografia nr. 19

Shumë gabime gjejmë edhe nëpër dokumente zyrtare të institucioneve shtetërore, të cilat janë të një niveli pak më ndryshe në krahasim me artikujt e tjerë, sepse teksti i tyre është më i gjatë dhe zakonisht ato dokumente përkthehen nga njerëz që e njohin pak më mirë shqipen, sesa “përkthyesit” që provojnë të përkthejnë tekste të shkurtra si ato që i përmendëm më sipër. Për këtë arsye vlerësoj se këto shkresa duhet të trajtohen në ndonjë studim tjetër të veçantë, kurse sa për këtu mund të numërojmë vetëm rastet shumë karakteristike që

ndikohen drejtpërdrejt nga maqedonishtja, si: *Deri te Ministria për...* (në vend që të përdoret rasa dhanore: Ministrisë = si adresant) nga: До: Министерство за...; *Ministria <u>për</u> punë të brendshme* (në vend që të përdoret rasa gjinore: Ministrisë <u>së Punëve</u> të Brendshme) nga: Министерство <u>за</u> внатрешни работи; gabime këto që hasen në shumë lutje dhe kërkesa të shumicës së institucioneve.

Problem shumë i shpeshtë në shumë tekste të gjata dhe të shkurtra, jo vetëm gjatë përkthimeve, është përdorimi i mënyrës lidhore në vetën e tretë njëjës, e cila zakonisht zëvendësohet me kohën e tashme të mënyrës dëftore. Kjo është dukuri shumë e lashtë e trashëguar nga e folmja e rrethit të Dibrës, të cilën e hasim edhe te shkrimtarët e shekullit XVI dhe më vonë. Kjo strukturë ngjan edhe me konjuktivin (mënyrën lidhore) të maqedonishtes, si p.sh.: *të shkoj / të shkon, të punoj / të punon, të mësoj / të mëson, të jep, të merr* (në vend të formave të drejta: *të shkojë, të punojë, të mësojë, të japë, të marrë*) etj. Sa për ilustrim kemi fotografinë nr. 20, p.sh.: *EVN është e detyruar <u>të përfundon</u> lidhjen* (për: EVN-ja është e detyruar të përfundojë lidhjen), *çdo person ka mundësi <u>të arrin</u>* (për: të arrijë), *vetëm EVN Maqedoni mundet <u>të distribuon</u>* (për: mund të distribuojë / të shpërndajë). Në këtë fotografi, sikurse mund të vëreni, ka edhe gabime të tjera, si p.sh.: *termat* (për: afatet), *marrveshje* (për: marrëveshje), *ndërrmarje* (për: ndërmarrje), *mashtrrim* (për: mashtrim), *duke dilluar* (për: duke filluar) etj.

Ndikuar nga anglishtja dhe maqedonishtja, emrave të përveçëm të huaj nuk u vendosin çdoherë mbaresat e rasave përkatëse, por i përdorin në formë të ngurosur, si: *Sifo ofron për ju* (për: Sifoja). Por e përdorin: *Ai i tha Sifo**s;** Bashkpunojm me Murinjo* (për: Bashkëpunojmë me Murinjon)*; Princ punon çdo ditë 09:00-22:00h* (për: Princi punon çdo ditë nga ora 09:00 - 22:00), *Filip ofron terapi ....* (për: Filipi ofron terapi/trajtim të.....), *Koço shkoi atje* (Koçoja). Por: *Ai i tha Koço**s.** Shkoi me Koço**n**. Selishçev e mbron tezën e tij...*(Selishçevi), *Johan Shmid thekson se..., Fridman vërteton se....*(Fridmani)*, xha Zeqo* (Zeqoja)[2]

Fjalët e huaja që kanë depërtuar edhe në shqipe edhe në maqedonishte, të cilat duhet të shkruhen sipas parimit historik–tradicional (etimologjik), shkruhen gabimisht ndikuar nga drejtshkrimi i maqedonishtes, p.sh.: dijagonale (diagonale) ~ ди**ј**агонално, iracional (irracional) ~ и**р**ационален, materijal (material) ~ матери**ј**ал, rezulltat (rezultat) ~ резу**л**тат, morfollogji (morfologji) ~ морфо**л**огија, llogjik (logjikë) ~ **л**огика, fakulltet (fakultet) ~ факу**л**тет, still (stil) ~ сти**л**,

[2] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 8.

diciplinë / disciplinë (disiplinë) ~ дис**ц**иплина, zhirafë (gjirafë) ~ **ж**ирафа, akvarium (akuarium) ~ ак**в**ариум, funkcion (funksion) ~ функ**ц**ија, apsolut (absolut) ~ а**п**солутен, egzistim (ekzistim) ~ е**г**зистенција, univerzitet (univer**s**itet) ~ универ**з**итет, istorija (historia) ~ историја, finansa (financa) ~ финансии, arhiva (arkivi) ~ архива, psihologji (psikologji) ~ психологија, proekt (projekt) ~ проект, hierarhi (hierarki) ~ хиерархија, rezime (rezyme) ~ резиме etj.

Në ndikim të drejtshkrimit të maqedonishtes gabohet edhe përdorimi i shkronjave të mëdha ose të vogla të disa institucioneve apo emrave vetjakë me nyja dhe pjesëza të mbiemrave, si: Fakulteti filologjik (për: Fakulteti i Filologjisë), Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe (për: Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare), Jeronim De Rada (për: Jeronim de Rada) në analogji me Жозеф Ле Ба etj.



Fotografia nr. 21



Fotografia nr. 22



MK **ГАЛА петадерм маст за груба, здебелена кожа на стапала**

Ефикасно ја омекнува и отстранува грубата, сува и здебелена кожа на стапалата. Содржи салицилна киселина која нежно го отстранува површинскиот слој на изумрени клетки и витамини А и Е кои помагаат во регенерацијата на кожата, со што таа станува мазна, мека и нежна. Се нанесува на претходно измиена и добро исушена кожа, во тенок слој, со блага масажа, 1-2 пати дневно. Да не се користи на иритирана или инфицирана кожа, како и кај лица со дијабет. Во случај на алергиска реакција или иритации на кожата, да се прекине со употреба. Се препорачува бремени жени и доилки пред употреба да се консултираат со доктор. Да се внимава да не дојде во контакт со очите. Само за надворешна употреба. Да се чува на температура до 25 °C, во добро затворена туба, заштитено од светлина и влага. Да се чува на места недостапни за деца.

e-mail: liveros@abv.com


AL **GALA petaderm vaj për përafërt, lëkurë të trashë e ndjek këmba-këmbës**

Në mënyrë efektive zbut dhe heq thembra e ashpër, e thatë dhe të trasha të lëkurës.Acidi salicil vepron në mënyrë keratolitike (përkujdesëse) dhe largon shtresën sipërfaqësore të qelizave të vdekura të lëkurës. Përmban vitamina A dhe E të ndihmojë në rigjenerimin e të lëkurës, ajo bëhet e qetë, e butë dhe të butë. Lyhet në lëkurë më parë të larë dhe të thatë të thembërrave, në një shtesë të hollë, duke bërë një masazh të butë, 1-2 herë në ditë. Të mos përdoret në lëkurë të irituar, me ndezje apo të infektuar, si dhe tek personat dijabetik (me sëmundjen e sheqerit). Në rast të reaksionit alergjik dhe iritimeve në lëkurë, të ndalet me përdorimin e saj. Rekomandohet (këshillohet) për gratë shtatzane dhe atyre që japin gji foshnjeve që para përdorimit të konsultohen (këshillohen) me mjekun. Të kini kujdes të mos vijë në kontakt me sytë. Vetëm për përdorim të jashtëm. Të ruhet në temperaturë deri më 25 °C, në tubë mirë të mbyllur, të mbrojtur nga drita dhe lagështija. Të ruhet në vende larg kapjes së fëmijëve.



Fotografia nr. 23 Fotografia nr. 24

Më e keqja dhe më e dhimbshmja është kur nëpër artikuj ose mbishkrime hasim njëkohësisht gabime logjike, përmbajtësore dhe gramatikore, si në fotografitë nr. 21, 22, 23 dhe nr. 24, p.sh.: *Llokum thata* (në vend të: kumbulla të thata = суви сливи). Këtu zëvendësimi i fjalës 'kumbulla' me 'llokum' nuk mund të shpjegohet assesi; *Universiteti institut për Radiologjisë*; *Vaj për përafërt, lëkurë të trashë e ndjek këmba-këmbës*.....(për: krem / yndyrë për lëkurë të vrazhdë / të ashpër dhe të trashur të thembrave) etj. Shumë aktuale u bë edhe mbishkrimi i fotografisë nr. 24, i cili asnjë fjalë nuk është si duhet. I tërë teksti i këtyre fotografive më mirë dilte nëse përkthehej me "google translate", sesa në këtë mënyrë që ka shkretuar shqipen. Këto tekste nuk kanë asnjë kuptim. Kushdo që do ta lexojë këtë do të thotë në vete: "Alarm!!! Në duart e kujt ka mbetur shqipja në Maqedoninë e Veriut?!!"



Fotografia nr. 25

Po ashtu një emërtim i përkthyer në mënyrë shumë qesharake është fotografia nr. 25 *(Ndërmarrja qarkulluese publike)*. Këtë gjendje alarmante me të gjitha këto gabime e shumë e shumë të tjera, nuk i bën një folës i mirëfilltë i shqipes. Këtu, ose bëhet fjalë për një joshqiptar, ose për një shqiptar që mendon se e njeh shqipen, por në fakt është larg asaj. Këto mbishkrime, reklama, dokumente, përmbajtje të artikujve ushqimorë apo ilaçeve, fletëpalosje, qarkore etj. të kalkuara nga maqedonishtja apo anglishtja ose të ndikuara nga e folmja dialektore janë më të këqija se përkthimet e bëra në *google translate,* sepse shpesh ndodh që këto tekste, meqë janë të shkurtra, t'i përkthejnë persona që fare nuk e njohin shqipen ose e njohin vetëm përciptazi. Prandaj, mund të konstatojmë se shqipja në Maqedoninë e Veriut nuk është e përfshirë sa duhet në mënyrë institucionale nëpër mbishkrime, tabela, reklama dhe nëpër artikuj të ndryshëm ushqimorë, higjienikë etj., por edhe në ato raste që përdoret, niveli i përkthimit është përplot me gabime, gjymtime dhe shtrembërime fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore, logjike, semantike, teknike etj.

Ndërkaq, nga një analizë e bërë me librat shkollore të arsimit fillor në RMV, rezultoi që gati se të gjitha librat kanë gabime gjuhësore, teknike apo përmbajtësore, ndonjë libër më shumë e ndonjë më pak. Shkaqet e këtyre gabimeve janë:

- **Koha e shkurtër** dhe **trysnia** - Gjithmonë nga Ministria e Arsimit ose nga shtëpitë botuese punët bëhen me ngut dhe me afate shumë të shkurtra kohore. Përkthyesve dhe lektorëve nuk u jepet kohë e mjaftueshme për ta kryer punën me përgjegjësi dhe me përkushtim maksimal, por u bëjnë trysni për ta përshpejtuar punën.

- **Manipulimi** – ka raste kur jepen librat për përkthim, sidomos të lëndëve si muzika, matematika, kimia, historia etj., përkthyesit dhe lektorit i jepet vetëm pjesa tekstuale e jo edhe tabelat, pentagramet, diagramet, formulat, fotografitë e të ngjashme. Kjo bëhet për shkak të kursimit të mjeteve që duhet t'i paguhen përkthyesve dhe lektorëve në bazë të karaktereve, por pa e menduar se kjo dëmton cilësinë e librit. Nga ky manipulim rezultojnë libra gjysmake me pjesë të papërkthyera apo pa kontinuitet logjik, mospërshtatje të notave muzikore me tekstin e këngës, shkurtesa dhe formula me iniciale nga maqedonishtja, bile shpesh edhe me alfabet cirilik, ndërfutje të njësive mësimore ofenduese dhe përulëse për shqiptarët etj.
- **Cilësia e përkthyesit dhe lektorit** – jo gjithmonë përkthejnë apo lekturojnë personat kompetentë për këtë punë. Shpesh lektorë të librave janë persona joadekuatë ose ka raste kur vetëm shkruhet emri i ndonjë personi adekuat, por pa e shikuar fare librin personi në fjalë. Prandaj librat dalin, jo vetëm me përkthim të dobët, por edhe me lekturë dhe redaktim të dobët. Faktorët kryesorë të cilësisë jo të mirë të një numri të përkthyesve dhe lektorëve në RMV janë të natyrës gjuhësore e jashtëgjuhësore. Historia e zhvillimit të shqiptarëve dhe e gjuhës letrare shqipe përbën një shembull, ku duken qartë ndikimi i fuqishëm i faktorëve shoqërorë mbi fatet e gjuhës standarde. Në këtë rast po përmend vetëm disa nga ato, që mendoj se janë më të rëndësishëm: Diglosia, bilinguizmi dhe plurilinguizmi, analfabetizmi i disa brezave më të vjetra, analfabetizmi funksional i sotëm, cilësia e dobët gjuhësore e mjeteve të informimit, me një theks të veçantë tekstet e internetit, të cilat nuk e kanë aspak kujdesin e duhur ndaj gjuhës, mungesa e të lexuarit të librave gjuhësisht të redaktuara e të lekturuara dhe kjo ndodh pikërisht për shkak të epokës digjitale, e cila është pranuar për së prapthi e po keqpërdoret, sidomos nga gjeneratat e reja. Kurse edhe ata që duan të lexojnë pengohen nga format e gabuara. Gjeneratat që e njohin më së miri dhe e zbatojnë mirëfilli standardin janë të brezit të tretë (pra mbi 35 vjeçar). Vështirë mund të gjendet përkthyes dhe lektor i kompletuar.

Në librat e arsimit fillor në RMV hasen gabime gjuhësore (në rrafshin fonetik, morfologjik, morfosintaksor, sintaksor dhe leksikor), logjike, teknike dhe përmbajtësore.

Problemi më i shpeshtë në rrafshin fonetik është të shkruarit e zanores /**ë**/ të patheksuar, e cila në ligjërimin bisedor dhe në të folurit e shpejtë rrudhet (tkurret, reduktohet) në shkallë të ndryshme, në vendet ku ajo

duhet të shkruhet për shkak të parimit morfologjik, historik-tradicional, prandaj më shpesh gabohet në:

- Çiftet e mbiemrave dhe ndajfoljeve të të njëjtit tip, si: *drejt ~ i drejtë, drejtpërdrejt, shpejt ~ i shpejtë, shpejtësi, lart ~ i lartë, i lartpërmendur, vërtet ~ i vërtetë* etj.
- Mbaresa për vetën e parë dhe të tretë e shumësit: *shkojm- shko**jmë**, shkojn - shko**jnë**, luajn - lua**jnë**, i quajn – i qua**jnë*** [3] etj.
- Mbaresat e gjinores, dhanores dhe kallëzores në njëjës dhe të emërores e kallëzores në shumës tek emrat e gjinisë femërore, si: *letërsi**së**, gjuhësi**së**, dashuri**së**, lumturi**së**, letërsin**ë**, gjuhësin**ë**, dashurin**ë**, lumturin**ë**, letërsit**ë**, njësit**ë**, llogarit**ë**, dukurit**ë*** etj. (të gjitha këto i shkruajnë pa zanoren /ë/).
- Prapashtesa trajtëformuese e shumësit: *disa shkrimtar**ë**, dy ushtar**ë**, pesë këngëtar**ë**, 150 milion*[4] (milionë), *mund të jenë server ose kompjuter personal* (mund të jenë serverë ose kompjuterë personalë)[5]. Këto raste edhe kur janë në njëjës edhe kur janë në shumës gabimisht i shkruajnë pa /ë/.
- Mbiemrat që mbarojnë me –r, -k ose -v kur janë në formë shumësi: *titujt arsimor**ë**, kufij administrativ**ë**, kompjuterë të tjerë elektromekanik (elektromekanikë)*[6], *shtypësit laserik (laserikë)*[7], *të artistëve figurativ (figurativë)*[8] etj.
- Kur /ë/-ja ndodhet në pozitë mesore dhe është e patheksuar, e cila duhet të shkruhet për shkak të parimit morfologjik, si p. sh.: *hapsirë*[9] (hapësirë), *lojra* (lojëra)[10], *pjesmarje* (pjesëmarrje), *pikpamje* (pikëpamje), *vazhdimsi* (vazhdimësi) etj.
- Në fund të mënyrës lidhore të vetës së tretë njëjës: *(ai) arriti ta fus*[11] (ta fusë), *të shkoj* (të shkojë).

---

[3] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 8.
[4] Po aty f. 13.
[5] Po aty f. 14.
[6] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 10.
[7] Po aty f. 40.
[8] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 5, 84.
[9] M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Biologjia* 7**, Tetovë, 2018.
[10] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 52.
[11] Po aty, f. 11.

- Shtohet pa nevojë një **–ë** fundore në shumë fjalë, si: *ç'po ndodhë*[12] (ndodh), *me miqë*[13] (miq), *këtë vreshtë* [14] (vresht), *e sigurtë*[15] (e sigurt) etj.

Gabimet e tjera të shpeshta në lëmë të fonetikës e të fonologjisë janë: ngatërresë ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /**r**/ *(mar / marr, pjesmarje / pjesëmarrje, kur / kurë ~ kurrë / kurr, regull / rregull, rradha / radha, korigjim / korrigjim, morra / mora);* këmbimi i /**h**/-së me /**f**/-në *(njof = njoh, shof = shoh)* dhe e kundërta: të *njo**h**tohesh me* (njoftohesh), *je njo**h**tuar*[16], *ta njo**h**toj, njo**h**toeni*[17]; alternime të tjera si: *nd**j**ej, nd**j**ehem* (nd**i**ej, nd**i**hem), ***g**itarë* (**k**itarë), *kari**k**e* (ka**rr**i**g**e), ***s**pjegim* (**sh**pjegim), *nj**e**jt* (nj**ë**jtë), *gj**ë**rë* (gj**e**rë), gj**ë**rësisht (gj**e**rësisht)[18], ***ç**vendosen* (**zh**vendosen), *pe**js**azh* (pe**iz**azh)[19], *në mënyrë **k**ierarkike* (**h**ierarkike); metatezë dhe alternim, si: *shëndroj* (shndërroj), *pregadis* (përgatis); përdorim i gabuar i apostrofit te trajtat e shkurtra të përemrave, gjegjësisht ngatërrohet elizioni me shkrirjen *(t'i, t'ua, t'ju, m'i, m'u ~ ti, tua, tju, mi, mu)* me *(ta ~ t'a, ma ~ m'a)*; po ashtu **ç'** kur është përemër pyetës dhe kur është parashtesë antonimike apo përforcuese herë shkruhen të gjitha me apostrof e herë pa apostrof (nuk dallohen ***ç'**ka ~ **çka**, **ç**armatim ~ **ç'**armatim na qenka ky?!, **ç**farë ~ ç'farë, çdo ~ ç'do*); përdoret alternativa antihiatike e parafjalës **tek** edhe kur fjalët që pasojnë fillojnë me bashkëtingëllore, edhe pse në këtë rast duhet të përdoret **te**, si: *tek nxënësit*[20]; fjalë me epentezë: *e kaltër**t*** (e kaltër)[21], metatezë: *bëri das<u>ëm</u>* (dasmë)[22], apokopa: *më të këqia* (këqija)[23], *thesi me gru**n*** (grurë)[24]

---

[12] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 6.
[13] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 52.
[14] Po aty, f. 56.
[15] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 8.
[16] Po aty, f. 82.
[17] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 52, 53.
[18] Po aty, f. 51.
[19] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 81.
[20] Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën e IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009, f. 7.
[21] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 14.
[22] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 44.
[23] Po aty, f. 48.
[24] Po aty, f. 55.

(formë dialektore, pra pa rotacizëm), qiellzorëzim: *h**e**dhet në mënyrë* (h**i**dhet)[25] etj.

Te shumica e librave të historisë, muzikës dhe vizatimit hasen disa antroponime problematike, të cilat herë bien ndesh me drejtshkrimin e shqipes e herë me natyrën e shqipes, si p.sh.: *Kirilli dhe Metodi / Qirili dhe Metodi / Kirili dhe Metodi / Cirili dhe Metodi,* por kemi: *Kiril Pejqinoviq; Milosh Obiliq / Sllobodan Milosheviq,* por: *Millosh Gjergj Nikolla, Bllazhe / Blazhe, Lazar Liçenoski / Llazar* etj.

Shpeshherë hetohen edhe shkelje të normës morfologjike, si p.sh:

- Mosdallimi ose përdorimi i kundërt i gjinisë së përemrave vetorë ***ata*** dhe ***ato*** *(ato burra, ata gra ose ata burra, ata gra),* por edhe te disa emra si: *ky fëmiu* apo *kjo fëmija (*për: *ky fëmija);*
- Përdorim në rasë të gabuar të përemrave pronorë: *Ne i respektojm kritikat **e juaja*** (Ne i respektojmë kritikat **tuaja**);
- Përdorim i kundërt i trajtave të shkurtra të përemrave të vetës së dytë dhe të tretë në shumës, si: ***T'ju** them atyre, **T'u** ndihmoj juve,* në vend që të përdoret: ***T'u** them atyre, **T'ju** ndihmoj juve; nuk iu nevojitet* (nuk u nevojitet) [26]etj.
- Përdorimi i gabuar i përemrave **çfarë** dhe **cili**: *Çfarë është roli i....?* [27](në vend të: Cili është roli i ...)
- Gabime në përdorimin e nyjës ***i*** / ***e*** me ***të*** ose ***të*** me ***së*** *(... forma e mënyrës lidhore **të** kohës **së** tashme **të** vetës **së** parë shumës..., Ministri i Punëve të Brendshme **të** Maqedonisë, Ministrisë **të** Arsimit, kohës **të** tashme);*
- Mospërshtatje gjinie mes emrit dhe mbiemrit ose fjalëve përcaktuese, zakonisht me emrat mashkullorë ambigjenë që e formojnë shumësin si emrat e gjinisë femërore: *ata male* (ato)*, këta libra* (këto)*, këta fshatra* (këto), *në pjesën e përparmë* (e përparme)[28] ose e kundërta, kur duhet mbiemri të jetë në gjininë mashkullore,

[25] Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën e IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009, f. 23.
[26] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 130.
[27] M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Biologjia* 7**, Tetovë, 2018.
[28] Po aty f. 32.

përdoret në gjininë femërore, si: *stadium atletike*[29]*. kompjuterë të mëdha* (të mëdhenj) [30].

- Zakonisht titujt e mësimeve në gjuhën shqipe duhet të jenë në trajtën e shquar, kurse në maqedonisht përdoren në trajtën e pashquar, prandaj gjatë përkthimit shpesh bëhen lëshime dhe në po të njëjtin libër kemi laramani titujsh, gjysmat në trajtë të shquar e gjysmat në trajtë të pashquar, si p.sh.: *ton* (toni), *kontrast* (kontrasti), *tush* (tushi), *vizatim* (vizatimi), *teatër* (teatri) [31] etj.
- Përdorim i gabuar i disa foljeve të parregullta apo me dukuri morfonologjike, si p.sh.: *Hardueri është ai të cilin e godasësh kur...* (e godet)[32]
- Mënyra urdhërore, veta e dytë njëjës, shkruhet sikur të jetë mënyrë dëftore, veta e parë njëjës: *gjej personazhet* [33](gjeji).
- Mospërshtatje të numrit të emrit dhe mbiemrit, si p.sh.: *kompjuterët e ri* [34] (e rinj).

Gabimet leksikore janë zakonisht ato terminologjike, si: *livadhi magnetik* (fusha magnetike) = поле, *tregim skematik* (pasqyrë, paraqitje skematike) = приказ; *Jeta ka ekzistuar ende para rreth 3,5 miliardë vitesh* (qysh para) = уште пред; E metë tjetër janë barbarizmat, pra përdoren shumë fjalë të huaja dhe vetëm u vihen mbaresat e shqipes, si: *evitoj, konkludim, posedon, printim, kam predispozita, nuk flas unë apriori* etj. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe gabimet drejtshkrimore të natyrës leksikore (kompozitat, fjalët e prejardhura me parashtesim, përngjitja), gjegjësisht të shkruarit e fjalëve ngjitur (njësh), ndaras ose me vizë në mes, si në rastet: *bashkë lojtar* (bashkëlojtar), *mos aktivitet* (mosaktivitet), *gjysmë rrethor* (gjysmërrethor),[35] *poashtu* (po ashtu), *e*

[29] Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009, f. 14.
[30] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 15.
[31] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 6, 8.
[32] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 30.
[33] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 56.
[34] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 30.
[35] Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009, f.7, 16.

tj. (etj.) = и др., *të pa përdorshëm* (të papërdorshëm)[36], *sa që* (saqë)[37], *nëqoftëse* (në qoftë se), *njëri tjetrit* (njëri-tjetrit), *lloj lloj* (lloj-lloj) etj.

Në aspekt morfosintaksor dhe sintaksor hasëm gabime të vendndodhjes së fjalëve në fjali (topika), si: *bluetooth pajisje* (pajisje bluetooth), *audio fajll, video fajlla*[38]*, ai mos të shkon, ajo mos të bën, mos ta lija vetë* (për: ai të mos shkojë, ajo të mos bëjë, të mos e lija vetë); struktura të kalkuara, si: *makinë për shtyp*[39] (makinë shtypi); periudha të gjata me natyrë joshqipe, periudha pa kallëzues; përdorim i gabuar i presjes pas lidhëzave në vend të para lidhëzave ose përdoren aty ku fare nuk ka nevojë presje: *gjuha më pëlqen por, mësuesi*... (, por)[40] etj.

Ndër gabimet më të shpeshta teknike janë: vendosja e emrave maqedonase, në vend që të jenë emra shqiptarësh në tekste apo detyra matematikore; kanë mbetur disa pjesë të papërkthyera në mes të mësimeve; disa nga simbolet ose shkurtesat fare nuk përkthehen, por mbeten me inicialet e maqedonishtes dhe me alfabet cirilik; bëhet ndarje e gabuar e dyshkronjësheve në fund të rreshtit, si p.sh.: *bal-lafaqohen*[41]; në disa raste në vend të shkronjës [**ë**], përdoret shkronja [**e**] ose në vend të shkronjës [**ç**], përdoret [**c**], si p.sh.: *here* (herë), *mire* (mirë)[42], *cdo* (çdo) etj.; ka edhe gabime të tjera, si: *veprën artistiki* [43] (artistike), *karatere vullkanike* (kratere), *Ferdinand Magelani* (Fernando), *Jurij Gargarin* (Gagarin), *ekuadori* (ekuatori), *hmisferën* (hemisferën), *nevilit* (nivelit) [44] etj.

Për fat të keq, nëpër disa libra ka edhe gabime përmbajtësore, gjë që ndikon shumë negativisht në nxënien e informatave të sakta. Këto lloje të të metave të librave janë më të rrezikshme në krahasim me gabimet që u përmendën më sipër. Kështu, për shembull, lakimet e emrave në disa libra të Gjuhës shqipe përmenden 3, në disa 4 lakime; terminologjia është e paunifikuar mes librave të po së njëjtës lëndë, varësisht nga gjuha që është përkthyer apo hartuar libri; faktet e rrejshme historike

---

[36] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 30.
[37] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 53.
[38] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 92.
[39] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 66.
[40] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 50.
[41] S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009, f. 99.
[42] Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008, f. 55.
[43] Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009, f. 11.
[44] Gjeografia për klasën VI, Shkup, 2016.

për autoktoninë e shqiptarëve, gjegjësisht i quajnë shqiptarët të ardhur në shek. XII; lidhjen e gjenezës së maqedonsave të sotëm me maqedonasit antikë; luftërat me argumente zbutëse dhe eufemistike të sllavëve dhe grekëve, kurse hiperbolizimi i luftërave dhe sundimit Osman etj. Të gjitha këto ua tollovisin mendjen nxënësve dhe krijojnë paragjykime të gabuara, urrejtje, inferioritet etj.

Nëpër tekstet shkollore hasëm edhe gabime logjike, që shkaktohen nga formulimet e papërfunduara, si në rastet: *gjimnastika meshkuj, gjimnastika femra* [45], që do të kishte qenë më mirë të ishin: gjimnastika e meshkujve ose për meshkuj; gjimnastikë e femrave ose për femra.

PËRFUNDIM

Nga gjithë ç'u tha më sipër, po përfundojmë se zbatimi i shqipes standarde në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është në cilësinë dhe nivelin që dëshirojmë. Këto gabime ndikojnë negativisht në nxënien e shqipes standarde, prandaj duhet të korrigjohen e të mos lejohet që në të ardhmen të përsëriten. Që të shmangen këto lëshime në të ardhmen, duhet që:

REKOMANDIME

- Të krijojmë rrethana më të favorshme për ngritjen e përgjithshme intelektuale të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, duke përmirësuar cilësinë në arsim e si rrjedhojë të përmirësohet edhe kultura gjuhësore.
- Të bëhet përzgjedhja gjithnjë e më e madhe e përkthyesve dhe lektorëve cilësorë d.m.th. të mbahet përgjegjësi më e madhe në punë dhe gjatë përzgjedhjes nga punëdhënësi.
- Të bëhet kujdes më i madh gjatë përkthimit dhe lekturës, duke u shfrytëzuar të gjitha mjetet ndihmëse ekzistuese.
- Të rritet emetimi i emisioneve në radio e televizion për kulturën gjuhësore.
- Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve të trajnojë përkthyesit dhe lektorët e të gjitha institucioneve; t'u rekomandojë përkthyes dhe lektorë Ministrisë së Arsimit dhe shtëpive botuese; t'u lejohet të lekturojnë

[45] Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009, f. 24.

vetëm lektorët me licencë nga Këshilli i formuar nga Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve, kurse Inspektorati të mbikëqyrë mbarëvajtjen e zbatimit të shqipes.

- Të vihen në zbatim përfundimet e dala nga seminaret, simpoziumet dhe tribunat shkencore lidhur me çështjet teorike dhe praktike të shqipes standarde dhe të kulturës gjuhësore.
- Të zbatohen gjobat e nenit 22 e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, që shqipja e njësuar të merret realisht në mbrojtje nga shteti dhe të shpallet objekt kulturor i rëndësisë së veçantë, ashtu siç e kërkon edhe Kushtetuta.

Literatura e shfrytëzuar:

Ajten Hajdari – Qamili, ***Perla gjuhësore,*** Shkup, 2018.

Ajten Hajdari – Qamili, ***(Mos)zbatimi i shqipes standarde në Maqedoni***, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare, (13. 06.2012), Shkup, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve, Shkup, 13 qershor 2012.

Ajten Qamili, ***Shqipja "standarde" e studentëve të Maqedonisë***, Konferencë shkencore "Dyzet vjet të shqipes standarde", Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ***Drejtshkrimi i gjuhës shqipe***, Tiranë, 1973.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ***Konferenca shkencore ''Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot''***, Tiranë, 11 – 12 nëntor 2002, Shtëpia botuese ''Shkenca'', Tiranë, 2003.

B. Ristovski, Sh. Rahimi, S. Mlladenovski, S.K., T, Ç. ***Historia***, për klasën IX, Shkup, 2016.

Bllagoja Markoski, ***Gjeografia***, për klasën VII, Shkup, 2016.

Danço Ordev, ***Arsimi i artiti figurativ***, për klasën 7, Shkup, 2016.

Danço Ordev, ***Arti figurativ***, për klasën e 4, Shkup, 2009.

Danijella Gjorgjeviq, ***Informatika***, për klasën VI, Shkup, 2009.

Gj. Kasapi, S. Etemi, I. Dalloshi, ***Gjuha shqipe,*** për klasën III, Shkup, 2008.

Gjeografia për klasën VI, Shkup, 2016.

Gjovalin Shkurtaj, ***Si të shkruajmë shqip, Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale*** (Ligjërata dhe elemente të domosdoshme shkrimtarie), BOTIMET TOENA, Tiranë, 2008.

Gjovalin Shkurtaj, ***Urgjenca gjuhësore***, Tiranë, 2017.

Kiril Temkov, ***Etika***, për klasën VII, Shkup, 2015.

Lidija Belçeska Karapanxhevska, ***Arsim fizik dhe shëndetësor***, Libër për klasën IV në arsimin fillor nëntëvjeçar, Shkup, 2009.

M. Boshkoski, J. Ilioski, N. Dervishi, ***Historia***, për klasën VII, Shkup, 2016.

M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Biologjia* 7**, Tetovë, 2018.

M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Biologjia 9***, Tetovë, 2018.

M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Fizika 8***, Shkup, 2018.

M. Jones, D. Fellowes-Freeman, D. Sang, ***Fizika 9***, Tetov, 2018.

Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, ***Studime filologjike***, 3 – 4, VITI LXII (XLVII), Tiranë, 2008.

R. Noris, L. Rajan, ***Kimia 9***, Shkup, 2016.

Rami Memushaj, ***Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë***, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2005.

S. Arsenovski, M. Loshanska-Todorovska, Gj. Kakashevski, ***Informatika,*** për klasën e gjashtë, Shkup, 2009.

S. Pemberton, P. Kivli, P. Vinters, ***Matematika 7***, Tetovë, 2018.


S. Pemberton, P. Kivli, P. Vinters, ***Matematika 9***, Tetovë, 2018.

Thomas S. Kane, ***Si të shkruajmë shqip, Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën i përshtatur për shqipen***, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.

Z. Osmani, F. Bojku, ***Gjuha shqipe dhe leximi***, për klasën VII, Shkup, 2015.

Izer MAKSUTI[46]

ME RASTIN E SHËNIMIT TË DITËS NDËRKOMBËTARE TË PËRKTHIMIT



Motivi i fotografisë prezanton një dru, degët e së cilit simbolizojnë gjuhët dhe familjet gjuhësore.

"*Me gjithë ato që mund të thuhet për mangësitë e përkthimit, ai është dhe do të mbetet një nga punët më të rëndësishme dhe më dinjitoze në zhvillimet e përgjithshme të botës.*"

[46] Prof. dr. Izer Maksuti, mësimdhënës në Universitetin "Ukshin Hoti" - Prizren dhe në Universitetin e Tetovës, në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

Johann Wolfgang von Goethe (Gëte)

30 shtatori i çdo viti në të gjithë botën shënohet si

Dita Ndërkombëtare e Përkthimit (International Translation Day)

Rreth domosdoshmërisë së përkthimit

Me rastin e kësaj dite do të flasim për domosdoshmërinë e përkthimit, rolin qendror që ka pasur dhe ka përkthimi, për sfidat që kanë përkthyesit sot, kompetencën e nevojshme për të ushtruar zanatin e përkthyesit, si dhe disa tema tjera me interes për përkthyesit dhe me rëndësi për përkthimin.

Për këtë Ditë u vendos në vitin 1991 prej Federatës Ndërkombëtare të Përkthyesve (Fédération internationale des traducteurs - FIT), organizatë botërore e më shumë se 100 shoqatave nacionale të përkthyesve dhe interpretëve, me mbi 100.000 përkthyes në 55 vende.

Federata angazhohet për ruajtjen e të drejtave të përkthyesve, përmirësimin e kushteve të punës, mbështetjen e punës profesionale dhe arsimimit të tyre, lehtësimin e komunikimit etj.

Në maj 2017 OKB-ja vendosi që kjo ditë të shënohet në të gjithë botën.

Dita e sotme duhet të forcojë pozitën e përkthyesit në shoqëri, të nxisë solidarizimin me ata, të ndërgjegjësojë shoqërinë për rëndësinë e këtij profesioni dhe të rrisë vetëdijen, për të mbështetur dhe shpaguar më mirë mundin dhe punën e përkthyesve. Mjerisht puna e përkthyesve nuk respektohet, përkthimet e mira rrallë vlerësohen.

Për këtë arsye në këtë Ditë organizohen aktivitete të ndryshme prej specialistëve të kësaj fushe, si konferenca, kongrese, debate, manifestime nëpër shkolla etj. Për çdo vit aktivitete të tilla organizohen nën një moto të veçantë. Për të dëshmuar peshën e kësaj Dite dhe për të nxitur përkushtimin për gjatë gjithë vitit po përmend këtu vetëm disa moto të viteve të fundit: "*Përkthimi: një bartës i mirëkuptimit ndërkulturor*"; "*E drejta për gjuhët: një parakusht i çdo të drejte njerëzore*"; "*Përkthimi dhe interpretimi bashkon botët"; "Përkthim dhe diversitet*"; "*Përkthimi është baza për shumëgjuhësinë dhe diversitetin kulturor*"; "*Përgjegjësia e përkthyesit përballë profesionit dhe shoqërisë*"; "*Shumë gjuhë janë një profesion*"; "*Terminologjia: fjalët janë të*

rëndësishme"; "*Të ndërtojmë ura në mes kulturave*"; "*Përkthimi si komunikim ndërkulturor*"; "*Bota e bashkuar është përtej kufijve gjuhësor*". Motoja e këtij viti është: "*Përkthimi dhe Gjuhët Indigjene*", sepse OKB-ja vitin 2019 e ka shpallë si "*Vit i Gjuhëve Indigjene*".

Pa punën e vyer të përkthyesve sot me këtë dinamikë të globalizimit do të ishte e pa mundur përcjellja e risive, zhvillimeve, revolucionit teknologjik etj. Fakti që në botë sot ka mbi 6000 gjuhë - më shumë se gjysma e tyre fliten vetëm prej më pak se 10.000 njerëzve dhe një çerek i tyre vetëm prej më pak se 1.000 folësve - shton domosdoshmërinë për përkthyes të kualifikuar, pasi që më tepër ka njohuri vetëm për gjuhë të huaja si anglishtja e frëngjishtja, pjesërisht për spanjishten dhe gjermanishten, ndërsa gjuhët e mëdha aziatike dhe arabishtja njihen shumë më pak.

Me këtë shtohet pesha e përkthimeve profesionale për ndërlidhjen e kulturave dhe kombeve, për mirëkuptim të ndërsjellë, për mbështetje të paqes dhe zhvillim shoqëror, kulturor e ekonomik. **Përkthimi sot është një domosdoshmëri!** Tekstet që përkthehen janë të shumëllojshme duke nisur prej lajmeve të përditshme, udhëzimeve për përdorues të produkteve e medikamenteve, filmat dhe seritë televizive, gazeta, revista, reklama, libra profesionalë shkencorë, letërsi etj. Edhe bisedimet ndërkombëtare në rrafshin politik dhe ekonomik pa përkthyes nuk do të ishin të mundura. Kush do të kishte dashur që përgjatë bisedimeve vendimmarrëse e momenteve të tilla vendimtare të mos ketë përkthime cilësore dhe përkthyes profesionistë.

Rëndësia e përkthimit nëpër epoka të ndryshme historike

Për dallim prej shumë festave tjera kurioze, zgjedhja e 30 shtatorit ka të bëjë me ditën e emrit gjegj. vdekjes së Shën Jeronimit (347 - 420), i cili shquhet për përkthimin e Biblës nga hebraishtja në latinishten e folur (Vulgata); ai sot mbahet si shenjtori që mbron përkthyesit.

Përmes përkthimeve dija bartet prej një kulture në kulturat tjera. Përkthimeve në qendrën e atëhershme të përkthimit në Bagdadin e shek. IX u falënderohemi për ruajtjen e veprave shkruar nga dijetarë të antikitetit. Duke rishkruar nga një material në një material tjetër shkrimi dhe duke përkthyer ato u shpëtua nga zhdukja një pjesë e madhe e veprave të civilizimit antik.

E ashtuquajtura “Shkolla e Toledos” ripërktheu në shek. XII këto tekste në latinisht një shekull më vonë në kastilisht - pasi një numër i madh i përkthyesve ishin safardë, hebrenj të Spanjës, përkthimet u bënë edhe në gjuhën ladino - fakt ky që ndikoi edhe në normimin e gjuhës spanjolle.

Një prej arritjeve tjera në historinë e përkthimit është edhe përkthimi i Biblës nga Martin Luteri, i cili pati një ndikim thelbësor për zhvillimin e gjuhës gjermane. Përkthimet e Biblës angleze “King James” ndikuan disa shkrimtarë të njohur. Me shpikjen e shtypit këto libra të përkthyer botoheshin me tirazh më të madh. Periudha e romantizmit ishte koha e përkthimeve letrare; veprat e Shekspirit në gjuhët tjera të Evropës pasuruan gjuhën e skenës dhe teatrit në mbarë Evropën dhe botën. Mendimet e iluminizmit arritën të përhapen në të gjithë botën vetëm përmes përkthimeve. Puna e përkthyesve krijoi parakushtet për zhvillim të kulturës e shkencës dhe për konsolidim të gjuhëve popullore. Pra kudo që flitet, shkruhet, lexohet, por edhe këndohet gjejmë punën e përkthyesve dhe falë mundit të tyre janë ruajtur këto vlera botërore edhe në gjuhën tonë.

Të rikujtojmë rolin e përkthimit për zhvillimin e gjuhëve kombëtare; edhe për gjuhën shqipe përkthimet shembullore kanë qenë themeltare, duke nisur prej Gj. Buzukut, K. Kristoforidhit, F. Konicës, F. Nolit, J. Vrionit, V. Kokonës, A. Klosit e shumë të tjerë.

Shekulli XX dhe XXI është bërë epoka e përkthimeve të teksteve profesionale. Përmes globalizimit është shumëfishuar edhe nevoja për përkthime. Në radhë të parë përkthehen tekste të sipërmarrjeve të ndryshme prodhuese, kontrata, tekste juridike etj., por paralelisht veprat letrare në të gjithë botën po përkthehen gati në shumicën e gjuhëve të botës. Me këtë është shtuar numri i përkthimeve në fushë të letërsisë; edhe sot letërsia botërore njihet përmes përkthimeve.

Në vendet shumëgjuhësore të Evropës si Zvicra, Luksemburgu, Belgjika, përkthimet janë të patjetërsueshëm dhe përditshmëri. Sot Brukseli dhe Strasburgu merren si kryeqendra botërore të përkthyesve dhe interpretëve që punojnë për Komisionin Evropian. Me mijëra specialistë të këtyre fushave nga 28 vende anëtare të BE-së, përkthejnë tekste në 24 gjuhë zyrtare, sipas nevojës edhe në gjuhë tjera si në rusisht, kinezisht etj. Me miliona faqe përkthehen për Komisionin Evropian: Drejtoria e Përgjithshme e tij përkthen mbi 70 % të materialeve dhe rreth 30% e punës shpërndahet për përkthyes të

jashtëm. Tekste me përmbajtje jo sekrete dhe që nuk kërkohen urgjent u jepen për përkthim agjencive të përkthimit dhe përkthyesve të pavarur.

Detyra e shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit të BE-së është të mbështetet shumëgjuhësia në mbarë Bashkimin Evropian dhe qytetarët të njihen më mirë me politikat e BE-së. Dokumentet e organeve dhe institucioneve të BE-së përkthehen sipas prioritetit duke i ndarë në grupe dhe qëllime. Komisioni Evropian më së shumti përkthen në tri gjuhët e punës për të lehtësuar komunikimin: anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Anëtarët e parlamentit evropian i marrin dokumentet e punës secili në gjuhën e vet.

Faqeve të internetit u është shtuar pesha për informim publik, për atë çdo faqe e tillë zyrtare e internetit përkthehet në çdo gjuhë të BE-së. E gjithë kjo punë mundëson që të kemi kaq shumë informacione në më shumë gjuhë.

Kostoja e përkthimeve dhe interpretimeve të të gjithë organeve të BE-së: Komisioni, parlamenti, këshilli, gjykata, komisione tjera të shumta, është e lartë. Për çdo vit shkojnë harxhimet deri në mbi 1 miliard euro. E gjithë kjo është më pak se 1 % e buxhetit të BE-së, pak më shumë se 2 euro për çdo qytetar të BE-së (mbi 500 milionë banorë). Komisioni Evropian punëson mbi 3.000 përkthyes dhe interpretë. Në Komisionin Evropian punojnë poliglotë të shumtë që dinë me dhjetëra gjuhë, dallohet njëri që flet 32 gjuhë.

Kanadaja shquhet për të drejtat e gjuhëve dhe kultivimin e shumëgjuhësisë. Atje sipas ligjit gjithçka - e tërë veprimtaria politike duhet të përkthehet në gjuhën tjetër kryesore (anglisht – frëngjisht dhe anasjelltas) - sipas nevojës edhe në gjuhën e indianëve vendas.

Shqipëria si vend në NATO, vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian nga 2014, si vend me një numër kaq të madh të emigranteve, ka gjithnjë e më shumë nevojë për përkthyes profesionistë dhe do shtohen kërkesat për përkthime të testeve të fushave të ndryshme.

Kosova si shtet i ri, me një prezencë të lartë të ndërkombëtarëve si kurrë më parë në historinë e vendit, me një Ligj më të avancuar për përdorimin e Gjuhëve, është shembull për zbatim të dygjuhësisë në mbarë vendin (shqip dhe serbisht) dhe shumëgjuhësisë në nivel rajonal (shqip, serbisht, turqisht). Që dy dekada nga çlirimi i Kosovës një prej veprimtarive më aktive dhe fusha që ka siguruar shumë vende pune ka qenë ajo e përkthimit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut si një vend me një realitet të tillë shumetnikë dhe shumëgjuhësorë, pas miratimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve (11.01.2018 dhe hyrjes në fuqi më 14.01.2019) dhe me themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës (13.03.2019), për të zbatuar atë ligj dhe për të arritur një barazi gjuhësore në këtë vend do të duhet që tekstet përkatëse në gjuhën maqedonase të përshtatet e përkthehet edhe në gjuhën shqipe. E gjithë kjo do të jetë një sfidë e vërtetë për përkthyesit e paktë profesionistë që ka vendi, por po aq sfiduese dhe e vështirë do të jetë përgatitja, trajnimi dhe shkollimi i një mal përkthyesve që tanimë i duhen shtetit për të zbatuar këtë ligj, dhe për t'u përgatitur rrugës së anëtarësimit për në BE, si vend kandidat prej vitit 2005.

Sfidat e përkthyesve sot dhe kompetenca translatorike

Po të tentojmë të përmbledhim përkufizimet e shumta për përkthimin, si: zanat, shkencë e art, përkthimi në radhë të parë është një proces, si i tillë përkthim do të thotë të kuptosh, të aftësohesh të marrësh vendime dhe të kesh ndjenjë përgjegjësie për peshën e përkthimit si produkt e akt komunikimi. Përkthimi sot është një veprimtari e specialistëve të fushës përkatëse, ndërsa përkthyesit janë urë lidhëse mes dy gjuhëve, kulturave dhe botëve të ndryshme.

Sfida e përkthyesve sot është *nevoja e përditësimit të dijes* dhe *domosdoshmëria e kompetencës translatorike*. Nocioni translacion përdoret tanimë në shumë gjuhë si mbiterm për përkthimin dhe interpretimin. **Kompetenca translatorike** përfshin **kompetencën gjuhësore** në radhë të parë zotërimin e gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj (gjuhës së parë dhe gjuhës së dytë), njohjes së mirë jo vetëm të gjuhës në të cilën përkthejmë, por edhe të asaj nga e cila përkthejmë; **kompetencën profesionale** (njohjen e zanatit), metodologjinë e përkthimit (teknikat, strategjitë etj.); **njohjen e terminologjisë** për fushat që përkthejmë, si dhe thellimi i njohurive në fusha terminologjike, të llojeve të ndryshme të teksteve.

Për përkthyesit shqiptarë mungon terminologjia e harmonizuar, unifikuar dhe standardizuar e fushave të ndryshme në gjuhën shqipe, si dhe mjetet ndihmëse të përkthyesit, sidomos fjalorët terminologjikë për lëmenj të shumtë.

Padyshim edhe kompetenca për mjetet moderne ndihmëse, të cilët e lehtësojnë, përmirësojnë dhe racionalizojnë dukshëm punën e

përkthimit, është ndër parakushtet kryesore të zanatit të përkthyesit. Dihet që faktori kohë gjegj. shpejtësia në profesionin e përkthyesit luan një rol kryesor dhe është përditshmëri e tij. Mjetet ndihmëse elektronike i mundësojnë përkthyesit që të racionalizojë dhe automatizojë procesin e përkthimit.

Për natyrën e këtij shkrimi veçojmë këto mjete ndihmëse dhe njohuri të përkthyesit:

1. Fjalorë, leksikonë të ndryshëm (të shtypur dhe elektronik);
2. Tekste paralele, si dhe njohja e kulturës së gjuhës dhe vendeve ku flitet ajo;
3. Kompetenca kërkimore (reasearch competence) - është e pamundur të përkthejmë pa këtë kompetencë;
4. Administrimi i terminologjisë (terminology management), data baza terminologjike (terminology databases);
5. Translation Memorys (arkiv/regjistrues i përkthimit) si dhe teknologjia e përkthimit
6. Dije specifike në një fushë të caktuar (drejtësi, ekonomi, mjekësi, turizëm etj.); e patjetërsueshme për përkthyes të specializuar në një apo më shumë fusha;
7. Dashuria dhe ndjenja e veçantë për gjuhën dhe fjalën e shkruar.

Njohurit e gjithanshme që kërkohen për të përkthyer ndihmojnë të kuptuarit dhe me këtë lehtësojnë dhe përshpejtojnë procesin e përkthimit. Për të qenë më kreativ në procesin e përkthimit të teksteve ndihmon kultura e gjuhës dhe e shkrimit. Dihet që sa më e lartë kultura, aq më e pasur gjuha.

Sa kreativ duhet të jetë përkthyesi?

Sa "liri" ka përkthyesi për të qenë kreativ? Kreativiteti i autorit dhe i përkthyesit dallojnë.

Përsëritëm që përkthimi është një proces kompleks dhe i vështirë. Kreativiteti në këtë proces është tepër i nevojshëm dhe shpesh çelësi i zgjidhjes së problemeve të përkthimit. Nuk lejohet përkthimi fjalë për fjalë, por përshtatja e tyre në kontekstin e duhur kulturor, me qëllim që të bartet i tërë kuptimi i tekstit origjinal.

Gjatë përkthimit e përjetojmë gjuhën ndryshe, jemi më të afërt me atë, depërtojmë në të! Për të arritur efektin maksimal të disa lloje të teksteve duhet të jemi kreativ në përshtatje. Jo vetëm te përkthimet letrare, por edhe në fushë të marketingut, përkthimi i teksteve publicitare, sloganeve të reklamave etj., rekomandohet një kreativitet i veçantë. Këtu përkthimi fjalë për fjalë nuk do të ishte i duhuri.

Përkthimi duhet të tingëllojë ashtu sa teksti i përkthyer të mos dallohet se në cilën gjuhë është hartuar. Teksti i përkthyer mirë i jep lexuesit të njëjtën ndjenjë sikurse teksti origjinal!

Përkthim i arrirë merret ai tekst, saqë kur e lexojmë na duket sikur të jetë shkruar në gjuhën tonë. Për të arritur rezultate të tilla në përkthim duhet studim i duhur dhe përvojë e gjatë në fushat përkatëse.

Në të gjithë hapësirën shqiptare nuk ka thuajse asnjë shkollë të mirëfilltë që përgatit përkthyes profesionistë. Gati asnjë universitet shqiptar nuk ka program të konsoliduar e standardizuar dhe me staf akademik të kompletuar, ku do të kishin mundur të përgatiten kuadrot e sotëm dhe të ardhshëm që i duhen botës shqiptare.

Në të gjithë vendet shqiptare nuk ka institucione që janë përgjegjëse dhe filtër i përkthimeve se a janë ata cilësorë dhe të denjë për botim. Sot në botën shqiptare përkthimet improvizohen për përfitime përmes tenderëve. Nga ky krim i "përkthyesve" vuajnë sot e gjithë ditën tekstet mësimore në shkollat tona, librat universitarë, veprat letrare etj. Këto tekste të përkthyera shkel e shko, janë fare të pakuptueshëm e të pa përdorshëm! Me këtë është dëmtuar shoqëria dhe lexuesi shqiptar ka humbur rastin që të ketë në dorë ato vepra me vlerë përmes përkthimit cilësor.

Sikurse disa zanate tjera me shumë përgjegjësi edhe ai i përkthyesit paguhen keq. Sa për krahasim Amazon pas çdo libri të shitur fiton 20 herë më shumë se përkthyesi, falë punës së të cilit kemi në dorë atë botim. Kjo e rrënon edhe statusin e përkthyesit. Përkthyesit e vërtetë janë idealistë, pasi si përkthyes nuk bëhesh i pasur, por pasurimi vjen në forma tjera duke qenë në kontakt me tekste të ndryshme, njeh kultura, vende e njerëz të shumtë. Përkthyesi krijon një lidhje të veçantë me tekstin origjinal dhe me autorin. Përkthyesit janë (ri)krijuesit e asaj që kanë shkruar autorë të ndryshëm.

Literatura e shfrytëzuar:

Albrecht, Jörg (2005): *Übersetzung und Linguistik*. Tübingen: Narr.

Baker, Mona ed. (2001): *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*. Routledge, New York.

Kautz, Ulrich (2002): *Handbuch Didaktik des Übersetzens und Dolmetschens*. München: Iudicum.

Koller, Werner (2011): *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*. Tübingen: Francke

Reiss, Katharina (2000): *Grundfragen der Übersetzungswissenschaft.* Wien: WUV.

Snell-Horby, Mary u.a. ed. (1999): *Handbuch Translation.* Tübingen: Stauffenburg.

Tupja, Edmond (2007): *Këshilla një përkthyesi të ri*. Tiranë: Onufri.

Qemal MURATI[47]

GJEDHE TË ZVETËNIMIT GJUHËSOR TË SHQIPES NË PËRKTHIM

"*Ai që e shkruan dhe e flet bukur standardin, është privilegj për të.*" – **Isa Bajçinca**

Për organizimin e këtij debati më temë "*Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut*" dëshiroj të përgëzoj "Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës", si dhe të uroj formimin e kësaj Agjencie – themelatës më të rëndësishme për përkujdesjen dhe zbatimin e gjuhës shqipe në përdorimet publike dhe drejtorin e saj dr. Ylber Sela (diçka e tillë nuk është krijuar as në Shqipëri e as në Kosovë).

Në fillim (jo *fillimisht* – na ka lodhur ky artificializëm i kotë) dua të bëj një digresion të vogël për rëndësinë e gjuhës. Institucionet qeveritare në Suedi kanë në listën e pagave edhe nga një gjuhëtar, puna e vetme e të cilit është për të shkurtuar dhe lehtësuar *gjuhën e dokumenteve*. Me fjalë të tjera, për të kundërshtuar prirjen e të shprehurit të komplikuar që është evidente kudo, madje edhe në Skandinavi, e natyrshme për njerëzit në pozitë. A ia vlen për të ëndërruar për një vend pune të tillë dhe në administratën tonë? Në çdo rast, një gjuhëtar i tillë nuk do të kishte punë të lehtë, sepse gjuha administrative është e pasur me plot shprehje që nuk do të thonë asgjë - pohon linguisti i njohur Ranko Bugarski në librin e tij *Jezik oko nas* (*Gjuha rreth nesh*) (Ranko Bugarski, *Jezik oko nas*, NOLIT, Beograd, 1980, 46).

Më shumë sesa në Skandinavi e në vende të tjera, angazhimi i gjuhëtarëve a korrektorëve gjuhësorë posaçërisht ia vlen te ne – për t'u përkujdesur që kjo gjuhë të shkurtohet e të thjeshtohet që të jetë më e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë, sidomos në administratën tonë publike. Këtë detyrë të rëndësishme tanimë po e merr "Agjencia për Zbatimin e Gjuhës" – e cila ka marrë e po strukturohet dhe presim të realizojë një varg projektesh për mirëmbajtjen e gjuhës shqipe siç është dhe organizimi i këtij debati sot – që është për çdo lëvdatë dhe për t'u përshëndetur.

---

[47] Prof. dr. Qemal Murati, punonjës shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe në ITSHKSH – Shkup.

Në gjuhën e shkruar të administratës sonë shtetërore, në tekstet e ligjeve, në medie, në shkollë e në universitet, në zhargonin e politikanëve, kemi një gjuhë të mjegullt e të komplikuar, të thatë e të klishetizuar dhe me struktura e gjedhe të gjuhëve të huaja. Për këtë ka shembuj të panumërt, të cilëve u duhet vënë gisht dhe duhet t'u qiten rrënjët në diell.

Në zhvillimet e reja të kohës sonë: teknologjike, ekonomike, politike, kulturore etj. natyrisht "*Çdo gjuhë duhet të pasurohet me fjalë e me shprehje të reja, por para së gjithash duhet të kihet parasysh fryma e gjuhës, struktura e saj, ngase gjuha është organizëm që nuk i duron "trupat" e huaj*" (Krume Kepseki 2014: 333). Në këtë fushë, një nga problemet më thelbësore të shqipes së sotme standarde është çështja e neologjizmave, pra mënyra se si duhen adaptuar fjalët e reja nga anglishtja, çështja e krijimit të strukturave të reja artificiale dhe e përdorimit të fjalëve pa bukë, çështja e sintaksës se a do ta shprehim një mendim me tri fjali apo me një fjali, pra çështja e gjuhës së mjegullt, e jo çështjet e zgjidhura se a do të shkruhet *kalë* me ë apo *kal* pa *ë*, a do të themi *qurra* apo *qyrra*, a do të shkruajmë *banjë* apo *bajë*, e kotësira të tjera të këtij lloji. *Respektimi i gramatikës gjatë të folurit e të shkruarit është çështje dinjiteti personal dhe pranimi të dinjitetit të bashkëbiseduesit* – shprehet leksikologu italian Silverio Novelli, autor i librit *"Thuhet? Nuk thuhet? Varet" (Si diçe? Non si diçe. Dipende*). Sa e flasim shqipen shqip? Sa janë shqipfolësit tanë të dinjitetshëm në pikëpamje gramatikore e të qytetërimit gjuhësor? Përgjigjja mund të jetë: pak ose aspak.

Sot kemi një shqipe të nëpërkëmbur e të keqpërkthyer, për të cilën studiuesi dhe publicisti i njohur Moikom Zeqo shprehej me shqetësim a me zemëratë:

1. Si ka mundësi që nuk luftohet, jo për purizmin absurd, por për pastërtinë e gjuhës shqipe, që përmban në vetvete mundësi të mëdha edhe të farkëtimit frazeologjik, por edhe terminologjik?

2. Si ka mundësi që këto 27 vjet janë botuar një numër i frikshëm përkthimesh nga gjuhët e huaja, në një gjuhë shqipe banale dhe gati të frikshme?

3. Si ka mundësi që janë zhdukur korrektorët letrarë dhe nuk respektohet ortografia e gjuhës shqipe? Duket sikur përjetojmë jo vetëm një kohë pa asnjë respekt për gjuhën shqipe, por gati censin e një barbarie gjuhësore.

4. Politikanët tanë të cilët janë fjalamanët më të padurueshëm dhe ritualë të ekraneve dhe të medieve flasin në një gjuhë shqipe të kontaminuar, për shkak edhe të diturive sipërfaqësore dhe të mediokritetit në kokat e këtyre politikanëve.

5. Si ka mundësi që në vend të gjuhës së mrekullueshme shqipe ne të ngulmojmë, në mënyrë të pashpirt të krijojmë një *kitch – gjuhë shqipe*? (Moikom Zeqo, Gazeta "Dita", 5.7.2017).

Në gjuhë është e rëndësishme jo vetëm ajo që thuhet, por dhe ajo që nuk duhet të thuhet dosido. Për këtë qëllim, siç pohon prof. Emil Lafe: Një "*Gramatikë e gabimeve*", e hartuar në një mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe tërheqëse, do të ishte një mjet i pazëvendësueshëm për të luftuar shmangiet e gabimet gramatikore që vihen re (E. Lafe, *Probleme dhe detyra në fushën e kulturës së gjuhës, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës"*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973, 32).

Për debatin e sotëm rreth problematikave në fushë të përkthimit, do t`u sillemi disa fjalëve dhe shprehjeve të krijuara a të përkthyera skandalisht keq nga gjuhët e huaja në shqipen, sidomos nga serbishtja dhe maqedonishtja, e kohët e fundit dhe nga anglishtja, të cilat janë shumë larg shqipes dhe i japin kësaj gjuhe një shije të athët, artificiale dhe e bëjnë të paqartë dhe të pakuptueshme. E vrazhdë dhe e egër është posaçërisht gjuha e portaleve, me frymë e me sintaksë sllave, për të cilën përkthyesi i njohur Edmond Tupja shprehet kështu:

Masakrimi i gjuhës shqipe, përveçse në fushat e tjera, vërehet sidomos dhe në fushën e përkthimit, ku kjo gjuhë bëhet gjithnjë e më e panatyrshme dhe më e paqartë, sepse fjalët, togfjalëshat, fjalitë e frazeologjizmat nga gjuhët e huaja përkthehen ad literam, fjalë për fjalë, paçka se në shqipen ato nuk kanë kurrfarë kuptimi. Këto vitet e fundit gjuha shqipe po përdhunohet sistematikisht nga pseudopërkthyesit e të gjitha strukturave e niveleve shtetërore e private për t`u ndërzyer me fjalë të huaja të panevojshme e për t`u tredhur si kurrë ndonjëherë. Fatkeqësisht, nuk po përdhunohen vetëm fjalët, por edhe struktura morfosintaksore të shqipes, madje edhe struktura semantikore e saj (E. Tupja, *Pro translitore - Shtjellime kritike për përkthyesin dhe përkthimin*, OMBRA GVG, Tiranë, 2003).

Fjalë dhe shprehje të formuara e të përkthyera keq që duhen shmangur nga përdorimi

Adresoj problemin - Në komunikimin publik ka zënë e po përdoret shpesh një shprehje e çuditshme që nuk është në natyrën e shqipes: "*Ta adresojmë problemin*". Shqip shprehemi: *e shtroj problemin, e shqyrtoj problemin, e trajtoj problemin, e zgjidh problemin*, e kështu më tej. Kurse ata që thonë se *do ta adresojnë problemin* as nuk do ta shqyrtojnë, as nuk do ta zgjidhin, por jua kanë dredhur, ju kanë mashtruar. Po përse kështu, do të pyesë dikush. Sepse kthejeni fjalinë ndryshe kur njeriu flet ndershmërisht dhe ju thotë: e kemi shqyrtuar problemin, e kemi zgjidhur problemin tuaj. Po çfarë feje kuptimi do të kishte fjalia: "*E kemi adresuar problemin tuaj*"? (Xhevat Lloshi).

Deri te... - Mediet tona vazhdojnë të flasin shqip në maqedonisht me përdorimin e një shprehjeje artificiale **"deri te"** (maq. *do*):

Deri te

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Mediumet

Përfaqësitë diplomatike në Shkup

Organizatat Joqeveritare

Partitë politike që përkrahin lirinë e medias

Z. Piter Van Haute

Të gjithë dashamirët e fjalës së lirë

(Gazeta "Lajm", 17.02.2016).

- Kam reaguar me shkrim **deri te kryetari** i Qytetit të Shkupit" (Almakos, 17.2.2016).

Kur i drejtohemi me shkresë zyrtare një institucioni a personi të caktuar, shqip thuhet: *Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë* (jo: Deri te Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë);

Kam reaguar me shkrim *te kryetari* i Qytetit të Shkupit (jo: *deri te kryetari* i Qytetit të Shkupit).

Diploma të krahasueshme ndërkombëtare - Universiteti i Prishtinës ofron *diploma të krahasueshme ndërkombëtare* (në informatorin e UP).

Ç`kuptim ka togfjalëshi *diploma të krahasueshme ndërkombëtare,* as dreqi s`e di. Drejt: *diploma kompatibile ndërkombëtare* (lat. *compatibilis* "që janë të pajtueshme me diplomat ndërkombëtare").

**Do t`i ketë duart plot punë -** Gjykata speciale për krime lufte dhe krim të organizuar *do t`i ketë duart plot punë* (mbititull, Shtypi).

Kalkuar keq nga serb.: *Imače pune ruke posla*. Shqip: *Do të ketë një mal punësh.*

Falënderohet - Izraeli falënderohet nga Serbia

"*Izraeli falënderohet nga Serbia* për mosnjohje të Kosovës" (titull). Shqipja në natyrën e saj përdor veproren (falënderoj) e jo pësoren (falënderohet). Prandaj duhet të thuhet e të shkruhet: "*Serbia falënderon Izraelin* për mosnjohjen e Kosovës".

Falënderues

Jemi shumë falënderues për faktin se…

Jemi shumë falënderues për këtë ndihmë dhe kujdes të vazhdueshëm…

Ne jemi shumë falënderues se si na kanë mbështetur në 13 vjetët e fundit…

Kolegji përsëri ka hapur rrugën e mundësisë së arsimimit, një ndihmesë për të cilën *ne jemi shumë falënderues*…

Juve ju jemi shumë falënderues për pritjen miqësore që na keni bërë…

Ne jemi shumë falënderues për këtë nivel evropian…(Shtypi).

Në "laboratorin" e praktikës ligjërimore të "politikëbërsve" tanë të Kosovës është krijuar dhe ka hyrë në qarkullim një shprehje krejt artificiale *falënderues* (si përkthim i fjalëpërfjalshëm nga gjuhët sllave *zahvalan*), në vend të gjegjëses shqipe *mirënjohës*.

Në të gjithë shembujt e mësipërm kemi një të folur shqipe në serbisht ose serbisht me fjalë shqipe. Shqip thuhet: *Jemi shumë mirënjohës* ose *Ju falënderojmë*, jo *jemi shumë falënderues.*

Falënderues dhe mirënjohës

"LR-PDSH-ja dhe Kryetari i saj janë *Falemnderues dhe Mirënjohës* përjetë solidaritetit të pa imagjinueshëm që të gjithë keni treguar gjatë këtyre ditëve me ne."

Gjuha shqipe ka *falënderoj, falënderim*, por nuk ka *falënderues*/ *jam falënderues.* Në vend të kësaj të fundit ka: *mirënjohës/ jam mirënjohës*. Prandaj duhet të thuhet e të shkruhet:

"LR-PDSH-ja dhe Kryetari i saj janë *mirënjohës* përjetë për solidaritetin e paimagjinueshëm që të gjithë keni treguar gjatë këtyre ditëve me ne."

Fillimisht

"Këto gjurmë kanë qenë të shprehura *fillimisht* në qytete".

"Palestinezi në Got Talent - *fillimisht* të gjithë e përqeshin, më pas e gjithë salla shpërthen në lot".

"Ardhja e Mitchell *fillimisht* në Kosovë – simbolikë e veçantë".

Fillimisht është një fjalë e krijuar kohët e fundit dhe e përdorur kot. E përfshin edhe FGJSH si një ndajfolje librore *fillimisht* - në fillim; që në fillim, si fillim. Në vend të këtij artificializmi, që është i gabuar edhe nga pikëpamja e fjalëformimit gramatikor (mungon hallka fjalëformuese *fillimi*- që të jepte *fillimisht*, khs. sikurse kemi te *miqësi - miqësisht*), në shqipen përdoren: *së pari, së pari herë, në krye të herës, në krye të radhës,* etj.

Fitili i zjarrit - Në pritje të filmit "*Gori Vatra*" (*Fitili i zjarrit*).

Prania e filmit boshnjak "*Gori Vatra*" (*Fitili i zjarrit*, "Koha Ditore").

Përkthim i gabuar i titullit të filmit boshnjak "Gori Vatra" me "Fitili i zjarrit", që nuk ka asnjë kuptim. Shqip përkthehet "*Digjet zjarri*".

Gjegjësisht, përpjesëtimisht - jo të rregullta janë edhe krijimet e reja, sidomos me ndajshtesën *-isht*, si: *gjegjësisht, përpjesëtimisht, lirisht,* etj. (Mimoza Priku, *Ndikimet e huaja në të folmet shqipe të përdorura në trevat e Malit të Zi*). Këtyre mund t'u shtojmë edhe: *fillimisht*, etj.

Hesapet e pastra, dashuria e gjatë

Me sa di thuhet: "*Hesapet e pastra – dashuria e gjatë*" (R. Qosja, *Ligjërime paravajtëse*, 1996, 81).

Frazeologjizëm i përkthyer fjalë për fjalë nga serb. *čist račun, duga ljubav*. Fjalori i H. Bariçit (Rečnik srpskoga ili hrvatskoga jezika, Zagreb, 1950) dhe Fjalor serbokroatisht-shqip (Prishtinë, 1986, 104) këtë frazeologjizëm të serbishtes e japin me gjegjësen shqipe *hesape të mira, miq të mirë.*

Gjegjësja më e goditur shqipe është: *Llogari e spastruar, punë e mbaruar.*

I njëjti/ të njëjtit, të njëjtat

"Policia e Kosovës përmes raportit 24-orësh, tregon se dje në Podujevë është arrestuar një i dyshuar pasi që **i njëjti** së bashku me një të dyshuar tjetër e kanë sulmuar fizikisht viktimën, dhe i kanë grabitur 500 euro."

"MPB e ka konfirmuar ndeshjen, dhe **të njëjtit** kanë deklaruar se ministrja, Jankulovksa nuk ka pësuar ndonjë lëndim gjatë aksidentit" (Shtypi);

"Sipas përqindjes së votave nga këta vendvotime, **të njëjtat** mund të ndikojnë në rezultatin përfundimtar" (Shtypi).

"Dy mjekë kanë përfunduar në pranga të Policisë së Kosovës **pasi që të njëjtit** dyshohet me bazë se kanë lëshuar certifikata mjekësore për patentë shofer pa ndonjë kriter" (ALMAKOS).

"Sinqerisht më vjen shumë keq dhe ndjehem i nënçmuar kur mendoj që një pjesëtar i një nacionaliteti tjetër (apo ndonjë që proklamohet si shqiptar e që në damarë i rrjedh kushedi se çfarë gjaku) e që me siguri nuk mund t'i prodhojë si duhet tingujt melodikë të gjuhës shqipe për shkak të mungesës së **të njëjtave** në gjuhën e tij, të marrë guximin e të formulojë fjali dhe tekste të tëra në shqip dhe më në fund **të njëjtat** t'ua servojë shqiptarëve në stilin De Luxe! (Portalb);

Kalk nga maq. *istite*.

Në gjuhën shqipe nuk përdoret një përemër i tillë **"i njëjti"** (nga sll. *istiot*), që është një artificializëm i pakripë, por "*ai, ajo*".

Iu nënshtrua plagëve - "Sulmuesi nga Virxhinia *iu nënshtrua plagëve*" (titull, shtypi).

“Ministri i katërt somalez *iu nënshtrua plagëve* të marra në sulmin vetëvrasës në Mogadishu” (titull, Shtypi).

“Futbollisti i qëlluar me armë zjarri në Aerodrom *iu nënshtrua plagëve*” (titull, Shtypi).

Kalkuar (përkthyer) keq prej serb. *podlegao povredama*.

Ju dëshiroj udhë të mbarë! Në këtë urim folja *dëshiroj* duket normale kah ana morfologjike, por më e qartë kuptimisht dhe në përputhje me normën letrare do të ishte folja *uroj*.

Kyçem/ nuk kyçem

“*Unë kurrë nuk kyçem në polemika* të cilat nuk i konsideroj, por Akademia do të jetë gjithmonë ndihmesë e institucioneve shtetërore për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe të rinisë...” (Nexhat Daci, Gazeta “Express, 21.10.2018).

Fjala *kyç, kyçem* në gjuhën shqipe do të thotë: mbyll, mbyllem, por në Kosovë, nën ndikimin e serbishtes, kjo fjalë përdoret gabimisht me kuptimin: “përfshihem, hyj, inkuadrohem” (*uključiti se*). *Kyçem në parti; kyçem në politikë; u kyça në diskutim*, në vend se: *hyj në parti; përfshihem në politikë; mora pjesë në diskutim,* etj.

Në fakt - sipas një hulumtimi, fjala më parazite në artikulimet e moderimit televiziv, kryesisht në hapësirat informuese, është: ‘*në fakt*’. (ang. *in effect,* it. *infatti*). Në çdo dy fjali, ka nga një ‘*në fakt*’ (Gazeta “Dita”, 20.12. 2013), në vend se të thuhet shqip: *në të vërtetë, në thelb*. Vetëm në një kronikë televizive të Klan Kosova patëm vënë re se një gazetar përdori 7-8 herë fjalën **në fakt**.

Edhe në ligjërime të tjera televizive, biseda a intervista, pas çdo pyetjeje të gazetarit, i intervistuari përgjigjet gjithmonë me një “**në fakt**”. Në një intervistë në “LajmTV” (22.04.2017) që zgjat 8 minuta e 38 sekonda, e intervistuara përdor 8 herë shprehjen e famshme “**në fakt**”:

“Është e vërtetë që libri im **në fakt** është shumë aktual, pavarësisht se ai ka disa vite që është bërë...Problematikat që trajton libri janë shumëdimensionale. **Në fakt** sot flitet gjerësisht për statusin e shqiptarëve në shtet... Çështja e gjuhës shqipe është **në fakt** një problem që duhej të ishte zgjidhur para 2001... **Në fakt**, kohëve të fundit flasim vetëm për politikë...Politika është gjëja që na intereson më tepër në vend

që **në fakt** duhet të ishte krejt e kundërta...**Në fakt**, ne, i gjithë populli, **në fakt**, jemi të angazhuar me hallet e politikës...**Në fakt** libri im është aktual...".

Në fakt në të përditshmen ka nisur *faktikisht* të përdoret shumë anglishtja, por ndoshta kjo nuk është vetë faji i njerëzve, por edhe i kushteve që Shqipëria ndodhet... (Pyetje)

Në fakt, unë jam dakord që anglishtja po merr përmasa të një gjuhe, ndoshta vendoset në krye të gjuhëve ndërkombëtare, që po përhapet me përmasa të jashtëzakonshme. (Përgjigje)

Në fakt do të kisha dëshirë të ndalemi pak më gjatë, meqenëse përkon me temën e emisionit tonë... (Pyetje) (Shtypi).

Ç'është ky "**në fakt**" (ang. *in fact,* it. *infatti*), kur në shqip mund të thuhet aq bukur: "*në të vërtetë", "në thelb*", "*puna është se*", por natyrisht as këto shprehje nuk duhet të përdoren aq shumë.

Në qoftë se më premton shëndeti: "*Në qoftë se më premton shëndeti*" (në gjuhën e intelektualëve) – maq. *Ako zdravjeto mi vetuva*. Shqip: *Nëse do të kem shëndet. Të jem gjallë e shëndoshë*.

Nuk jam i thirrur: "Për këtë je *i thirrur*. Kjo është puna jote." (Gazeta Express, 11.10.2017).

"**Nuk jam i thirrur** që të njoh apo të mos njoh Kosovën" ("Zëri").

"**Nuk jam thirrur** për të dhënë dëshmi" (Rtv Klan).

"Unë nuk e di emërtimin taktik të operacioneve që zhvilloheshin sepse **nuk jam e thirrur** për atë punë. **Unë jam e thirrur** për sterilizimin e instrumenteve dhe unë përcjell instrumentet dhe kjo është detyra ime", u përgjigj dëshmitarja" (Mediet).

Formuar sipas gjedhes së serb. *pozvan, nisam pozvan*. Shqipja e shpreh këtë me: "*kompetent, nuk jam kompetent*", e jo me "*nuk jam i thirrur*". Kjo e fundit është një shprehje e çoroditur pa shije e pa kuptim.

Paraprakisht – "**Faleminderit paraprakisht**", kalkuar nga serb. **hvala unapred.** Shqip mund të thuhet më drejt: *faleminderit që më parë* – nëse do të thoshte diçka kjo shprehje.

Përkundër - "Bahtiri thotë se **përkundër** problemit me murin, në Mitrovicë situata është e qetë" (titull).

Duhet thënë shqip: *me gjithë problemin e murit*.

Përkundër I. *pj*. Përkundrazi. II. *parafj.* Kundër, përballë, kundrejt. Përkundër asaj rryme. Përkundër pushtuesit të egër. **Përkundrazi** *pj.* Krejt ndryshe nga sa mund të mendohet a nga ajo që është thënë më parë; jo (përdoret zakonisht në fillim të një fjalie a si fjalë a ndërmjetme për të kundërshtuar a për të mohuar atë që është thënë më parë). Mos ishte diçka e papritur? - Përkundrazi, këtë e kishim marrë vesh me kohë. Nuk u tërhoqën, përkundrazi, nisën sulmin.

Përskaj - në mediet tona, për *"pokraj"* të maqedonishtes ka marrë e po përdoret një artificializëm i çuditshëm në shqipen "*përskaj*" që nuk do të thotë asgjë. P.sh.:

- "BDI kërkon njohjen e shqipes si zyrtare në OKB, **përskaj gjuhës maqedonase**" (titull);

- "Gazeta e përditshme maqedonase "Fokus" shkruan sot se Bashkimi Demokratik për Integrim BDI, do të kërkojë që gjuha shqipe të jetë zyrtare **përskaj gjuhës maqedonase** në Kombet e Bashkuara" (Agjencia INA);

- Mediat konsiderohen pushtet i katërt në shoqëritë bashkëkohore, **përskaj pushtetit** legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

- "Deri tani, **përskaj problemeve** të shumta, ajo arrin disi ta ekuilibrojë lirinë dhe sigurinë ndëretnike…" (Shtypi);

- "Në apelin për një rezistencë gjithëpopullore, **përskaj përpjekjeve** që të ketë partner shqiptar…" (Shtypi).

- "Shumica e qytetarëve në zgjedhjet e djeshme parlamentare kanë votuar për ndryshime. Vullneti i tillë i qytetarëve u bë evident edhe **përskaj shembujve** të shumtë të presioneve, frikësimit dhe blerjes së votave".

Në të gjithë shembujt e cituar kemi të bëjmë me një përkthim të fjalëpërfjalshëm të shprehjes maqedonase *pokraj* me një artificializëm të pakuptueshëm *përskaj*, në vend të gjegjëses shqipe *krahas, me gjithë*.

Shqip nuk thuhet **përskaj gjuhës maqedonase** (maq. *pokraj makedonskiot jazik*), por **krahas gjuhës maqedonase**.

Jo **përskaj problemeve** të shumta (maq. *pokraj mnogu problemi*), po **krahas problemeve** të shumta, *me gjithë* problemet e shumta.

Jo **përskaj përpjekjeve***…,* po **krahas përpjekjeve, me gjithë** përpjekjet.

Përkatësisht - gjuhëtari ynë i shquar prof. I. Ajeti thoshte se ndajfolja **përkatësisht** jo vetëm në shtypin tonë të përditshëm, por as në shkrimet e specialistëve të degëve të ndryshme, nuk ka gjetur përdorimin e drejtë të saj; *odnosno*-ja e sllavishtes në të shumtën e rasteve po shqipërohet dhe sikur ka zënë vend të qëndrueshëm (gabimisht) **përkatësisht,** duke u zënë vendin: **a, ose, o, apo**: kanë ndihmuar për të sqaruar *a* për të ndriçuar anë të zhvillimit historik të shqipes, (*a=odnosno*).

- "A ka, **përkatësisht** a pretendon medoemos mision poezia?

Mos vallë edhe e ashtuquajtura poezi e pastër e emërtuar si e tillë që nga fillimet e lirikës moderne evropiane, **përkatësisht** që lidhet me emrin dhe poezinë e Merimesë...;

- Përkatësisht kjo shumëllojshmëri prek pragun e lirikës së padeshifrueshme... (A. Aliu, *Poezia si mision*, "Studime filologjike shqiptare, ASHAK, Prishtinë, 2008, 109).

- "Folklori shqiptar, **përkatësisht** krijimtaria artistike gojore...".

"Kosova sfidohet nga Gjeorgjia **përkatësisht** Izraeli" (titull, "Bota Sot", 9.6.2017).

- "Etimologjia e emrit dardan, **përkatësisht** e Dardanisë...".

"Rregullore nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, **përkatësisht** marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta".

- "Mikrotoponimet, **përkatësisht** hidronimet e këtyre anëve janë analizuar edhe nga aspekti dialektologjik..." (shtypi).

FGJSSH fjalën **përkatësisht** nuk e ka me kuptimet e mësipërme, por e sjell si ndajfolje librore me kuptimin: në gjendjen kur secili lidhet me atë që i përket. Bujqësia dhe blegtoria do të rriten **përkatësisht** 16 dhe 8 për qind në krahasim me vitin e kaluar.

Kontradiktë në mbiemër - Por, nga ana tjetër, nga çfarë u „polemizua" aty: edhe informim me pagesë, edhe ruajtje anonimati, të krijohej dhe „shija" e një „*contradicto in adjectivo*" („kontradiktë në mbiemër"), pse jo, edhe e një abuzimi jo të vogël!... (R. Mejdani, "Shekulli", 23. 3. 2006).

Shprehja e njohur *contradictio in adjecto* në shqip përkthehet me *kontradiktë në zanafillë, kundërthënie në zanafillë,* dhe jo me *kontradiktë në mbiemër,* e cila si e tillë nuk ka asnjëfarë kuptimi.

Me duar të zbrazëta - Dhe u kthyen *me duar të zbrazëta* ("Koha Ditore", 18. I. 2008).

Përkthim nga serb. *praznih šaka*. Shqip thuhet: *duarzbrazët.*

Nëse keni hëngër të gjitha dhe çdo gjë...

"Nëse një ditë hani *cilësisht,* kjo do ta shtojë *vetëbesimin tuaj.* Nëse *keni hëngër* pa menduar mirë *të gjitha dhe çdo gjë* (serb. *sve i svašta*)...(L. Field, *Psikologjia e vetëbesimit*, Titanic, Prishtinë, 2005).

Përkthim fjalë për fjalë që e venit natyrën e shqipes, i mbushur dhe me gabime gramatikore.

Shqip thuhet: *Nëse një ditë hani ushqime me cilësi të mirë, kjo do ta rriste besimin tuaj në vetvete. Nëse keni ngrënë pa menduar mirë çfarëdo ushqimi...*

Natë e qartë - Është një natë e qartë! (Rilindja javore). Përkthim i fjalëpërfjalshëm nga gjerm. *Es ist eine klare Nacht.*

Shqip thuhet: *Është një natë e kthjellët*.

Nën zë - Tash së fundi *nën zë përflitet* edhe për një „pakt" politik ndërmjet kryetarit aktual të Kosovës dhe zëvendëskryeministrit... (nëntitull, "Kosova Sot").

Sajesë e çoroditur, kalk nga serb. *ispod glas*. Shqip mund të thuhet: Tash së fundi *përflitet në diskrecion, shushuritet, pëshpëritet* a vetëm *përflitet,* por jo *përflitet nën zë.* Kjo e fundit është një çorbë që s`di ç`emër t`i vësh.

Pyetja e stabilitetit – "Pyetja e stabilitetit të Maqedonisë" (titull i një botimi, për *çështja e stabilitetit.* Përkthim i gabuar nga fr. *question*, duke ngatërruar *çështjen* me *pyetjen*).

Rastin e kam lajmëruar në polici (shtypi). Shtrohet pyetja: *Lajmërohet rasti*, kur folja lajmëroj përdoret vetëm për njerëzit?! Rendi i drejtë do të ishte: *Për këtë rast kam lajmëruar policinë.*

Shakanë anësh - *Shakanë anësh*! ("Koha"). Sll. *Šalu na stranu*.

Shqip thuhet: *Pa shaka. T`i lëmë shakatë*.

Shërbim inteligjent - Përkthim i gabuar i termit të anglishtes *Intelligent Servis,* që përdoret gjerësisht në gjuhën e medieve dhe të politikanëve tanë. Në anglisht fjala (nocioni) *intelligence* ka disa kuptime a përdorime: 1) zgjuarsi, intelekt, mençuri; 2) informacion, të dhëna; 3) zbulim; *intelligence servis* shërbim sekret (*informativ*).

Në shqipen duhet përdorur: *Shërbimi sekret, Shërbimi i zbulimit, Shërbimi informativ* (jo *Shërbimi inteligjent*, sepse kjo e fundit asocion me inteligjent "intelekt").

Shihemi!/ dëgjohemi! - Në gjuhën e folur shqipe në Kosovë, kur dikush ndahet me dikë, ka marrë e po përdoret: *shihemi, dëgjohemi,* (si përkthime të fjalëpërfjalshme të shprehjeve gjegjëse serbe *vidimo se* dhe *čujemo se*), në vend se të thuhet drejt me admirativin (dëshiroren) e shqipes: *Mirupafshim! Mirudëgjofshim!*

E quajmë shumë të drejtë mendimin e gjuhëtarit Isa Bajçinca që thoshte se "*Shqipja në Kosovë nuk vuan nga standardi, por vuan nga serbishtja*".

Shprehet i zhgënjyer/ shprehet optimist/ shprehet pesimist

"Orav *shprehet i zhgënjyer* që nuk është arritur marrëveshja" (titull).

"Wilshere *shprehet optimist* për sezonin e ri" Klan Kosova (titull);

"Elseid Hysaj *shprehet optimist* për ndeshjen me Danimarkën" (titull);

"Tadiç *shprehet optimist* për vazhdimin e dialogut me Kosovën" (titull);

"Greenspan *shprehet pesimist* në parashikimin e tij në lidhje me fatin eë Greqisë".

Në gjithë shembujt e mësipërm fjala *"shprehet"* është e tepërt, e mund të mos përdoret fare. Pra, mund të thuhet fare qartë: Orav *i zhgënjyer* që nuk është arritur marrëveshja; Elseid Hysaj *optimist* për ndeshjen me Danimarkën; Tadiç *optimist* për vazhdimin e dialogut me Kosovën, etj.

Tani veç – "*Tani veç është bërë publike*"; "*Tani veç është paralajmëruar*". Kështu e flasin gjuhën intelektualët tanë në medie, në TV, në Radio. Me dy shprehje paralele ndajfoljore me kuptim të njëjtë: *tani* – shqip, dhe *veç* – serbisht.

Titujt më kryesorë

(A ka shkallë krahasore mbiemri kryesor-e?)

Mbiemri *kryesor-e* "që është në krye nga rëndësia; themelor; qendror", ka një përdorim të shpeshtë në gjuhën standarde shqipe, si p.sh.: *Çështje kryesore. Rrugë kryesore. Sheshi kryesor i qytetit. Fjali kryesore* (FGJSSH).

Krahas këtyre përdorimeve të drejta, kohët e fundit ky mbiemër ka zënë e po përdoret mjaft shpesh, sidomos në mediet elektronike – në radio e në televizion, edhe me pjesëzën *më – më kryesore,* sigurisht nën ndikimin e gjuhëve të huaja, veçanërisht anglishtes a italishtes, si p.sh.:

-Këto ishin disa prej informacioneve *më kryesore* që ndoqët në këtë edicion lajmesh (Top Channel);

- Këta ishin titujt *më kryesorë* të gazetave (KTV);

- Një nga lëvizjet *më kryesore...*

- Në vazhdim të njihemi me titujt *më kryesorë* të shtypit të sotëm (KTV);

- Këta janë titujt *më kryesorë* të gazetës "Bota Sot" (KTV);

- Këta janë titujt *më kryesorë* që veçuam për gazetën "Kosova Sot" (KTV);

- Të shohim cilët janë titujt *më kryesorë* në shtypin e Tiranës (KTV);

- Shkrimi *më kryesor* në gazetën "Koha Ditore"...(KTV);

- Kemi parë pak më parë titujt *më kryesorë* në gazetat e Prishtinës dhe titujt *më kryesorë* në gazetat e Tiranës (KTV);

- Ishin këta titujt *më kryesorë* të shtypit të Tiranës (KTV);

- Do të shohim tani disa prej ndryshimeve *më kryesore* ndërkombëtare (Top Channel).

Mbiemri *kryesor-e* në logjikën e gjuhës e ka të shprehur së brendshmi idenë krahasore e sipërore "që është në krye nga rëndësia, themelor, qendror", prandaj nuk është e nevojshme të paraprihet nga pjesëza *më* dhe të bëhet *më kryesore,* sepse nuk ka *më shumë kryesore* dhe *më pak kryesore.* Në grupet emërore: *titujt më kryesorë, informacionet më kryesore,* kemi vetëm një galimatias a çorbë gjuhësore, të gatuar keq nga kuzhinierët shqipfolës. Për informacionet apo artikujt e një gazete mund të thuhet: *informacionet kryesore* (dhe *jo më kryesore), artikulli kryesor* i gazetës ose *kryeartikulli* i numrit (dhe jo artikulli *më kryesor)* etj.

Dihet që jo të gjithë mbiemrat mund të kenë shkallë krahasimi, sepse disa tipare (veçori, cilësi) për nga natyra e vet nuk mund të shprehen (nuancohen) në shkallë të ndryshme, si: *i shkëlqyeshëm, i njësishëm, ideal, tradicional, eminent, prioritet, katastrofal, minimal, optimal* etj. Këta mbiemra jo vetëm që nuk lejojnë krahasim *(më i shkëlqyeshëm, më i njësishëm, më ideal, më tradicional, më eminent, më minimal, më optimal, më kryesor)*, por nuk lejojnë as përcaktim sintaksor me kuptim vlerësues, siç i ndeshim në mediet tona:

- Njëra nga qëllimet *më prioritare;*
- Të ardhurat *më minimale;*
- Për krijimin e kushteve *më optimale;*

- Është një nga profesorët *më eminent;*

Formimet e tilla kanë shkuar edhe në gjuhë të tjera ballkanike, si. p.sh. në maqedonishten (Elena-Joana Atanasova-Nikulesku, *Za upotrebata na nekoi tudji zborovi vo makedonskiot jazik na radioto i televizijata, Makedonskiot jazik vo javnoto opštenje,* Skopje, 2000).

Me pjesëzën *më* formohet shkalla krahasore e sipërore relative e mbiemrave: *i mirë – më i mirë, i vogël – më i vogël, i madh – më i madh, i bukur – më i bukur* etj., por jo dhe mbiemrat *kryesor – më kryesor, i shkëlqyeshëm – më i shkëlqyeshëm, eminent – më eminent,* etj., siç u vu re më sipër.

Gjuha shqipe bën pjesë në përkufizimin e kombit (E. Tupja), prandaj fjalët e kësaj gjuhe nuk bën të bien në fondin pasiv kurse fjalët e huaja në fondin aktiv. Po kështu, nuk bën të fusim frymën e huaj në të folurit shqip duke bjerrë frymën vetjake: *Më ke munguar* (për: më ka marrë malli), *do të na mungosh* (do të na marrë malli për ty), *shkopi dhe karota* (për: *kërbaçi dhe kulaçi*), *resurset dhe burimet ujore* (për: *burimet ujore*)*; nuk ka sens* (për: *nuk ka kuptim*). Për një *ngjarje të shënuar* gjithnjë e më shpesh po përdorim *eveniment*, e prej *eveniment* në *event*.

Standardin e gjuhës shqipe dhe standardin e përkthimit duhet ta kultivojmë e ta përparojmë, jo ta zbresim në standardin e gjuhës së rrugës e të artificializmit. Për këtë qëllim, që ta mirëmbajmë shqipen tonë të bukur, do të ishte e dobishme që "Agjencia për Zbatimin e Gjuhës" të themelojë një organ a revistë për kulturën e gjuhës ("*Gjuha shqipe në praktikë*"), në formë të shtypur dhe online, si dhe të organizojë *trajnime për përdorimin e gjuhës shqipe dhe ruajtjen e gjuhës standarde.*

Literatura e shfrytëzuar:

Ali Aliu, *Poezia si mision*, "Studime filologjike shqiptare, ASHAK, Prishtinë, 2008.

E. Tupja, *Pro translitore - Shtjellime kritike për përkthyesin dhe përkthimin*, OMBRA GVG, Tiranë, 2003.

Elena-Joana Atanasova-Nikulesku, *Za upotrebata na nekoi tudji zborovi vo makedonskiot jazik na radioto i televizijata, Makedonskiot jazik vo javnoto opštenje,* Skopje, 2000.

Emil Lafe, *Probleme dhe detyra në fushën e kulturës së gjuhës, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës"*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973.

Fjalor serbokroatisht-shqip (grup autorlsh), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1986.

Henrik Barić, *Rečnik srpskoga ili hrvatskoga jezika*, Zagreb, 1950.

Isa Bajçinca, *Shqipja standarde dhe probleme rreth saj* (Përmbledhje artikujsh), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016.

Idriz Ajeti, *Për ngritjen e kulturës gjuhësore*, "Vepra" 2, ASHAK, Prishtinë, 1988.

Kerume Kepeski, *Statii i analizi za makedonskiot jazik*, "Makedonika litera", Skopje, 2014.

L. Field, *Psikologjia e vetëbesimit*, Titanic, Prishtinë, 2005.

Moikom Zeqo, Gazeta "Dita", 5.7.2017.

Ranko Bugarski, *Jezik oko nas*, NOLIT, Beograd, 1980, 46.

Rexhep Qosja, *Ligjërime paravajtëse*, Prishtinë, 1996.

Demush BAJRAMI[48]

MEDIAT SOCIALE SI NXITJE TË REJA NË PERCEPTIMIN E DIVERSITETIT GJUHËSOR DHE KULTUROR

Njeriu me kohë ka ndërtuar botën e informacionit (simboleve), fjalët, me të cilat ka nxitur dhe ka marrë pjesë në procesin e komunikimit. Gjatë gjithë qytetërimit, njeriu ka zhvilluar aftësitë e tij, e me këtë edhe mjetet që plotësojnë nevojat themelore për komunikim. Struktura sociale e komunikimit ka qenë objekt i hershëm studimi. Pikëpamjet për mënyrën e komunikimit i kanë rrënjët që në kohërat e lashta, të grekëve dhe romakëve të vjetër, të cilët merreshin me studimin e retorikës - artit të komunikimit me gojë, por edhe me shkrim.

Sot, diversiteti kulturor e gjuhësor ka hapur gamën e gjithëprfshirjes tematike e problemore, kurse mediave sociale u ka dhënë nxitje të reja në perceptimin më të drejtpërdrejt të multikulturalizmit dhe multilingualizmit, si dhe komunikimit publik. Ky lloj komunikimi, para së gjithash vendosë parimet mbi të cilat bazohet informimi multikulturor, duke respektuar normat gjuhësore. Prandaj, ky punim nxjerr në pah rolin e mediave sociale dhe të internetit, ku ky i fundit duke qenë tepër i sofistikuar për nga natyra dhe jashtëzakonisht diversiv për nga përmbajtja, është shndërruar në një mundësi reale për të gjithë ata të cilët përmes bashkimit virtual i sendërtojnë interesat e tyre të përbashkëta.

Fjalët kyç: Gjuha, komunikimi, informacioni, media sociale, multikulturalizmi.

Paranteza hyrëse

Përgjatë gjithë historisë së marrëdhënieve njerëzore, gjuha, kultura dhe shoqëria kanë qenë në ndërveprim, por sidomos ky ndërveprim ka ardhur në shprehje në mes të gjuhës, mendimeve dhe të kuptuarit të botës, duke luajtur edhe një rol të rëndësishëm në

[48] Doc. dr. Demush Bajrami, mësimdhënës në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në UEJL.

pikëpamjet dhe diskutimet e ndryshme filozofike. Çdo sistem gjuhësor ka folësit dhe të folmen e saj burimore brenda një bashkësie të caktuar gjuhësore si një mjet komunikimi që transmetohet dhe mbijeton në kohë dhe hapësirë i trajtuar si i vlefshëm, logjikisht i strukturuar dhe njëkohësisht kompleks.

Komunikimi është proces i dërgimit dhe pranimit të porosive (mesazheve) në mes të njerëzve - proces i shkëmbimit të informacionit. Më shpesh bëhet përmes shenjave të caktuara. Modeli më i thjeshtë i komunikimit është komunikimi në mes të dy subjekteve – dërguesit dhe pranuesit të porosisë. Të shprehurit dhe plotësimi i nevojave është qëllimi i komunikimit njerëzor. Prandaj, komunikimi është një proces i shkëmbimit të përhershëm të informacionit.

Ndërvarësia si fenomen interaktiv në një shoqëri me pluralitet shenjash kulturore, gjuhësore e fetare, krijon dosmoshmërinë e kohezionit social, politik e ekonomik, nga ku buron edhe formimi i shprehive të përbashkëta dhe largimi nga qasjet etnocentike.

Multilingualizmi dhe multikulturalizmi janë një fenomen i përhapur që ekziston në pothuajse çdo vend të botës, qoftë i njohur apo jo zyrtarisht, por edhe një përgjigje politike dhe shoqërore në kontekst të situatës sociale në të cilën nuk ka konsensus mbi një kulturë të vetme kombëtare, e cila duhet të mundësojë integrimin e shoqërisë plurietnike dhe plurikulturore (siç ka qenë gjithnjë). Prandaj, ekzistenca e etniteteve kombëtare një gjuhësore ose homogjene vihet në pikëpyetje pasi që "të gjitha etnitetet kombëtare" thuhet se janë shumëgjuhësore. (Beacco J-C., Byram M., 2007, f. 22).

Pothuajse, të gjitha shoqëritë evropiane janë multikulturore, por vetëm disa prej tyre e respektojnë realitetin multikultural. Pra vetëm aty ku multikulturalizmi kuptohet si një program ose doktrinë që trajton situatën multikulturore sociale, duke u përpjekur për të trajtuar të gjitha kulturat brenda një shoqërie, me një qasje të barabartë. Koncepti i multikulturalizmit sot, kryesisht, tregon të bashkëjetuarit njëkohësisht dhe paralelisht e më shumë kulturave në një hapësirë të caktuar. Megjithatë, multikulturalizmi në kuptimin më të gjerë nënkupton bashkëjetesën paqësore të komuniteteve të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare në të njëjtin vend/në të njëjtën hapësirë. Njohja e të drejtave të grupeve kulturore dhe vlerësimi pozitiv i dallimeve të tyre është në qendër të kërkesave multikulturore. Banting dhe Kymlicka (Banting K., Kymlicka W., 2006), kanë përpiluar një listë të politikave që mund të përdoren për të vlerësuar shkallën në të cilën një vend i caktuar ka ose

nuk ka adoptuar multikulturalizmin. Politikat e përfshira në këtë listë japin një ilustrim të qartë të asaj që do të thotë multikulturalizmi në praktikë:

- afirmimi kushtetues, legjislativ ose parlamentar i multikulturalizmit në nivelin qendror dhe / ose rajonal dhe komunal;
- miratimi i multikulturalizmit në kurrikulën shkollore;
- përfshirja e përfaqësimit etnik dhe ndjeshmërisë në mandatin e mediave publike ose licencimit të mediave;
- lejimi i shtetësisë së dyfishtë;
- financimi i organizatave ose aktiviteteve të grupeve etnike;
- financimi i arsimit dygjuhësor ose i mësimit të gjuhës amtare;
- veprim afirmues për grupet e pafavorizuara të imigrantëve.

Në këtë kontekst, duhet përfshirë edhe realitetin plurilingual me zotërime të ndryshme të kodeve dhe sistemeve të veçanta. Sipas Sapir (1929): "Asnjë gjuhë nuk është asnjëherë aq e ngjashme sa të konsiderohet se përfaqëson të njëjtin realitet shoqëror. Botët në të cilat jetojnë shoqëritë e ndryshme janë botë të dallueshme dhe jo thjesht bota e njëjtë me etiketa të ndryshme të bashkangjitura". (Sapir E. , 1929, fv. 207-214).

Për sa kohë që qytetërimi është përballur me një reflektim të fuqisë së fjalës dhe derisa kishte një monopol mbi aftësitë e të shkruarit, komunikimi nuk kishte rolin e një shkence. Në kulturat gojore, në të cilat shkrimi ishte një lloj privilegji, por edhe një mjet i dominimit dhe manipulimit, monopoli i dijes e kështu edhe mjetet e komunikimit, ishin bërë pronë e sunduesve, dijetarëve dhe klerikëve. Për shekuj me radhë, komunikimi bëhej vetëm me ndërmjetësimin e shenjtorëve dhe ikonës, e cila kishte rolin e medias. Kjo është edhe sot, por në thelb ka ndryshuar karakterin dhe porosinë, duke u vënë në dispozicion të të gjitha shtresave shoqërore.

Mediat sociale dhe diversiteti gjuhësor e kulturor

Normat e kulturës tradicionale e kanë vështirë ta inkorporojnë në vetvete diversitetin kulturor, gjuhësor e mediatik. E mbyllur në

sistemin e njëtrajtshëm të prodhimit të vlerave tradicionale, bota si e tillë është dashur të bëjë revolucionin e shndërrimit të stereotipeve në konglomerate multikulturore, për t'ia krijuar vendin një fenomeni të ashtuquajtur infoglobalitet, i cili nënkupton procesin e komunikimeve masive që zhvillohen në të gjitha nivelet botërore, duke mos përjashtuar as ato lokale. Multikuluturalizmi mund të gjejë mbështetje pikërisht në këtë fenomen, posaçërisht në shoqëritë shumëkombëshe siç është rasti me Maqedoninë e Veriut, ku monopoli i dikurshëm nacional-ideologjik, është zëvendësuar me një model të ri vlerash e perceptimesh, që njihet si demokraci digjitale, e pakontrolluar nga një qendër e vetme e vendosjes.

Duke qenë se fuqia e medias sociale gjithnjë e më tepër po ndikon në sensibilizimin e institucioneve, pushteteve dhe opinionit të qytetarit, sfidë e posaçme paraqitet ruajtja e drejtpeshimit të kësaj fuqie dhe profilimit të multikulturalizmit si liri e shprehjes.

Ajo që mbetet brengë konstante kur analizojmë mediat në shoqëritë demokratike dhe pushtetit të atyre mediave, është pikërisht i ashtuquajturi inflacion i pushtetit mediatik, i cili për pasojë ka kundërefektin negativ, për arsye se jo rrallë ndodhë që të humb drejtpeshimi në qasjen objektive, ku mediatizimi i politikës po e nxjerr nga loja rolin e publikut në gjykimin individual. Këtë situatë më së miri e ka shpjeguar filozofi dhe politikologu i njohur Josep Ramoneda i cili në këndvështrimin e tij del se demokracia humb dendësinë e përmbajtjes së saj pikërisht nga roli i tepërt i televizionit, i cili e ka bërë politikën si "garë sportive". Të gjithë studiuesit e mediave dhe sidomos ata që bëjnë studime krahasimtare në mes të mediave klasike dhe atyre sociale, kanë ardhur në përfundim se ajo që duket në shikim të parë se media bën një lidhje më të fortë të qytetarit me politikën, duke rritur aftësinë ndërhyrëse të tij, nëse ky problem kundrohet pak më thellë, atëherë del se media, sidomos televizioni me lehtësinë e lidhjes së qytetarit me botën politike përmes ekranit dhe konsumit pasiv të politikës, e bën efektin e kundërt, duke zhdukur edhe atë pak gjë shoqërorizuese që ka mbetur në jetën politike. Por, kështu nuk është edhe me mediat sociale. (Bajrami D., Iseni A., 2015, f. 19). Për dallim nga mediat tradicionale, ku publiku kishte komunikim të njëtrajtshëm me aktorët e një ngjarjeje të caktuar, tek mediat sociale ky komunikim është interaktiv dhe gjithëpërfshirës. Zhvillimi teknologjik i mediave online ka mundësuar një transformim rrënjësor të publikut, sidomos mënyrën se si ne i mendojmë mediat. Fenomeni i mbajtjes në "kontroll" të mediave, sidomos në shoqëritë multietnike, ku diversiteti kulturor e gjuhësor

duhej të vinte më tepër në shprehje, kishte bërë nga mediat që të jenë institucione të pushtetshme që më tepër do t'u shërbenin konjukturave të caktuara politike, se sa publikut.

Mediat sociale po shikohen gjithnjë e më tepër si prioritet për diversitetin gjuhësor dhe kulturor. Qarkullimi i informacionit me një shpejtësi të shumëfishuar si dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun, bëri që mediat asociale të ndihmojnë procesin e komunikimit. Edhe në shoqëritë e hapura, sidomos ato me karakter multietnik, njerëzit e zakonshëm mund të mbledhin informacion, ta shpërndajnë dhe komentojnë, duke u bërë kështu pjesëmarrës aktiv në krijimin e demokracisë digjitale.

Në komunikimin publik e social, sot ndeshim përdorues pa kriter të mediave të reja, të cilët aspak nuk janë në funksion të profesionalizimit të mediave dhe komunikimit publik. Sot, gjithkush bën gazetarin dhe redaktorin nëpër media sociale, por askush nuk merr përgjegjësinë për efektet shpërdoruese të gjuhës, të lirisë pa kufi dhe cenimit të standardeve minimale profesionale. Vendosja pa kriter e materialeve e me një keqformim gjuhësor e profesional (ku zakonisht mungojnë rregullat drejtshkrimore dhe jo vetëm), është një model i keq dhe ndikon negativisht në publik. Ka rrezik që ky publik i ri, i cili formohet në këtë mënyrë, të jetë aq shumë i lidhur pas këtij 'realiteti', sa të humbë lidhjen e tij me realitetin e përditshmërisë. Për më tepër, ekziston mundësia që edhe të heqë dorë nga mediat tjera, të ashtuquajtura konvencionale, ndaj të cilave, edhe mund të tregojë një refuzim paragjykues. Ky lloj paragjykimi mund të kontribuojë që publiku të mbetet painformuar. Mbyllja brenda mureve të mediave virtuale, në planin e përgjithshëm nuk i ndihmon një formimi kulturor të publikut. Ndonëse, mund ta quajmë të rëndësishëm ndikimin e mediave sociale në vendosjen e disa standardeve të munguara teknologjike në mediat klasike, do të duhej të jetë i efektshëm edhe një ndikim kthyes - mediat klasike tek mediat sociale. Këtu, duhet të vijë në shprehje respektimi i standardeve themelore të informimit profesional (duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë, gjithëpërfshirshjes dhe burimeve të lajmit). Kjo para së gjithash se në shoqëritë multietnike, nuk mund të flasim për një publik, për shkak të ndërtimit të parametrave të ndryshëm kulturor, gjuhësor e fetar mbi një syprinë të përbashkët sociale dhe kjo ndikon që edhe receptimi mediatik të mos e ketë një platformë unike. Kjo specifikë e opinionit publik do të duhej të merrej si përparësi e jo si handikap. Një hapësirë publike e caktuar mund të jetë komplementare e një hapësire tjetër dhe kështu formimi i opinionit publik ka dinamizmin e vet social e

komunikues. Kjo është shumë e pranishme sidomos në komunikimin virtual ku njerëzit kanë nevojë të dalin nga 'dhomat e errëta' të vetmisë sociale dhe disa madje e lavdërojnë cyber hapësirën si mënyrën më të mirë të 'lirimit të shpirtit nga errësira e trupit'. (Groothuis, 1997)

Identiteti i medias në shoqëritë multietnike, siç proklamohet kjo e jona, paraqitet më kompleks, aq më tepër kur ka pririje të shumta të kontrollimit të hapësirës publike në gjuhën shqipe nga individë e grupime joshqipfolëse, të cilët anashkalojnë informimin profesional, duke e zëvendësuar atë me interesa të tjera jashtëgjuhësore e joprofesionale.

Promovimi i gjuhëve amtare

Në të gjithë botën, mendohet se fliten 6.000 gjuhë, por sipas parashikimeve deri në fund të shekullit 21, më shumë se gjysma e tyre nuk do të jenë më. Çdo dy javë shuhet nga një gjuhë. Thelbësore për mbijetesën e gjuhës është që ajo t'u transmetohet fëmijëve, të ketë mbështetje institucionale, të kultivohet në shkolla, media... Gjuha shqipe nuk është në rrezik. Është gjuhë që flitet nga disa miliona njerëz në botë. Është e standardizuar, me fjalorë, gramatikë dhe mbështetje institucionale.

Është i njohur modeli skandinav, ku ligjërohen shtatë ose tetë orë në javë. Në Greqi, gati nëntë orë ligjërim gjuhësor. Në hapësirën e Ballkanit Perëndimor deri në pesë orë në javë e më pak. Ndërsa, në shkollat profesionale thuaja gjuha është anashkaluar krejtësisht. Niveli i shkrim-leximit gjuhësor dhe kulturor nuk është shumë i kënaqshëm. Kështu, të paktën, kohë pas kohe paralajmërojnë studiuesit e linguistikës.

Sapir dhe studenti i tij Lee Whorf, kanë punuar në pozicionin teorik të njohur si hipoteza Sapir-Whorf, ku sipas tyre, gjuha që e flet një njeri përcakton nocionet e tij mbi realitetin. Pra, gjuha përcakton realitetin dhe ka përparësi mbi realitetin. Kjo, natyrisht, nuk nënkupton se dikush duhet vetëm të thotë: "Unë jam miliarder" dhe pastaj të bëhet miliarder, por faktin që gjuha strukturon perceptimin tonë të realitetit. "Qeniet njerëzore nuk jetojnë vetëm në botën objektive, e as vetëm në botën e veprimtarisë shoqërore siç kuptohet zakonisht, por janë shumë në mëshirën e gjuhës së veçantë e cila është bërë medium i shprehjes për shoqërinë e tyre. Është iluzion të imagjinojmë se dikush përshtatet në thelb pa përdorimin e gjuhës, e cila është thjesht një mjet i

rastësishëm për zgjidhjen e problemeve specifike të komunikimit ose të reflektimit. Faktin e çështjes është që 'bota reale' është në një masë të madhe të pandërgjegjshme deri në shprehitë gjuhësore të grupit. Asnjë dy gjuhë nuk janë mjaft të ngjashme për t'u konsideruar si përfaqësues të së njëjtës realitet shoqëror". (Sapir E. , 1929) (Sapir E. , 1949, f. 209) Gjuha nuk është vetëm një medium pasiv për artikulimin e mendimeve tashmë ekzistuese, por një formë e pashmangshme e këtyre mendimeve se pa gjuhë nuk mund të ketë as mendim. Pra, të menduarit tonë përcaktohet nga gjuha dhe sipas (...) relativitetit gjuhësor, njerëzit që flasin gjuhë të ndryshme e perceptojnë dhe mendojnë botën krejt ndryshe, pasi nuk ka kufizime në larminë strukturore gjuhësore. (Lyons, 1981)

Ndodhë që në përkthim të përdoren fjalë që nuk ekzistojnë në fjalorin e gjuhës amtare. Nuk është fjala për pak fjalë, por ato janë shtuar aq shumë, saqë vështirë se mund të ketë shkëputje nga kjo 'lidhje' e panatyrshme me fjalë të huaja, pa asnjë klasifikim. Fjalët renditen njëra pas tjetrës, duke e humbur kuptimin. Si duket, kjo është rezultat i mungesës së shprehisë së leximit dhe i mosnjohjes së rregullave gjuhësore. Sidomos, gjatë përkthimit, një fjalë që nuk është lexuar e mësuar kurrë, do të mungojë në përkthim, e që ia humbë tërë kuptimin fjalisë. Dhe, jo rrallë përkthyesve u vjen më lehtë që të përdorë fjalë ashtu siç janë shkruar në origjinal. Cook konsideron se për shumicën e nxënësve bashkëkohorë, përkthimi duhet të jetë qëllim dhe mjet kryesor për mësimin e gjuhës dhe masë kryesore për sukses. (Cook, 2010, f. xv)

Shpesh dëgjojmë edhe deklarata politikanësh që aspak nuk i thonë fjalët në frymën e gjuhës amtare, prandaj ndodh që dëgjuesi edhe të mos i kuptojë ato fjalë. Me të drejtë, Mulaku dhe Hoxha, theksojnë se "shumica e fjalëve të huaja (...) e të panevojshme hyjnë në gjuhën tonë prej gjuhës së shkrimit, kryesisht nga përkthimet e teksteve politike, ekonomike, informative, zhurnalistike, teknike etj". (Mulaku L., Hoxha Sh., 2003, f. 49).

Gjuha me të cilën sot shërbehemi në punën me kompjuter ose lojërat kompjuterike bartë me veze një realitet krejtësisht ndryshe, ku pothuajse të gjitha fjalët janë me prejardhje të huaj. Madje, edhe ato pak fjalë të gjuhës amtare që janë nuk po arrihen të shqiptohen si e sa duhet. Ekziston bindja se këto fjalë dhe shprehje nuk mjaftojnë, prandaj nuk do të kishte ndryshuar asgjë. Duke qenë të vetëdijshëm se gjuha e përdorur në teknologjitë e informacionit, si dhe emrat e tyre janë aq globale saqë është vështirë për t'u ndryshuar në gjuhën amtare, në cilëndo gjuhë qoftë. Në një rast, drejtorja e përgjithshme e UNESKO-s, Irina Bokova,

kishte theksuar se teknologjitë e reja sigurojnë mënyra të reja për përcjellje, hulumtim dhe mësim të gjuhëve dhe se suksesi nga botimi elektronik i Atllasit të UNESKO-s për gjuhët e rrezikuara në botë është tregues se sa i fuqishëm është interneti për përcjelljen e gjendjes së gjuhëve dhe shumëgjuhësisë, si dhe për ngritjen e vetëdijes së opinionit në një shtrirje globale për këtë çështje. Dua të ndaj bindjen me të se, "teknologjitë e informimit dhe komunikimit mund të jenë, posaçërisht të dobishme për promovimin e gjuhëve amtare. Duhet ta shfrytëzojmë fuqinë e përparimit që t'i ruajmë shfaqjet e llojllojshme në botë dhe t'i promovojmë të gjitha burimet dhe format e shprehjes. Ato janë fijet nga të cilat është qëndisur tapiceria - rrëfimi i njerëzimit". (UNESDOC, 2019)

Gjithashtu, duhet rënë dakord me pikëpamjet e të gjithë atyre që thonë se nuk duhet të kihen parasysh sferat abstrakte dhe shkencore, ku gjuha dominante e fjalëve është me origjinë greke dhe latine, sepse një situatë e tillë është e pranishme te të gjitha gjuhët. Në gjuhë, në fakt, vepron një numër i madh i internacionalizmave, që nuk kanë zëvendësim të mirë, apo të mjaftueshëm në terma dhe shprehje përkatëse në gjuhën amtare, që shpesh sjellin telashe edhe gjatë përkthimit nga një gjuhë në gjuhën tjetër. E njëjta gjë vlen edhe për fjalët që përdoren në shqip për aq kohë saqë ato bëhen pjesë e përditshmërisë sonë leksikore, edhe pse ekzistojnë fjalë të ngjashme ose ekuivalente me origjinë shqipe. Fondi leksikor gjuhësor i shqipes, padyshim që ka zgjidhje adekuate, ndoshta jo për të gjitha fjalët, por për një numër sosh po. Megjithëkëtë, "huamarrja" e fjalëve shfaqet si një domosdoshmëri, jo vetëm në gjuhën shqipe dhe jo vetëm kohët e fundit. Me fjalët e huaja duhet bërë kujdes, prandaj përdorimin e tyre duhet kufizuar sikurse me 'mëlmesat' në ushqim, vetëm aq sa të na mjaftojnë për shije, pa e tepruar.

Ekziston një parim universal se drejtshkrimi duhet të zbatohet për këdo që flet një gjuhë, qoftë gjuhë amtare, qoftë gjuhë e huaj. accurate spelling relies on the use of multiple sources of phonological, orthographic and morphological linguistic information. (Treiman, R., Bourassa, D.C., 2000) Drejtshkrimi si normë gjuhësore, njëkohësisht duhet të jetë edhe normë e detyrueshme ligjore. Në mënyrë të veçantë në shkolla, universitete, në administratën publike dhe shtetërore dhe gjithkund në shtet, sidomos në komunikimin zyrtar, por edhe në gazeta, revista, radio dhe televizion e në mediat sociale. Por, rrallë ndodh ose kurrë të shohësh të jetë shkruar diç. ku është zbatuar drejtshkrimi i gjuhës shqipe, ashtu si duhet, me përjashtim të revistave shkencore gjuhësore dhe atyre profesionale. Nuk janë të pakta rastet ku edhe vetë

institucionet shtetërore nuk e respektojnë atë. Gjuhët dhe sidomos gjuha shqipe, nuk respektohen, edhe përkundër sanksioneve ligjore e kushtetuese. Shpresat janë se institucioni i cili është angazhuar për kujdesin ndaj përdorimit të gjuhës, pra, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e flasin së paku 20 për qind e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut., do ta shmangë këtë rrëmujë e do të këmbëngulë në respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, që e nënkupton edhe respektimin e rregullave gjuhësore (gramatikore) në komunikimin zyrtar. Vetëm kjo qasje do t'u ndihmonte gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera në shoqëritë shumëgjuhësore, duke parandaluar situatat paradoksale gjuhësore, ku siç duket tashmë kanë krijuar njëfarë tradite të shkeljes së normës gjuhësore.

Në Ligjin për përdorimin e gjuhëve thuhet: "Në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë (së Veriut) nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat tjera". (Gazeta Zyrtare, 2019) Ky fakt tregon se institucionet duhet të jenë të parat që duhet ta zbatojnë gjuhën. Ndër të tjera, është i rëndësishëm krijimi i rregulloreve për respektimin e gjuhës amtare, duke ndjekur rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore, si çështje me interes për zhvillimin e vlerave estetike dhe etike në komunikim përmes gjuhës.

Gjuha dhe drejtshkrimi që të zbatohen me sukses, duhet të ekzistojë një qëndrim i qartë institucional ndaj gjuhës amtare që gjithsesi çon në respektimin e vlerave të bashkësive të ndryshme kulturore e gjuhësore dhe, natyrisht, pastaj i kontribuon fuqizimit dhe jetësimit të shoqërisë multikulturore. Dëgjimi, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit përbëjnë kompetencën gjuhësore dhe komunikuese, që duhet të zhvillohet në të gjitha fushat, si aftësi për të identifikuar marrëdhëniet midis kulturave në jetën e përditshme. Para së gjithash,

normat gjuhësore në shkrim dhe të folur ndikojnë në njohjen më të mirë midis vete, duke shmangur gjuhën e urrejtjes. Kultura e shprehjes dhe krijimtarisë, ndër të tjera, inkurajon kreativitetin, kuriozitetin intelektual, debatin argumentues, të menduarit ndryshe dhe nxit lirinë e shprehjes.

Shqyrtime përmbyllëse

Mediat sociale në shekullin 21, ku kemi të bëjmë me një nivel të ri të edukimit mediatik, ende nuk janë në gjendje që t'u ofrojnë mundësi qytetarëve për të ndërtuar një qasje kritike rreth proceseve sociale, komunikimit dhe ndërveprimit në një shoqëri multikulturore, duke u bazuar në standardet e informimit profesional.

Mediat masive (mediat sociale dhe mediat konvencionale), do të duhej ndjekur një qasje sistematike në informim, sepse siç dihet mediat mund të formojnë formojmë një perceptim pozitiv të publiku lidhur me problematika të rëndësishme për shoqëritë multikulturore, ku diversiteti kulturor e gjuhësor duhet të vijë më tepër në shprehje.

Ka kaluar një kohë e gjatë duke shkruar në trajta e forma tepër negative dhe me përmbajtje barbarizmash që në vetvete e gjithë kjo përbën paradigmën e mangësisë gjuhësore. Neutralizimi dhe kundërshtimi i këtyre formave, do të kishte kuptim dhe do të bënte të mundur që të kthehej 'pastërtia' gjuhësore. Respektimi i normës gjuhësore nuk është vetëm punë e një njeriu, apo e një grupi, por kujdesi për gjuhën duhet vendosur në planin e institucioneve shtetërore dhe këtu, s'ka kompromis. Pra, askush nuk është i amnistuar nga mosrespektimi i drejtshkrimit të gjuhës amtare. Por, edhe askush nuk është i autorizuar të fusë barbarizma brenda gjuhës amtare.

Përfundimi logjik do të jetë se gjuha dhe drejtshkrimi i shqipes vetëm në pak mjedise është duke u respektuar. Krijimi i institucionit, i cili tani e tutje do të ushtrojë kujdesin ndaj gjuhës, siç është Agjencia e zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20 për qind e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, së bashku me organet përcjellëse të kësaj agjencie, si inspektorati etj., pritet të ndërmarrë veprime ndaj atyre subjekteve që nuk i përmbahen Ligjit për gjuhët, me qëllim që të ndërpritet praktika e moszbatimit të rregullave gjuhësore.

Literatura e shfrytëzuar:

Bajrami D., Iseni A. (2015). Mediat e reja si dimensioni më përfshirës mediatik i multikulturalizmit në komunikimin publik. *International Conference on Literature, Linguistics and Interdisciplinary Studies* (fv. 15-29). Tetovo: Info Media Group & Anglisticum Journal.

Banting K., Kymlicka W. (2006). *Multiculturalism and the welfare state: recognition and redistribution in contemporary democracies, Oxford University.* Oxford: Oxford University Press.

Beacco J-C., Byram M. (2007). *Guide for the development of language education policies in Europe: from linguistic diversity to plurilingual education (version 1, 2003).* Strasbourg: Council of Europe Publishing.

Cook, G. (2010). *Translation in Language Teaching: An Argument for Reassessment.* Oxford: Oxford University Press.

Gazeta Zyrtare. (2019, 01 14). Ligji për përdorimin e gjuhëve. Shkup.

Groothuis, D. (1997). *The soul in syberpace.* Michigan: Baker Books.

Lyons, J. (1981). *Language and linguistics: An introduction.* Cambridge: Cambridge University Press.

Mulaku L., Hoxha Sh. (2003). *Kulturë e gjuhës.* Prishtinë: Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës.

Sapir, E. (1929). The status of linguistics as a science. *Language*, 207-214 Vol. 5, iss. 4.

Sapir, E. (1949). *Selected writings of Edward Sapir in language, culture, and personality, Mendelbaum, D.G. (Ed).* Berkeley and Los Angeles: University of California Press.

Treiman, R., Bourassa, D.C. (2000). The development of spelling skill. *Topics in Language Disorder*, 20, 1–18.

UNESDOC. (2019, 11 10). *unesdoc.unesco.org.* Gjetur në unesdoc.unesco.org: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000191071

Asllan HAMITI[49]

SFIDAT E PËRKTHIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të shumta. Po të vështrojmë tekstet e përkthyera nga shqipja në gjuhë të tjera si dhe nga gjuhët e tjera në shqip po edhe interpretimet (simultane, konsekutive) shpërfaqen shumë probleme të natyrave të ndryshme. Në një paraqitje të shkurtër është e pamundur të përmenden të gjitha. Por, me këtë rast ne do të përpiqemi t'i përmendim vetëm disa nga problemet madhore që i kemi hetuar në përkthimet maqedonisht-shqip e anasjelltas:

1. **Arsimi jocilësor parauniversitar e universitar në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Konstatim i përgjithshëm është se ne kemi arsim jocilësor. Për këtë gjendje të pamirë fajtor jemi të gjithë. Këtu mund të përfshihen planet e programet mësimore jo të përshtatshme për nxënësit e studentët e kohës sonë, tekste të dobëta shkollore, kushtet jo të mira hapësinore dhe mospasja e mjeteve mësimore, pagat e ulëta të mësimdhënësve, punësimet jo sipas kriterit të cilësisë, mungesa e shprehisë për të lexuar tekste e vepra me vlerë që sjell kufizime në kulturën e përgjithshme të rinisë sonë si dhe në kulturën e dobët gjuhësore, duke mbjellë analfabetizmin funksional dhe jo rrallë duke prodhuar analfabetë me diplomë. Thjesht, të rinjtë e të rejat tona nuk janë të motivuar për të nxënë dituri që më pas të merren me punë intelektuale, por shpresojnë të dalin jashtë vendit për një jetë materiale më të mirë. Si përfundim, sistemi i keq arsimor prodhon kuadro të dobëta, përfshirë edhe përkthyesit.

2**. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare**

"Gjuha më mirë se gjithçka tjetër jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe." Janë këto fjalët e Ismail Kadaresë që të ftojnë të reflektosh rreth asaj që po ndodh me gjuhën shqipe, e përkufizuar si pasqyra e kulturës dhe e kombit tonë.

---

[49] Prof. dr. Asllan Hamiti, mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare.

Shpërfillja e shqipes është vetëm njëri nga problemet e shumta serioze të shoqërisë shqiptare. Konstatim i përgjithshëm është se në Maqedoninë e Veriut kemi pak njerëz që dinë ta flasin e ta shkruajnë shqipen ashtu si duhet. Problemi më i madh në përdorimin e shqipes standarde lidhet me kulturën e dobët gjuhësore, sidomos e brezit të ri. Mosnjohja e mirë e gjuhës amtare, ka të bëjë me mangësi të rënda në arsimin bazë, por edhe me mungesën e leximit, krahas me mospërpjekjen për të pasuruar ligjërimin dialektor, ndikimin e gjuhëve të huaja dhe krijimin e brezave dy- a trigjuhësh.

Për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë duhet kushtrimuar të gjithë: institucionet arsimore, nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, mjetet e informimit dhe e gjithë shoqëria. Propozim i përgjithshëm i gjuhëtarëve është që lëndë të kulturës së gjuhës të mësohen si të domosdoshme në të gjitha fakultetet në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut. Ai (mjeku, ekonomisti, gjykatësi, gazetari, përkthyesi, ...) që flet e shkruan mirë, ka shumë sukses në jetën dhe në punën e tij.

Në dallim nga ligjërimi i shkujdesur dhe bisedor, që përvetësohen lehtë nga komunikimi i përditshëm; ligjërimi libror kërkon një përgatitje paraprake arsimore e kulturore si dhe një përvojë të nevojshme gjuhësore. Nuk mund të kemi përkthyes të mirë me njohjen e ligjërimit të shkujdesur e atë bisedor, pa njohjen e ligjërimit libror.

Shqipja e sotme, si edhe çdo gjuhë tjetër e gjallë, është tërësi: a) variantesh historike, b) variantesh territoriale, c) variantesh stilistike dhe ç) variantesh shoqërore. Përkthyesi duhet të njohë mirë të gjitha këto larmi gjuhësore të dy gjuhëve të punës. Ai, si edhe çdo intelektual tjetër, duhet të njohë mirë gjuhën standarde, që është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të qytetërimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar.

Gjuha standarde jeton e vepron në trajtën e stileve funksionale. Funksioni dhe përshtatja e ligjërimit sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë stileve funksionale: stili i veprimtarisë shkencore e teknike, shtetërore e administrative, shoqërore e politike, stili i veprimtarisë letrare artistike dhe stili i veprimtarisë fetare. *Përkthyesi duhet të dijë karakteristikat e stilit të tekstit që përkthen.* Fjala vjen, po të dojë të përkthejë një tekst që i takon stilit shkencor, përkthyesi duhet të ketë parasysh se stili shkencor karakterizohet nga të shprehurit e drejtë logjik, nga saktësia e përdorimit të termave, nga

qartësia e thënies etj. Tipike për të janë informacioni, logjika, objektiviteti dhe saktësia.

3. **Mosrespektimi dhe mosnjohja e tjetrit**

Maqedonia e Veriut është shtet shumënacional e shumëgjuhësor, por etnitetet janë shumë të mbyllur në vete, kanë paragjykime për tjetrin që shprehet gjithkund, si në tekstet mësimore, në mjetet e informimit, në jetën e përditshme etj. Përkthyesi duhet të ketë njohuri të përgjithshme, të njohë shumë mirë gjuhën burimore dhe gjuhën e synuar së bashku me kulturat që lidhen me to si dhe njohuri të thelluara në fushën që përkthen (ekonomi, drejtësi, letërsi, art, sport etj.).

Mbyllja vetëm në guaskën e vet sjell izolim, mosnjohje të mjaftueshme të kulturës së tjetrit që ka për pasojë edhe probleme të shumta e të pakapërcyeshme përkthimore. Në këtë kuptim, nxënësit shqiptarë maqedonishten e kanë lëndë të domosdoshme dhe fillojnë ta mësojnë që nga klasa e tretë e deri në studime, ndërsa shqipja për joshqiptarët në R. e Maqedonisë së Veriut ka statusin e gjuhës fakultative vetëm në tri vitet e arsimit fillor (nga klasa VI-IX).

Të paktë janë joshqiptarët që përcaktohen të mësojnë shqipen (në shkollë, në kurse apo edhe në fakultet). Njohësit e mirë të shqipes me gjuhë amtare maqedonishten do të ishin më të suksesshëm në përkthimet nga shqipja në maqedonisht.

Do të ishte mirë që të ndiqen edhe te ne modelet më të mira të vendeve shumëgjuhësore, përkatësisht gjuha shqipe të jetë lëndë mësimore e domosdoshme edhe për joshqiptarët në arsimin parauniversitar.

4. **Mosnjohja e teorisë së përkthimit dhe mosmbështetja në praktikën e deritashme të përkthimit**

Të paktë janë ata përkthyes në Maqedoninë e Veriut që njohin si duhet teorinë dhe teknikën e përkthimit e të interpretimit, veglat teknike dhe aplikacionet ndihmëse. Zaten, nuk kemi as specialistë për të trajnuar studentët për këtë fushë. Nga ana tjetër, përkthimi e interpretimi nga shqipja në maqedonisht e në kahun tjetër ka një traditë disavjeçare. Për shumë fjalë e terma tani më janë gjetur gjegjëset përkatëse, prandaj përkthyesit e sotëm duhet lexuar e parë për të zgjidhur mëdyshjet a hezitimet për ndonjë variant përkthimi.

Pra, për të lehtësuar punën, për të siguruar njëtrajtësinë e për të ndihmuar standardizimin e njërit nga variantet e mundshme përkthimore nga gjuha A në gjuhën B, përkthyesi duhet të mbështetet në

praktikën përkthimore jo vetëm nga një gjuhë në shqip, po edhe nga gjuhët e tjera jo të punës.

5. **Mosinteresimi i institucioneve për të siguruar përkthyes të mirë**

Në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup, kemi një katedër përkthimi e interpretimi me gjuhët e mundshme kombinimi: maqedonisht, anglisht, frëngjisht; si edhe në grupet përkatëse me programe të veçanta përkthimi. Në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare, ku edhe jam pedagog, kemi Grupin e përkthimit shqip-maqedonisht për a) studentë që shqipen e kanë gjuhë amtare dhe për b) studentë që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare.

Si punonjës i këtij institucioni lirisht mund të them se organet përkatëse nuk kanë bërë asnjë investim për të siguruar kushtet e nevojshme për punë të suksesshme: mungojnë pajisjet teknike, laboratori i interpretimit, mospunësimi i kuadrit të specializuar, mungesa e literaturës së nevojshme, probleme të organizimit të punës praktike për përkthim e interpretim në institucionet përkatëse si dhe shumë probleme të tjera.

Problemet e përgjithshme në arsim, mosinvestimi e mosinteresimi i institucioneve përkatëse për traduktologjinë në Maqedoninë e Veriut, mungesa e programeve të mirëfillta të përkthimit, puna stihike pa planifikim e pa strategji zhvillimi ka sjellë shumë zbrazëtira në përgatitjen e studentëve që të integrohen në tregun e punës pas përfundimit të studimeve.

6. **Mungesa e konsultimit dhe e punës ekipore në procesin e përkthimit**

Në praktikën e deritashme të përkthimit e të interpretimit shqip-maqedonisht e anasjelltas ka munguar konsultimi profesional si dhe puna ekipore. Kanë përkthyer shumëkush për arsye komerciale, me nguti, ndonjëherë pa e rilexuar e përmirësuar përkthimin, pa përvojën e kompetencën e nevojshme gjuhësore, pa konsultimin me profesionistë të fushës; pra përgjithësisht pa respektuar fazat e nevojshme të procesit të përkthimit. Kemi vetëm pak përkthyes të mirë shqip-maqedonisht e anasjelltas, por edhe më pak interpretues. Shumica e teksteve të përkthyera janë botuar e po botohen pa redakturë profesionale, redakturë gjuhësore, lekturë apo korrekturë.

Zaten, edhe teksti i shkruar në gjuhën amtare, qoftë edhe nga njohësit e mirë të gjuhës apo edhe shkrimtarët, duhet të rimerret disa herë për ta sjellë atë në nivelin e kënaqshëm. Në ligjërimin e shkruar ka

kohë të gjatë të mendohet ajo që thuhet, të zgjidhet forma e shprehjes, të rishikohet ajo që është thënë, të ndreqet e të rregullohet.

Kontrollimi përfundimtar shërben si një provë e cilësisë së përkthimit, në veçanti nëse teksti është i qartë, i shkruar në shqipen standarde dhe që lexohet sikur të ishte hartuar fillimisht në gjuhën shqipe. Në të gjitha rastet kur përkthyesi ka dyshime të caktuara, ai duhet ta përgatisë një listë pyetjesh për redaktorët gjuhësorë dhe për ekspertët e fushës. Edhe pse të tre pjesëmarrësit kryesorë (përkthyesi, eksperti i fushës, redaktori gjuhësor) punojnë veç e veç në procedurën e përkthimit, rezultatet më të mira arrihen kur ka ndërveprim ndërmjet tyre.

7. **Mosnjësimi (jostandardizimi) i shumë termave në shqipen**

Siç dihet, gjuhët kanë fjalë të përdorimit të përgjithshëm si dhe fjalë të specializuara në fusha të caktuara të veprimtarisë njerëzore, përkatësisht terme (si p.sh. në mjekësi, jurispodencë, ekonomi, fizikë, matematikë, astronomi, art, sport,...). *Pjesa e leksikut të përgjithshëm mund të bjerë deri përgjysmë*. *Gjysma tjetër i takon leksikut shkencor.* Bërthamën e leksikut shkencor e përbëjnë termat. Ato kanë dallime nga fjalët e zakonshme, pasi në vend të kuptimeve (kuptimet janë një përgjithësim nga përvoja njerëzore dhe përcaktohen brenda sistemit gjuhësor) shënojnë nocione (nocionet janë rezultat i njohjes shkencore dhe përcaktohen në sistemin e secilës disiplinë).

Fjalët e përgjithshme, kur kthehen në terma, ripërkufizohen, si p.sh. *uji* për gjeologjinë është *mineral i lëngët, vetëtimat* ose *rrufetë* në gjuhën teknike njihen me termin *shkarkim elektrik,* shfaqje të elektricitetit; *ngjeshja* apo *fërkimi* i trupit në mjekësi njihet me *masazhë, verdhëza* në mjekësi emërtohet me *hepatit C, ndezja e mushkërive* me *bronhit* e *asmë, dhëmbi* në mjekësi njihet me termin *dentes, buzët* janë *labia;* në mjekësi thuhet *i sëmurë psikik* dhe në asnjë mënyrë *i çmendur*, *spital neuropsikiatrik* dhe jo *çmendinë* etj. Një pjesë e madhe e termave janë nga terminologjia ndërkombëtare.

Përkthyesit gjenden shumë më lehtë me leksikun e përgjithshëm, por kanë vështirësi të mëdha në përdorimin e termave. Terminologjia shqipe në disa fusha të veçanta ende nuk është konsoliduar sa duhet apo edhe nuk është standardizuar. Për shkak të specifikave të sistemit juridik, administrativ etj. në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut përdoren edhe terma të ndryshme që kanë kuptim të ngjashëm a të përafërt. Përkthyesi përballet edhe me këtë vështirësi të larmisë së përdorimit të termave, përkatësisht të mosstandardizimit të tyre në nivelin kombëtar. Njësimi i termave në shqipen mbetet si një ndër

detyrat më të rëndësishme të planifikimit dhe të politikës gjuhësore mbarëkombëtare.

8. **Mungesa e fjalorëve terminologjikë**

Procesi i përkthimit kalon nëpër tri faza kryesore: faza e parë është leximi dhe analiza e tekstit; faza e dytë është evidentimi dhe paraqitja e termave dhe e nocioneve të panjohura, dhe faza e tretë është kërkimi i barasvlerësve. Studentëve dhe përkthyesve të rinj u rekomandohet që të ndjekin këtë rend pune dhe të mos nisin përnjëherë përkthimin mekanik. Përdorimi i termave është sfida më e madhe e përkthyesve.

Deri më tani janë hartuar disa fjalorë të leksikut të përgjithshëm shqip-maqedonisht e anasjelltas, ku mund të gjejmë të shënuar edhe ndonjë term. Janë botuar edhe disa fjalorë terminologjikë gjuhë e huaj-shqip e anasjelltas, por mungojnë fjalorët e mirë terminologjikë shqip-maqedonisht ose në kahun tjetër. Për më tepër, përkthyesit nuk duhet të mendojnë se do të gjejnë gjithçka në fjalorë. Një fjalor i mirë duhet t'u përgjigjet kritereve të besueshmërisë, dobisë dhe të jetë sa më shterues. Fjalorët e tillë janë të rrallë ndër ne.

Në kushte të tilla, përkthyesi duhet të jetë i përgatitur t'i përballojë problemet e reja e të shumta dhe nocionet e pahasura më parë. Përkundër përpjekjeve modeste të bëra në hartimin e fjalorëve terminologjikë për fusha të caktuara nga disa autorë, nuk ka përpjekje institucionale për hartimin e fjalorëve të këtij lloji në shqip. Hartimi i fjalorëve terminologjikë të shqipes është detyrë tjetër e rëndësishme në përballjen e shqipes me gjuhët e tjera dhe në sfidat që sjell procesi i globalizimit.

9. **Na mungojnë përkthyesit e specializuar**

Si në çdo fushë të veprimtarisë, edhe në përkthim ka a) përkthyes të përgjithshëm dhe b) përkthyes të specializuar për një lëmi të caktuar (për fushën juridike, ekonomike, artistike, letrare, ...), që mund të jenë specialistë, ekspertë dhe mjeshtër përkthimi.

Është e udhës që përkthyesit të specializohen në një fushë ose në disa fusha të përafërta dhe të formojnë grupet e tyre të ngushta të komunikimit me ekspertë të fushës dhe me gjuhëtarë, në mënyrë që përkthimi të jetë cilësor dhe që të parandalohen problemet e mëvonshme që mund të shkaktohen nga një përkthim i pasaktë.

Aftësitë kryesore të një eksperti përkthyes janë: të qenët analitik, të ketë aftësinë e të menduarit kritik, të lexuarit ndërmjet rreshtave, të

zotërojë mjetet gjuhësore të nevojshme për t'u shprehur saktë dhe drejt në secilën nga gjuhët e punës, mundësia për të kuptuar zhargonin dhe terminologjinë e përdorur në tekstin në gjuhën burimore dhe në gjuhën e synuar etj. Mjeshtrit përbëjnë grupin e elitës, gjykimet e të cilëve përcaktojnë rregullat, procedurat, standardet ose idealet.

10. **Ngritja e një qendre për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të shqipes**

Punën e lektorit të shqipes deri më tani e kanë kryer ata që kanë mbaruar fakultetin e gjuhës e të letërsisë shqiptare. Praktika ka dëshmuar se jo të gjithë kandidatët që marrin diplomën e këtij fakulteti janë edhe lektorë të mirë. Nuk kemi asnjë qendër për dhënien e licencës për lektor as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoni. Për licencimin e lektorëve të maqedonishtes ka një qendër të tillë në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup. Lektorët e shqipes do të duhet të punojnë në çdo institucion ku përdoret shqipja ose së paku çdo shkrim në shqip, përfshirë edhe përkthimet, duhet doemos të kalojë nëpër duart e lektorit të licencuar.

11. **Përkthyesit e mirë do të jenë shumë të kërkuar**

Në epokën tonë të telekomunikacioneve dhe të internetit, komunikimi shumëgjuhësh është përditshmëri jona. Globalizimi dhe përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për t'u bërë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian, e bëjnë profesionin e përkthyesit shumë të kërkuar. Përkthimi nga maqedonishtja në shqip e anasjelltas është zgjeruar mjaft dhe do të zgjerohet edhe më tej me Ligjin për Zbatimin e Gjuhëve, me vajtje-ardhjet Shqipëri, Kosovë - Maqedoni, komunikimin dhe bashkëpunimin institucional të Maqedonisë së Veriut me Shqipërinë e Kosovën. Andaj, edhe pse tani përballen me shumë vështirësi, përkthyesit dhe interpretuesit e mirë do të jenë mjaft të kërkuar në tregun e punës.

Për të siguruar përkthime cilësore, përballjen e shqipes me gjuhët e tjera më të lëvruara do të na duhet shumë punë për të bërë. Këtë shqipe të fituar me gjak e me djersë duhet ta ruajmë edhe ne, si dhe t'ua lëmë trashëgim pasardhësve tanë, si elementin më të rëndësishëm të qenies sonë kombëtare. Po të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj paraardhësve tanë si dhe obligimin që kemi ndaj brezave që vijnë, do të dimë çfarë qëndrimi duhet të kemi e çfarë duhet të bëjmë për gjuhën shqipe. Nëse nuk mund të bëjmë më shumë për shqipen, atëherë së paku të mos e harrojmë, shpërfillim, përziejmë, shtrembërojmë, ndotim e prishim.

Kemi trashëgimi të pasur materiale e shpirtërore, të cilat duhet t'i ruajmë, t'i kultivojmë, t'i pasurojmë e t'i përditësojmë. Meqë kemi tokën tonë shumë pjellore (shqipen), të trashëguar për mijëra vjet nga paraardhësit tanë, atë duhet ta lëvrojmë, ta ujisim, mirëtrajtojmë e mirëmbajmë dhe toka jonë (shqipja) do t'i plotësojë të gjitha nevojat tona. Atë që do të na mungojë (e nuk mundemi pa të) do ta marrim nga të tjerët.

Do të jemi të hapur me të gjithë popujt, gjuhët e kulturat e botës. Për sa i përket terminologjisë, thotë prof. Gjovalin Shkurtaj, të gjitha gjuhët marrin terma e fjalë nga gjuhët e tjera, sidomos nga anglishtja dhe gjuhët e mëdha të Evropës, porse *shqipja po merr më shumë*. Një pastrim patjetër që mund dhe duhet të bëhet.

Në gjuhë, p.sh. përparësi duhet t'u japim elementeve anase të shqipes, mandej ndërkombëtarizmave si dhe huazimeve që tani më janë mishëruar në shqipen. Ka edhe shumë fjalë të huaja që nuk e kanë fituar ende statusin e qytetarisë (shtetësisë) në shqipen e që lehtësisht mund të zëvendësohen me fjalë që i ka ose me fjalëkrijime të reja.

Në gjuhësi janë të njohura rrugët e pasurimit të leksikut: nga leksiku popullor, nga veprat letrare, nga mundësia e pashtershme e krijimit të fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës e me mënyra të shumta fjalëformimi (me parashtesim, prapashtesim, parashtesim e prapashtesim njëherazi, nyjëzim, kompozim, përngjitje etj.). *Edhe përkthyesit e mirë mund ta pasurojnë shqipen me fjalë, shprehje, terma, frazeologji librore e me struktura të reja sintaksore.*

Përkthyesi duhet ta bëjë punën në mënyrën më të mirë të mundshme, me shumë vullnet, përkushtim, ndërgjegje, kujdes e përgjegjësi. Përkthimi i keq sjell keqkuptim, mosmarrëveshje dhe e prish gjuhën; ndërsa përkthimi i mirë sjell komunikim korrekt, mirëkuptim, harmoni e paqe midis njerëzve dhe e pasuron gjuhën.

Do të bëhen mjeshtër përkthimi ata që flasin dy gjuhë që në fëmijëri, do të përcaktohen që në rini për profesionin e përkthyesit, do të kenë arsim cilësor, do të arrijnë nivel të lartë kompetence gjuhësore të të dy gjuhëve, do të lexojnë e studiojnë me përkushtim, do ta duan këtë profesion fisnik, do ta kenë të zhvilluar të menduarit kritik e krijues, do të zotërojnë aftësinë e shkrimit akademik dhe do të jenë të gatshëm të përballen me të gjitha sfidat e kësaj veprimtarie intelektuale.

Literatura e shfrytëzuar:

Hajdari – Qamili, Ajten, *Perla gjuhësore,* Shkup, 2018.

Hamiti, Asllan, *Leksikografia shqip-maqedonisht e anasjelltas,* Albanologjia 1-2/2014, Tetovë, 2014, f. 108-114.

Hamiti, Asllan, *Niveli metodologjik i gramatikave të gjuhës shqipe,* Seminari XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2011, 301-308.

Hamiti, Asllan, *Gjuha e teksteve shkollore të kimisë të arsimit fillor në Maqedoni, Seminari* V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë – Shkup, 3-4 tetor 2011, f. 47-51.

Hamiti, Asllan, *Gjuha në mjetet e informimit publik në Maqedoni,* Scupi 2, "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare (Konferencë Shkencore, Shkup, 13. 06. 2012), Shkup, 2012, f. 71-86.

Hamiti, Asllan, *Diglosia në Maqedoni dhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe,* Kumtesat nga Konferenca vjetore e shkencës "Java e Shkencës 2012", mbajtur në Prishtinë, më 16-19. 05. 2012, f. 187-190.

Hamiti, Asllan – Osmani, Ismet, *Për standardizimin e termave juridike e administrative në gjuhën shqipe*, Takimi XI vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca, Tiranë, 1-2 shtator, 2016.

Hamiti, Asllan, *Kultura e gjuhës për të gjithë,* Shkup, 2018.

Shkurtaj, Gjovalin, *Kultura e gjuhës,* ShBLU, Tiranë, 2006.

Shkurtaj, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip,* Toena, 2008.

Shkurtaj, Gjovalin, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran,* ShBLSh,Tiranë, 1988.

Shkurtaj, Gjovalin, *Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur,* ShBLSh, Tiranë, 1998.

Shkurtaj, Gjovalin, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe,* Tiranë, 2003.

Shkurtaj, Gjovalin, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura,* Gjuha jonë 1-2, Tiranë, 2000.

Shkurtaj, Gjovalin, *Urgjenca gjuhësore,* Naimi, Tiranë, 2017.

Zeqirija IBRAHIMI[50]

PROBLEMET E PËRDORIMIT ZYRTAR TË SHQIPES STANDARDE NË MAQEDONI

Pas miratimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve (më 11 janar 2018), që në fakt i referohet përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është hapur mundësia që në një sërë institucionesh shtetërore dhe lokale të përdoret edhe gjuha shqipe, krahas maqedonishtes.

Ndonëse ky ligj nuk e bën barazinë e plotë të shqipes me maqedonishten, ngase shqipja mund të përdoret në komunikim zyrtar vetëm krahas maqedonishtes, ky nuk është problemi i vetëm. Emërtimet e institucioneve qendrore, përkthimet e fletores zyrtare të shtetit, terminologjia, mungesa e fjalorëve, mungesa e aplikacioneve elektronike, por edhe mungesa e kuadrove të profesionalizuara, janë të gjitha probleme që presin të zgjidhen dhe për këtë nuk janë të mjaftueshme vetëm institucionet arsimore dhe shkencore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Maqedonia e Veriut dhe modelet e planifikimit gjuhësor.

Sipas Ranko Bugarskit, në Europë fliten 100-200 gjuhë,[51] ndërsa sipas Miquel Siguan-it[52], diku 50 gjuhë (dallimi krijohet për atë se çfarë paraqet gjuhë dhe dialekt), që sipas këtij të fundit mund të kategorizohen në 5 tipa kryesorë të modeleve të shteteve në bazë të politikave gjuhësore[53]:

1) Shtete njëgjuhëshe – siç janë Franca dhe Portugalia; ato njohin vetëm një gjuhë standarde, pavarësisht se mund të ketë edhe etni dhe gjuhë të tjera;
2) Shtete që i pranojnë gjuhët e pakicave – në këto shtete pranohet vetëm një gjuhë nacionale standarde, ndërsa njihet edhe prania e

[50] Prof. dr. Zeqirija Ibrahimi, punonjës shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

[51] Ranko Bugarski, Jezik i kultura, XX vek, Beograd, 2005, f. 95.
[52] Miquel Siguan, *Jezici u Europi,* Školska knjiga, Zageb, 2004, f. 11.
[53] Vep. e cit., f. 56-57

pakicave, ndërsa shtetet angazhohen për mbrojtjen e gjuhës së tyre. Këtu bie Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kroacia e Serbia;

3) Shtete me autonomi gjuhësore – janë shtete ku kemi organizim shtetëror me rajone autonome, si Spanja, ku shteti i njeh si zyrtare të gjitha gjuhët e atyre rajoneve autonome;

4) Shtete me federalizëm gjuhësor – si Belgjika dhe Zvicra, ku tërësitë gjeografike, pa marrë parasysh a janë kantone ose njësi të tjera, kanë gjuhë të tyre zyrtare dhe shteti i njeh ato si të tilla;

5) Shtete me shumëgjuhësi të institucionalizuar – si Luksemburgu, Irlanda, por edhe Finlanda. Në këto shtete pranohen dy e më shumë gjuhë si të barabarta në gjithë territorin e vendit. Në rajonin tonë e tillë është Kosova.

Siç shihet në këtë kategorizim, Maqedonia bie në grupin e ***shteteve njëgjuhëshe që kujdesen për gjuhën e pakicave***. Në fakt, Maqedonia këtë gjendje e ka trashëguar nga ish Jugosllavia, ku zyrtare ishte serborkoatishja, sllovenishtja dhe maqedonishtja.[54] Kështu, edhe pse shqiptarët në Jugosllavi ishin sa sllovenët (8%) dhe më shumë se maqedonasit (6%),[55] në mungesë të një njësie të barabartë federale (republikë), ata nuk e gëzuan të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës. E, derisa Jugosllavia kishte federalizëm gjuhësor dhe kujdes ndaj gjuhës së pakicave (shqipes, hungarishtes, turqishtes, vllahishtes etj.), shtetet që dolën prej saj ndoqën modele të shteteve njëgjuhëshe, gjithnjë duke e ruajtur karakterin njëetnik të shteteve.

Megjithatë, që nga pavarësimi i Maqedonisë më 1991, shqiptarët nuk kanë reshtur duke kërkuar përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, ashtu që thuaja në secilën qeverisje është kërkuar avancimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, që ka përfunduar me avancimin e fundit të përdorimit të gjuhës shqipe, që është bërë më 11 janar 2018, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ndonëse ky ligj nuk e ka barazuar gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase, pra nuk e ka ndryshuar modelin e planifikimit gjuhësor, përsëri llogaritet si avancimi më i madh i gjuhës shqipe në përdorimin zyrtar në këtë shtet. Në të vërtetë, ky ligj ka bërë vetëm emërtimin në kllapa "gjuha shqipe" (ndërsa në tekst akoma mbetet "gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve") dhe e ka zgjeruar përdorimin e saj zyrtar në

[54] Shih: Milorad Radovanović, Planiranje jezika *i drugi spisi*, Izdavačka knjižarnica Zoran Stojanovića Sremski Karlovci, Novi Sad, 2004, f. 44.
[55] Snježana Kordić, *Jezik i nacionalizam,* Durieux, Zagreb, 2010, f. 288.

organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në komunikim ndërkombëtar, në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucione për mbrojtjen e gjuhës). Edhe në këtë ligj mbetet formulimi "pranë gjuhës maqedonase", që nënkupton se statusi i maqedonishtes ka mbetur "kodi i vetëm i komunikimit të shtetit", sipas asaj që është projektuar në themelimin e Maqedonisë si njësi federale e Jugosllavisë më 1944 (një komb-një gjuhë-një shtet) dhe që vazhdon, ndërsa shqipja mbetet gjuhë e përkthyer.

Problemet e zbatimit të ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe

Pas miratimit të ligjit të lartpërmendur, tash është hapur mundësia që gati në të gjitha institucionet shtetërore të përdoret edhe gjuha shqipe. Ndonëse në aspektin politik kjo shihet si një arritje, nga aspekti gjuhësor vetëm tash shfaqen probleme serioze, që mund të lënë pasoja të pariparueshme në përdorimin e gjuhës shqipe.

Kështu problemi i parë u shfaq me emrin e shtetit. Derisa zhvilloheshin bisedime për emrin e ri, një nga emrat e mundshëm doli të jetë "Republika Ilindenska Makedonija", që nga njerëz të politikës u përkthye si "Republika Ilinditase e Maqedonisë"[56] në vend të "Republika e Maqedonisë së Ilindenit". Me supozimin se ky emërtim mund të pranohej dhe të botohej në gazetën zyrtare, ky do të ishte skandal për natyrën e gjuhës shqipe. Megjithatë, për arsye politike ky emër i shtetit nuk kaloi dhe pastaj u ra dakord për emrin "Republika Severna Makedonija"[57]. Edhe në këtë rast doli problem jo vetëm në përkthimin e përcaktorit "severna" si "e Veriut" apo "Veriore", por edhe për vendin e përdorimit. Maqedonasit, por edhe ndërkombëtarët, insistonin që ky përcaktor të qëndronte para emrit "Maqedonia", që binte ndesh me natyrën e shqipes, sepse do të dilte se ky përcaktor i referohet emrit "Republika" e jo emrit "Maqedonia". Sidoqoftë, pas ndërhyrjeve edhe të gjuhëtarëve, kjo çështje u zgjidh dhe tashmë zyrtarisht njihet si "Republika e Maqedonisë së Veriut", ndonëse në komunikim të përditshëm haset edhe si "Republika e Maqedonisë Veriore".

[56] https://www.alsat-m.tv/republika-ilindenase-e-maqedonise-e-pranueshme-per-te-dyja-qeverite/ (marrë më 29.09.2019)
[57] https://www.alsat-m.tv/emri-zaev-konference-per-shtyp-ne-oren-1830/ (marrë më 29.09.2019)

E sollëm këtë shembull vetëm si ilustrim se sa pak pakujdesi duhet, që të ndodhin probleme me pasoja të pariparueshme. Sepse botimi i emrit të shtetit në fletoren zyrtare nënkupton sanksionim përfundimtar dhe vetëm një vendim tjetër mund ta shfuqizojë atë vendim dhe të sjellë vendim tjetër.

Pasi që ka përfunduar çështja e emrit të shtetit dhe pasi që ka filluar zbatimi i ligjit të ri të gjuhëve, do të duhet që edhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore të bëhen edhe në shqip, emrat e tillë të regjistrohen në Regjistrin Qendror dhe të vendosen nëpër vulat e institucioneve, si dhe në hyrje nëpër pllakat përkatëse informuese. Dhe, kur kësaj ia shtojmë faktin se bëhet fjalë për qindra institucione të tilla, detyrimisht rritet droja se do të ndodhin gabime. Fjala bie, "Prirodno-nauçen muzej" ishte përkthyer si "Muzeu Natyror-Shkencor" në vend të emërtimit të përdorur në Shqipëri "Muzeu i Shkencave të Natyrës", ndërsa sipas këtij shembulli janë plot institucione që rishtazi duhet gjetur përkthimin adekuat ose emërtimin përkatës siç përdoret në Tiranë. (Po i referohemi Tiranës, sepse konsiderojmë se Prishtina nuk është shembull i mirë në këtë drejtim, qoftë për shkak të përshtatjes nga serbishtja të këtyre emërtimeve ose edhe për shkak të përshtatjes nga anglishtja.) Sa për ilustrim, po i përmendim këtu edhe disa institucione bashkë me dilemat e emërtimit: Drejtoria ***e*** Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore apo Drejtoria ***për*** Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore?; Drejtoria e ***të Ardhurave*** Publike apo Drejtoria e ***të Hyrave*** Publike?; Trupi i Revizionit (apo për Revizion) të Instrumentit për Ndihmën e Paraanëtarësimit? (është bërë përshtatje nga maqedonishtja, por nuk dimë a ka institucion të tillë në Tiranë); Komisioni i Shkallës së Dytë për Ankesa dhe Vërejtje (A ka emërtim të tillë në Tiranë dhe Prishtinë? (është bërë përshtatje nga maqedonishtja, por nuk dimë a ka institucion të tillë në Tiranë). Pastaj i kemi dilemat a duhet *auditim* apo *revizion*, a duhet *paraanëtarasim* apo *paraaderim*, a duhet *gazeta zyrtare* (siç e ka Prishtina) apo *fletorja zyrtare* (siç e ka Tirana). Këto janë vetëm shembuj ilustrues të dilemave që janë krijuar pas detyrimit që shqipja të përdoret në komunikim publik zyrtar në Maqedoninë e Veriut. Këtu po shtojmë se të gjitha institucionet janë të detyruara që sa më shpejt ta zbatojnë gjuhën shqipe, ashtu që – për shkak të këtij detyrimi – së shpejti do t'i kemi të gjitha edhe në gjuhën shqipe, por mbetet droja se duke shpejtuar, do të krijohen edhe shumë gabime. Ndërkaq, pasi të sanksionohen, edhe sikur të gjenden emërtimet e sakta, është detyrë jo shumë e lehtë ndryshimi tyre. Kjo flet për urgjencën që paraqitet në lidhje me këtë temë.

Me ligjin e ri për përdorimin e gjuhëve është mundësuar edhe themelimi i Agjencisë për Zbatimin ***e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve*** në Republikën e Maqedonisë së Veriut (vijon paradoksi që mos të emërtohet "Agjencia për Zbatimin ***e Gjuhës Shqipe*** në Republikën e Maqedonisë së Veriut) dhe Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve. Detyra e Agjencisë (që tashmë është themeluar) është të ndihmojë në zyrtarizmin e shqipes në Maqedoni, Inspektorati (që ende nuk është themeluar) do të ketë për detyrë ta mbikëqyrë përdorimin dhe përdorimin e drejtë të shqipes në Maqedoni, ndërsa nga këto institucione do të duhet të krijohet edhe një Këshill për Gjuhën Shqipe (ende nuk është themeluar), që do të japë licenca për redaktorë gjuhësorë/lektorë, që do ta kenë për detyrim ligjor ta lejojnë një tekst për përdorim publik, kjo sipas shembullit të redaktorëve gjuhësorë/lektorëve të maqedonishtes.

Megjithatë, përkundër vullnetit dhe dëshirës së mirë, Agjencia nuk është institucion i mjaftueshëm që të japë zgjidhje për krejt nevojat që paraqiten për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Janë dhjetëra institucione me terminologji shumë specifike, si të bujqësisë, blegtorisë, bujqësisë, industrisë, informatikës, financave etj., që nuk ka mundësi të përkthehet e të përshtaten vetëm nga disa të punësuar në një institucion shtetëror. Kjo, madje, nuk është çështje që mund zgjidhet as nga katedrat e institutet e albanologjisë në vendin tonë, sepse edhe ato përbëhen nga gjuhëtarë që kanë studiuar gjuhën standarde shqipe ose të folmet shqipe, por që nuk mund të jenë njohës absolutë të gjithë terminologjisë.

Problem tjetër do të ketë pastaj Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve, jo vetëm për arsye politike, sepse do të duhet t'i detyrojë institucionet ta përdorin gjuhën shqipe, por ai do ta ketë për detyrë edhe të krijojë standard se çfarë është e drejtë në përdorimin zyrtar e publik të shqipes e çfarë është e gabuar, që të mund të vendosë edhe për gjoba e vërejtje. Ky inspektorat do të duhet të merret me çështje që nga shkrimi i drejtë i emrave personalë dhe toponimeve nëpër dokumente që i lëshon shteti, shkrimi i drejtë i emrave të institucioneve, përdorimi i drejtë i shqipes nëpër të gjitha dokumentet zyrtare, e deri te përkthimi i materialeve nëpër institucione përkatëse, si edhe në fletoren zyrtare të shtetit.

Problem tjetër do të jetë edhe se si të do standardizohet dhënia e licencave për redaktorë gjuhësorë me autorizim zyrtar për përdorimin e gjuhës shqipe. Shtrohet dilema: a do të testohet njohja e rregullave

gramatikore të shqipes apo do të testohet edhe njohja e terminologjisë?; a ka një model apo standard të këtyre testeve në Tiranë? etj.

Krejt këto janë probleme që kërkojmë zgjidhje të menjëhershme. Prandaj sot shtrohet nevoja për bashkëpunim të thelluar të institucioneve të Maqedonisë së Veriut me ato të Shqipërisë, për ta ndihmuar sanksionimin zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoni. Ky nuk është vetëm detyrim shkencor e profesional, por edhe detyrim kombëtar, nëse duam që gjuha shqipe të jetë e njëjtë në të dyja anët e kufirit, aq më shumë që për shqiptarët shqipja është indi lidhor i identitetit të tyre kombëtar.

Konkluzione dhe propozime

Pasi që kemi shtruar një varg problemesh të përdorimit të shqipes zyrtare në Maqedoninë Veriut, do të përpiqemi të japim edhe disa propozim-zgjidhje për këtë problematikë.

Kështu, para së gjithash, pritet që Republika e Shqipërisë të jetë e hapur me krejt mundësitë profesionale që të ndihmojë në koordinimin e institucioneve për përdorimin e drejtë të terminologjisë në cilindo institucion të Maqedonisë së veriut. Këtu nënkuptojmë edhe trajnimet e përkthyesve dhe redaktorëve gjuhësorë në Tiranë ose edhe dërgimin e ekspertëve të fushave të ndryshme këndej, që s'do mend se mund të jenë ndihmesë e madhe në këtë fazë fillestare të punës së përdorimit zyrtar të shqipes në Maqedoninë e Veriut. Ky është dimensioni i vullnetit të mirë dhe gatishmërisë për ndihmë për arsye kombëtare, siç kishte ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore me grupet e arsimtarëve shqiptarë të ardhur nëpër shkollat shqipe këndej kufirit.

Përveç kësaj, gjykojmë se ka ardhur koha që sa më shpejt të përditësohen, plotësohen dhe ribotohen fjalorët ekzistues terminologjikë, si dhe të hartohen fjalorë të rinj për fusha të reja të veprimtarive dhe ata të bëhen në disa gjuhë (duke përfshirë edhe serbishten e maqedonishten, kjo për nevoja të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut). Kjo është detyrë e akademive të shkencave dhe instituteve shkencore të Shqipërisë dhe Kosovë, për çka mund të ndihmojnë edhe shqiptarët e Maqedonisë së Veriut me institucionet e tyre shkencore e arsimore.

Megjithatë, deri në plotësimin e këtyre fjalorëve, është bërë interes nacional shqiptar krijimi i një Korpusi Elektronik të Shqipes (KESH), në të cilin do të futeshin të gjithë fjalorët aktualë shpjegues,

terminologjikë dhe fjalorët dy a më shumë gjuhësh, që janë botuar kurdoherë, si dhe fjalorët e sinonimeve, fjalorët drejtshkrimorë, drejtshkrimi i gjuhës shqipe etj., që të mund të përdoret nga të gjithë shqiptarët kudo që janë. Kur ky fond i madh gjuhësor i shqipes të mund të përdoret në platforma elektronike dhe të mund të bëhet pjesë e softuerëve aktualë kompjuterikë, ai do të ishte një lehtësim i madh dhe një ndihmë e rëndësishme që përkthyesit shqiptarë, nga çfarëdo gjuhe, të mund të kenë qasje në të dhe në përdorimin e drejtë të shqipes. Për shkak se shumica e tyre janë botime private, do të duhet që shteti shqiptar (por, edhe Kosova dhe Maqedonia e Veriut) ta shpallin këtë si interes me prioritet të lartë nacional dhe të ndajnë fonde për ta krijuar dhe për ta përditësuar atë.

Nëse për disa vite krijohet KESH-i dhe hidhet edhe në platformën *google translate*, kjo nënkupton edhe përkthime më të shpejta, edhe më sakta edhe më unike. Në atë mënyrë edhe korrigjimi i gabimeve dhe lëshimeve të bëra, pas përditësimit, do të rregullohej në mënyrë automatike. Meqë këtë e mundëson teknologjia, ne besojmë se kjo është mënyra më e lehtë dhe më e qëlluar që të zgjidhet edhe problemi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, që sot shtrohet si nevojë emergjente, por edhe, në përgjithësi, kështu do të mundësohej avancimi i përdorimit të gjuhës nga të gjithë përdoruesit që mund ta shkruajnë shqipen nga cilido cep i botës dhe të kenë rezultate të njëjta.

Literatura e shfrytëzuar:

Bugarski Ranko, Jezik i kultura, XX vek, Beograd, 2005

Kordić Snježana, *Jezik i nacionalizam,* Durieux, Zagreb, 2010

Radovanović Milorad, *Planiranje jezika i drugi spisi*, Izdavačka knjižarnica Zoran Stojanovića Sremski Karlovci, Novi Sad, 2004

Siguan Miquel, *Jezici u Europi,* Školska knjiga, Zageb, 2004

Законот за употреба на јазиците, „Службен весник на Р. Македонија“, 14 јануари, 2019.

https://www.alsat-m.tv/republika-ilindenase-e-maqedonise-e-pranueshme-per-te-dyja-qeverite/ (marrë më 29.09.2019)

https://www.alsat-m.tv/emri-zaev-konference-per-shtyp-ne-oren-1830/

(marrë më 29.09.2019)
https://perceptor.mk/shto-e-novo-vo-noviot-predlog-zakon-za-jazicite/
(marrë më 29.09.2019)

Berton SULEJMANI[58]

GJUHA E MBISHKRIMEVE PRIVATE E PUBLIKE SOT

Përpjekje për të vënë sadopak rend në gjithë këtë kaos gjuhësor që ka ndodhur te ne, sidomos nga viti 1991 e deri më sot, kryesisht kanë qenë individuale e kolektive (katedrat e gjuhës shqipe Shkup e Tetovë). Andaj, nevoja e hartimit të një politike gjuhësore zyrtare në Maqedoninë e Veriut siç ndodhi me themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve, e cila tashmë është në një fazë të re, pra në fillimet e punës së saj, është për t'u përshëndetur, sepse puna e angazhimi i gjuhëtarëve dhe dashamirëve të gjuhës nuk mund t'i tejkalojë të gjitha këto probleme gjuhësore, por domosdo duhej të krijohej një institucionin që do të merrej me këto çështje. Themelimi i agjencisë është një ogur i bardhë dhe të njëjtës i dëshirojmë punë të mbarë!

Mjafton të udhëtoni nëpër lagjet e kryeqytetit, veçanërisht në vendbanimet shqiptare, qoftë me mjetet e transportit publik, qoftë me ato private gjithçka do ta keni të qartë, sepse tek një numër i madh institucionesh publike, por edhe dyqane private, mbishkrimet janë të shkruara vetëm në gjuhën maqedonase. Mohimi i shqipes vërehet edhe në institucionet bankare të Shkupit, në disa shkolla të mesme, me fjalë të tjera ato janë të shkruara vetëm me alfabet cirilik. Të tilla (një pjesë e madhe e tyre) janë edhe mbishkrimet që lidhen me administratën e qytetit të Shkupit, tabelat rrugore, tabelat e projektit "Shkupi 2014" (shih fotografinë me nr. 5) dhe shumë objekte të tjera. Edhe aty ku është e përdorur gjuha shqipe, në të shumtën e rasteve, vërehen gabime drejtshkrimore dhe gabime gjatë përkthimit, si: (fotografitë e mëposhtme janë bërë në komunën e Çairit).






[58] Prof. dr. Berton Sulejmani, mësimdhënës në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Universitetin "Fadil Sulejmani" Tetovë.

1



2



3

4



5

Fotografia e mësipërme (nr. 5) na le të kuptojmë se këto gabime gjuhësore ose janë të qëllimshme, ose janë përkthyer nga ndonjë joshqiptar. Them të qëllimshme sepse me këta pseudopërkthyes (që asnjëherë nuk dhanë përgjegjësi para ndonjë organi) duan të na defokusojnë me problemet reale të këtij shteti. Veç shembullit të mësipërm që për mbishkrimin e teatrit dhe operës, *maq*. *Македонска Опера и Балет* në shqip e gjejmë **Maqedonisht Operës dhe Baletit* (një përkthim të tillë, edhe pa shkollimin e duhur, një shqiptar asnjëherë nuk do të mund ta bënte e që do të duhej të ishte ***Teatri i Operës dhe i Baletit***). Shembuj të tillë hasim shumë, jo vetëm nëpër mbishkrimet e institucioneve të ndryshme, por edhe shkrimet e produkteve ushqimore (po e përmend atë "të famshmen" *ajvar/hajvar i zemëruar* për maq. *лут ајвар* në vend të *ajvar/hajvar djegës.*

MARKETI "KAM" DHE GJUHA SHQIPE. KAM-i është zinxhiri i vetëm i dyqaneve për shitje të produkteve bazë për përdorim të përditshëm në Maqedoni, që punon në principin e njëjtë si diskontet më të mëdha dhe të njohura në botë, si: "Aldi", "Lidel", "Plus", "Neto" etj. Dyqanet e kësaj ndërmarrjeje janë shtrirë edhe në komunat shqiptare dhe në komunat

ku shqiptarët përbëjnë minimum 30 % të popullsisë. Por gjuha shqipe në mbishkrimet e kësaj firme nuk përdoret. Edhe pse nuk mund të arsyetohet që mbishkrimet janë vendosur shumë më herët e ndonjë arsye tjetër. Në vazhdim po jua japim një të dhënë se edhe sot, pra në shtator të vitit 2019 në komunën e Çairit (objekti te stadiumi i KF "SHKUPI") të gjitha mbishkrimet janë vetëm në maqedonisht. Ja edhe disa fotografitë:





Radishan e jo Radishanë. Ajo që bie në sy kohëve të fundit në qytetin tonë (në Shkup), është edhe përdorimi i gjuhës shqipe në autobusët e Ndërmarrjes së Transportit Publik të Qytetit të Shkupit, por edhe këtu nuk mungojnë gabimet gjuhësore. Këtë që po e them po e ilustroj vetëm me toponimin e një lagjeje të komunës së Butelit, asaj të Radishanit. Në mbishkrimin e autobusit me numër **57** e gjejmë ***Radishanë***, pra me **-ë** në fund. Ky toponim duhet të shkruhet pa **-ë**, pra **Radishan,~i**, si: *Po shkoj te një shok imi në **Radishan**. **Radishani** qenka lagje e qetë.* Te faqja zyrtare e kësaj ndërmarrjeje, nuk e di se për ç'arsye, kemi një përdorim të pjesshëm të gjuhës shqipe (shih fotografinë e mëposhtme me numër 6). Nga ana tjetër, autobusët e ndërmarrjeve private të qytetit të Shkupit aspak s'e përdorin gjuhën shqipe sikur ata nuk e kanë obligim, (shih fotografinë me numër 7).





6

Mbishkrimet i disa shkollave të qytetit të Shkupit dhe shkrimi cirilik. Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i këtij shtetit 1991 (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, në vazhdim: IRJM) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka një ngritje, por jo plotësisht e barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo zyrtare. Siç dihet, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ky shtet filloi të quhet Republika e Maqedonisë së Veriut (maq. Република Северна Македонија). Për çdo eventualitet, në vazhdim po e japim nenin 1 dhe nenin2 të ligjit në fjalë:

Neni 1

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

(1) Qytetarët kanë të drejtë ta përdorin cilëndo nga gjuhët e theksuara zyrtare dhe alfabetet e tyre nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera e kanë për obligim që t'u mundësojnë qytetarëve shfrytëzim, përdorim dhe zbatim të atyre gjuhëve zyrtare dhe alfabeteve të tyre në cilëndo qoftë procedurë, si edhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe në atë alfabet.


(2) Në pajtim me të drejtën e qytetarëve që ta përdorin cilëndo nga gjuhët e cekura zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe procedurat tjera të parapara me ligje tjera. Gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet tjera, trupat dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e cilësdo prej gjuhëve zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në ato procedura dhe procedura tjera.

(3) Në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat tjera.

Pra, krahas gjuhës zyrtare të shtetit (maqedonishtes), mund të përdoret edhe gjuha e 20 % e qytetarëve (për shqiptarët gjuha shqipe),

por jo vetëm gjuha shqipe siç do ta përdornin vetëm serbishten serbët në Kosovë. Për të qenë gjuhë zyrtare dhe plotësisht e barabartë me maqedonishten, paragrafi 1 i nenit 1 do të duhej të ishte: *Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase (alfabeti i saj cirilik) dhe gjuha shqipe (alfabeti i saj latin).*

Nga kjo del që qyteti i Shkupit gjuhë zyrtare i ka dy: shqipen dhe maqedonishten. Krahas kësaj, me alfabet cirilik janë edhe shumë shkolla të mesme, ku ka edhe paralele në gjuhën shqipe[59], si p. sh.: С.У.Г.С. „Владо Тасевски“ – Скопје; Д.С.У. „Георги Димитров“; СУГС Гимназија „Орце Николов“ – Скопје; Државно средно хемиско-технолошко училиште „Марија Кири – Склодовска“; Гимназија „Јосип Броз Тито“ (Në shkollat e mesme ku drejtorët janë shqiptarë, shkruhen në dy gjuhë). Fotografitë e mëposhtme janë të atyre shkollave të mesme të Shkupit në të cilat nuk respektohet dygjuhësia e garantuar me ligj.



[59] Edhe pse është zyrtare edhe përdorimi i gjuhës shqipe në territorin e Qytetit të Shkupit, prapëseprapë, edhe sot e gjithë ditën shumë mbishkrime i kemi vetëm në maqedonisht. Aty ku ndihmësdrejtorët janë shqiptarë, bëjnë përpjekje dhe i ndërrojnë. Pra, me fjalë të tjera, nuk merren institucionet, por mbetet përpjekje individuale.

Mospërdorimi i –ë-së. Në faqet zyrtare të ndërmarrjeve të ndryshme të qytetit të Shkupit, madje, për fat të keq edhe në ditarët elektronik kemi vërejtur mospërdorimin e shkronjës **-ë** dhe përdorimin e **e**-së në vend të saj. Në një faqe të ditarit, nga 32 orë mësimore, vetëm 2 nga to kemi vërejtur se është përdorur ë-ja. Për fat të keq edhe në orët e lëndës *Gjuhë dhe letërsi shqipe* mungon. Fjala është për ditarët elektronik. Për dikë, kjo gjë ndoshta nuk çon peshë dhe shpesh i dëgjojmë arsyetimet se nuk e kemi në tastierë shkronjën në fjalë. Por, si është e mundur që për lëndën *Gjuhë gjermane* t'i gjejnë shkronjat –ä e -ö, p.sh.: *Präpositionen* etj., e për shqipen jo. Të nderuar mësimdhënës (sidomos ju të lëndëve të tjera), gjuha shqipe nuk është pronë vetëm e mësuesve të gjuhës shqipe, por e të gjithëve, pra edhe juaja.

Përfundim dhe propozim

Nga gjithë kjo pasqyrë e mësipërme, detyrimisht lind pyetja: Çfarë duhet të bëjmë që të dalim nga kjo situatë? Mendojmë:

1. Për t'u evituar gabimet e mbishkrimeve të ndryshme brenda dhe jashtë qytetit të Shkupit do të ishte mirë që para se ta publikojnë ndonjë mbishkrim të konsultojnë katedrat e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (Shkup e Tetovë) dhe, detyrimisht, Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës.

Ndërsa për ta përmirësuar gjendjen në shkollat tona do të ishte mirë që:

1. Të organizohen kurse të kulturës gjuhësore me mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore, posaçërisht me mësimdhënësit që studimet i kanë mbaruar në gjuhën maqedonase (e ndonjë tjetër);

2. Do të ishte shumë mirë që të punësuarit në shkolla, duke përfshirë edhe punonjësit e administratës të furnizohen me fjalorë drejtshkrimorë, shpjegues, terminologjik etj. Fundja, pse të mos hartohet një fjalor i shkurtër drejtshkrimor për nevojat e shkollave tona. Në të do të përfshiheshin rregullat e shkrimit të termave, lëndëve, emërtimeve të ndryshme, mbishkrimet e tabelave të shkollave etj.

3. Gjuhëtarët jo vetëm që duhet rregullisht të takohen dhe të bashkëpunojnë me arsimtarët e lëndëve të ndryshme, te të cilët, siç edhe pamë, shpesh hasen thyerje të normës gjuhësore, por edhe në shtyp e televizione të trajtojnë dhe të shpjegojnë probleme të kulturës gjuhësore nga ana e tyre;

4. Mësimdhënësit e lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi duhet të jenë shembull i mirë për të tjerët. Mospërdorimi i shkronjës /ë/ dhe thyerjet e normës

gjuhësore nga ta janë gabime që peshojnë shumë rëndë. Arsyetime të tipit, nuk mund të gjej shkronjë /ë/ e /ç/ në tastiere, kujtoj se janë të një niveli të ulët.

Literatura e shfrytëzuar:

IBRAHIMI, Mustafa & SULEJMANI, Berton (2016), **"*Gjuha e firmave dhe mbishkrimet publike në qytetin e Shkupit*",** Shkup.

KRASNIQI, Haxhi (1983). *T'i shkruajmë drejt firmat nëpër institucionet e sektorit shoqëror dhe në shitoret private.* Në "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2003). *Sociolinguistikë.* Tiranë.

Mustafa IBRAHIMI[60]

PËRKTHIMI I DISA FRAZEMAVE MIDIS GJUHËS SHQIPE DHE MAQEDONASE

Hyrje

Procesi i përkthimit është një transferim që nuk ndodh vetëm ndërmjet dy gjuhëve, por ndërmjet dy kulturave, duke qenë se si gjuha burimore, ashtu edhe gjuha e synuar, janë të rrënjosura në situata komunikative në kulturat e tyre respektive. Nocioni i kulturës është thelbësor në shqyrtimin e ndërlikimeve gjatë procesit të përkthimit dhe pavarësisht se ekzistojnë debate mbi faktin nëse gjuha është pjesë e kulturës, dy nocionet e kulturës dhe gjuhës janë të pandashme. Kultura dhe kompetenca kulturore janë fenomene shumë komplekse që mund të ngrenë mjaft gracka për përkthyesin. Fjalët apo shprehjet e rrënjosura në një kulturë të caktuar, përbëjnë vështirësitë më të mëdha që mund të hasin përkthyesit, pasi shpeshherë është gati e pamundur për t'u përkthyer dhe ka pasur debate të vazhdueshme rreth teknikave, humbjeve apo kompensimeve në përkthimin e termave kulturorë. Dallimet midis kulturave mund të shkaktojnë vështirësi shumë më të mëdha në përkthim sesa ndryshimet në strukturën e gjuhës, sepse njerëzit në kokën e tyre, varësisht nga kultura që i takojnë kanë koncepte të ndryshme për botën që i rrethon. Mendimet krijohen në bazë të përvojës së tyre shoqërore, përkthimi i gjuhës burimore në formën më të përshtatshme, është pjesë e rolit të përkthyesit në komunikimin ndërkulturor. Sa më i ndërgjegjshëm të jetë përkthyesi për kompleksitetin e ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet kulturave, aq më i mirë do të jetë në ushtrimin e profesionit të tij. Për të përmbledhur atë çka kemi thënë më lart, përkthyesi duhet të jetë si bilingual, ashtu edhe bikultural, për të mos thënë multikultural.

Pjesa kryesore

Në rrethana të këtilla sociolinguistike janë gjetur edhe gjuhët e Ballkanit, kryesisht nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta, duke pranuar e dhënë me njëra tjetrën. Këto paralele frazeologjike paraqiten

[60] Prof. dr. Mustafa Ibrahimi, mësimdhënës në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Sociale.

në të gjitha shtresat leksikore, si nga jeta materiale, ashtu edhe nga ajo shpirtërore. Praninë e kaq shumë paraleleve frazeologjike midis gjuhëve të Ballkanit, sidomos ato shqipe dhe gjuhët sllave e ka mundësuar kontakti i drejtpërdrejtë dhe bashkëjetesa e gjatë shumëshekullore midis atyre popujve. Duke ditur se popujt e Ballkanit të vendosur në një hapësirë të përbashkët jo vetëm që kanë pasur kontakte midis kulturave të tyre, por kulturat e tyre janë zhvilluar sipas traditave të njëjta ballkanike dhe përvojave të hidhura historike. Krejt kjo ka mundësuar që popujt e Ballkanit të kenë vlera të njëjta sociale, morale dhe politike, vlera që kanë gjetur ngjashmëri në gjuhë, sidomos në njësitë frazeologjike.

Frazeologjia e çdo gjuhe është shumë e pasur dhe e larmishme. Ajo ka mjete e vlera të pazëvendësueshme, me forcë të veçantë e me shpejtësi të lartë. Si e tillë ajo përbën një nga pasuritë më të mëdha të çdo gjuhe dhe populli që është krijuar prej kohësh e është ruajtur gojë më gojë ose që buron dita -ditës nga gurra e pashtershme e krijimtarisë së popullit.

Njohja e njësive frazeologjike ndihmojnë që gjatë përkthimit t'i përdorim drejt në të folur e në të shkruar. Veçanërisht gjuha e folur, krijimtaria gojore popullore, gjuha e letërsisë artistike, e shkrimeve politiko-shoqërore etj. janë të pasura me shprehje të tilla të bukura.

Gjatë përkthimit mund të gjejmë njësi frazeologjike (NF) që janë specifike për një kulturë të caktuar, NF që përdoren në mënyrë paralele në këto gjuhë dhe NF të përkthyera nga idiomat ndërkombëtare.

1 – Përkthimi i NF në mënyrë të pavarur me shprehje nga kultura e atij populli

Gjatë përkthimit duhet të kemi parasysh një shkallë të caktuar të ngjashmërive për mënyrën se si njerëzit e mendojnë botën. Nëse njerëzit nuk kanë koncepte të njëjta për botën ku jetojnë, shumë vështirë do të ishin kuptuar midis veti, ose do ishte shumë rëndë për përkthim nga një gjuhë në tjetrin. Duke i shqyrtuar njësitë frazeologjike të tri popujve, takuam disa shprehje ku përkthimi bëhet në mënyrë të pavarur me shprehje nga kultura e atij populli. Kjo do të thotë se e njëjta shprehje thuhet me anë të mjeteve të ndryshme ndihmëse, duke marrë parasysh shprehje të ndryshme me veçori karakteristike të njërit apo popullit tjetër. Të tillë janë:

Shqip	maqedonisht
Si shala e gomarit	*На магаре седло/ Митра паларија*
E ka halë në sy	*Го има како глотка в очи*
i drejtë si drapri	*Прав како геврек*

Tek një numër i madh të njësive frazeologjike që janë specifike për një gjuhë të caktuar, gjatë përkthimit duhet t'i përdorim shprehjet analoge, fjalët kyçe ose kontekstin, si p.sh.

Shqip	Maqedonisht
Dasmë pa aheng	*Свадба без сватови*
as mish as peshk	*Ни пари ни стари*

Shumica e NF të metaforizuara në shqipe gjejnë paralele pikërisht te tipi "e bëri", si:

Shqip	Maqedonisht
U bë kockë e lëkurë	*Стана коска и кожа*
E bëri nuse	*Го направи будала*

NF të metaforizuara në shqipe që gjejnë paralele te tipi "e ka", si:

Shqip	*Maqedonisht*
E ka zemrën hambar	*Има широко срце*
E ka zemrën katran	*Има лоша душа*
E ka zemrën barut	*Има огнено срце*
e ka zemrën pasqyrë	*Има кристално срце*
e ka kokën shkëmb	*Има тврда глава*

Midis shqipes dhe maqedonishtes takuam disa shprehje ku përkthimi bëhet në mënyrë të pavarur me shprehje nga kulturat e tyre, si p.sh.

Shqip	*Maqedonisht*
Opingat e Sheros	*Кога врбата ќе роди грозје*
Tersi i Pojanit	*Терс нога*
Avazi i Mukës	*На една свирка свири*
Leshte e Currit	*Шикли и шипинки*
Koha e Babaqemo	*Од времето на дедо ное*
Puthu me Milon	*На куково лето*
E hëngri si Xhaferi simitin	*Го помина жеден преку вода*
Zu ferra Brahim	*Му падна секирата во медот*
S'ia ha qeni shkopin	*Ни врагот не му ја врве*

2 – Përkthimi i NF në mënyrë paralele dhe analogjike

Paralelet leksikore dhe frazeologjike, jo vetëm midis shqipes dhe maqedonishtes, por edhe me gjuhët e tjera të Ballkanit janë bërë përmes një baze mjaft të gjerë dhe nëpër shumë shekuj. Zhvillimi i këtillë, para së gjithash i detyrohet një sërë faktorësh ekstralinguistik, në mesin e të cilëve si më të rëndësishëm janë: raportet dhe kushtet kulturo-historike dhe shoqërore në të cilat janë zhvilluar këto gjuhë. Si më kryesore paraqitet simbioza dhe interferenca shumëvjeçare gjuhësore, e cila është manifestuar në të gjitha nivelet gjuhësore, e veçanërisht në nivelin leksikor e frazeologjik.

2.1. Përkthimi i një togfjalëshi të lirë frazeologjik

Kjo formë shërben për krijimin e njësive frazeologjike duke rritur fondin e përbashkët të frazeologjizmave të këtyre gjuhëve. Në këto lloje të togfjalëshave frazeologjikë mund të vërehet se foljet komponentë janë nga grupi i foljeve më të zakonshme dhe me strukturë të gjerë semantike. P.sh.

Shqip	Maqedonisht
Hap gojën	*Отвора уста*
Fus hundën	*Пика нос*
Ka gisht	*Има прст*
Hap sytë	*Отвора очи*
merr pjesë	*Зема учество*
Ngre krye	*Крева глава*

2.2. Përkthime të NF që kanë analogji tipologjike

a) Analogjia tipologjike mbetet me vlerë edhe atëherë, kur ndonjë nga gjymtyrët e frazeologjizmit të shqipes ka si korresponduese të veten një fjalë me kuptim tjetër leksikor. Le të krahasohen shembujt.

b)

Shqip	Maqedonisht
i hedh hi syve	*му фрла пепел во очите*
i lëpij këmbët	*му ги лиже нозете*

c) Me këtë tip të njësive frazeologjike lidhen edhe frazeologjizmat që e ruajnë idenë e krahasimit. Edhe në këtë kategori shqipja dhe maqedonishtja gjejnë analogji midis tyre, p.sh.:

Shqip	Maqedonisht
[Dalin] si kërpudha pas shiut	*(нукнува)како печурки по дождот*
[Del] *si kërriçi para gomarit*	*(излегува) како прлето пред магаре*
si qen i lëshuar nga zinxhiri	*Како одврзано куче*

2.3. Përkthime të NF mbi bazën e hiperbolës

Shqip	Maqedonisht
e ngre në qiell	*го издига на небо*
e bën mizën buall	*од мува слон прави*

2.4. Përkthime të NF me metaforë të brendshme

NF me metaforë të brendshme me strukturën në shqipe *"e ka diçka"*, prirja e përgjithshme në këto tri gjuhë është ideja e krahasimit të shprehet me strukturën *"ka+ mbiemër relativ+ emër"*.

Shqip	Maqedonisht
E ka zemrën zjarr	*Има огнено срце*
E ka zemrën hekur	*Има железно срце*
E ka zemrën akull	*Има ледено срце*

Fushat konceptuale e leksikore të fjalëve që në strukturat frazeologjike shërbejnë si gjymtyrë e krahasimit të metaforës janë më shpesh emërtime bimësh, kafshësh dhe sendesh që kanë një tipar lehtësisht të figurativizueshëm p.sh.

Shqip	Maqedonisht
U bë limon	*/пожолте/ како лимон*
E ka gojën bilbil	*Има глас на славеј*
Si arrë në gojë	*Како кост во грло*

2.5. Përkthime të NF me kuptim të figurshëm

Shqipja me maqedonishten, por edhe me gjuhë të tjera të Ballkanit gjejnë paralele edhe me frazeologjizmat që formohen nga një fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë dhe nga një fjalë me kuptim të figurshëm, p.sh.

Shqip	Maqedonisht
i zë besë / besoj	*му верува*
zjarri e djegtë (digjet)	*оган да го изгоре*
mblidh mendjen	*собери си го умот*
i fus frikën	*му сеам страв*
i ngul sytë	*вперам очи*
E ka zemrën gurë	*Има камено срце*
E ka zemrën flori	*Има златно срце*
Nuk çan kokën	*Не си ја цепи главата*
Prish gjakun	*Со крвта пасипана*

2.6. Përkthimi i paraleleve frazeologjike të tipit emëror, mbiemëror e ndajfoljor

Shqipja gjen paralele edhe për tipat emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore, si:

Shqip	Maqedonisht
S'ka parë ditë të bardhë	*не видел бел ден*
mësallë me dy faqe	*дволична лопата*
me gojë të hapur	*со полна уста*
Budalla nuk ka brira	*Будалиот нема рогови*

2.7. Përkthimi i paraleleve frazeologjike të tipit foljor

Paralele midis shqipes dhe maqedonishtes kemi edhe në të gjitha modelet e tipit foljor të frazeologjizmave. P.sh, Folje + emër:

Shqip	Maqedonisht
më bëhet zemra bukë	*Ми омекна срцето*
Ia bëri mendjen dhallë	*Му го помати мозокот*
iu bë buka drokth	Му остана залакот вгрло

2.8. Përkthime të NF me fjalë semantikisht korelative

Një tip interesant nga struktura në të cilën shqipja gjen analogji në gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat me shkallë të ndryshëm njësimi semantik dhe idiomatizimi, që formohen me anë të përsëritjes së një fjale, ose me bashkimin e dy fjalëve semantikisht korelative (sinonime dhe antonime), p.sh.

Shqip	Maqedonisht
Ditë për ditë	*од ден на ден*
sy në sy	*очи вочи*
krah për krah	*рамо до рамо*
brez pas brezi	*од поколение до поколение*
Diftem tët difte	*Кажи ми да ти кажа,*

Për shumë frazeologjizma të shqipes s'kemi mundur të gjejmë paralele frazeologjike të të njëjtit tip në gjuhë të tjera të Ballkanit, p. sh. *Zë ngojë, shes mend, më shkon fjala, e bën bisht* etj.

3. – Përkthimi analogjik i NF nga idiomat ndërkombëtare

Këto idioma të huazuara nga gjuhët ndërkombëtare, në këto gjuhë ashtu si në gjuhët tjera janë futur në fondin e përbashkët dhe përkthimet janë analogjike, si p.sh.:

Shqip	Maqedonisht
Si thembra e Akilit	*Ахилова пета*
Flaka e Prometeut	*Прометеев оган*
Shpata e Demokleut	*Дамоклов меч*
Kali i Trojes	*Тројанкси коњ*
Lotë krokodili	*Крокодилски солзи*

Një numër përkthimesh të NF vijnë nga burime të njëjta, sidomos nga: përallat, fabulat dhe veprat tjera folklorike dhe artistike nga mbarë bota, si p.sh:

Shqip	Maqedonisht	Kuptimi
Dhelpra dhe rrushtë *Shumë zhurmë për asgjë* *Të rrosh a të mos rrosh*	*Лисицата и грозјето* *Многу врева за ништо* *Да живееш или да не живееш*	(e bëri si dhelpra me rrushtë)

Përfundim

Këto anologji tipologjike të njësive frazeologjike (NF), që dalin në të gjithë gjuhët e Ballkanit, veçanërisht në shqipen, maqedonishten dhe bullgarishten përbëjnë anën e brendshme, thelbësore të bashkësisë ballkanike në lëmin e frazeologjisë dhe këto studime që lidhen me çështjen e përkthimit të tyre kërkojnë edhe më tej një shqyrtim si në gjerësi, ashtu edhe në thellësi.

Sa i përket shkallës së produktivitetit të këtyre tipareve, secila gjuhë ka veçoritë e saj, megjithatë shqipja, siç dihet më tepër ofron me rumanishten, bullgarishten dhe maqedonishten, shumë pak me serbishten dhe turqishten. Kjo afri vërehet në paralelet e shumta që ka ky grup në fushën e leksikut dhe frazeologjisë.

Literatura e shfrytëzuar:

ÇABEJ, Eqrem, *Parallele Ausdrucke und Redensarten in den Balkan-sprachen.* vo "Revue internationale des etudes Balkaniques, Beograd 1956, I.

ÇABEJ, Eqrem. (1976). *Mbi disa izoglose të shqipes me sllavishten.* Studime filologjike, nr.2. Tiranë.

Fjalori i gjuhës së sotme letrare shqipe, Tiranë 1980.

Frazeollogiçen reçnik na bëllgarskija ezik, Sofje 1974-75.

HRISTOVA-BEJLERI, Rusana. (1996). *Njësi frazeologjike që përmbajnë krahasim në shqipe e bullgarishte*. Seminari i XVIII i gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare. Tiranë.

HRISTOVA-BEJLERI, Rusana.(2004). *Shqipja në fjalorin etimologjik të bullgarishtes.* Botuar në: Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 95-vjetorit të lindjes së Prof. Eqrem Çabejit. Gjirokastër, më 23 maj 2003. Tiranë, 2004. f. 361-368.

IBRAHIMI, Mustafa. (2013). Paralele frazeologjike midis të folmeve të shqipes dhe maqedonishtes. Në "AKTET" –Revistë e institutit Alb-Shkenca. Vëll.VI, nr.4, pp. 478-479. Instituti Alb-shkenca, Tiranë/Prishtinë/Shkup, 2013. ISBN 2073-2244.

IBRAHIMI, Mustafa. (2014). *Ndikimet leksikore të shqipes në maqedonishte në të folmet dhe rrethanat e sotme sociolinguistike*. In *Albanologjia - International Journal of Albanology 1-2/2014, pp. 127-131*. USHT, Tetovë, 2014. ISBN 1857-9485.

IBRAHIMI, Sami. (1987). *Disa rrethana sociolinguistike të ndikimit të gjuhës shqipe në gjuhën maqedone.* Në Çështje të studimeve albanologjike. Materiale nga Simpoziumi shkencor I mbajtur në Prishtinë më 20-21 dhjetor 1985. Prishtinë, fq.273-284.

ISMAJLI, Rexhep. (1972). *Disa fjalë shqipe në maqedonishte.* Gjurmime Albanologjike, nr.1. Prishtinë.

J.Thomai, Xh.Lloshi, R.Hristova, K.Qiaziti, A.Melonashi, *Fjalor Frazeologjik Ballkanik.* Tiranë 1999.

LLOSHI Xhevat, THOMAJ Jani, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit.* Studime filologjike

MURATI, Qemal. (1985). *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe.* "Jehona", nr.2. Shkup.

MURATI, Qemal. (1985). *Huazimet shqipe në maqedonishte.* Gjurmime Albanologjike, nr.14-1984. Prishtinë.

MURATI, Qemal. (2011). *Shqipja dhe maqedo-arumanishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre.* Në "Studime albanologjike" nr.4, f. 5-42. Shkup.

NASTEVA-JASHAR, Olivera. (1998).*Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike.* Shkup

NESIMI, Remzi. (1987). *Disa elemente në të folmet e Maqedonishtes perëndimore.* Në Çështje të studimeve albanologjike. Materiale nga

Simpoziumi shkencor I mbajtur në Prishtinë më 20-21 dhjetor 1985. Prishtinë, f .139-150; Gjuha shqipe, nr.2. Prishtinë,1986.

POLOSKA, Agim. (1995). *Studime gjuhësore shqiptare-maqedonase.* Në "Shqyrtime albanologjike", nr.1. Shkup.

POLOSKA, Agim. (2000). *Ndikimet e ndërsjella leksikore të shqipes dhe maqedonishtes në fushën e fjalëformimit.* Në "Jehona", nr.5-6, f. 127-139. Shkup.

THOMAI Jani, Xhevat Lloshi, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit.* në "Studime filologjike, Nr.1.Tiranë 19__.

THOMAI, Jani. (1981). *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe.* Tiranë.

YMERI, Haki. (2005). *Elementet leksikore shqipe në fjalorin e gjuhës maqedonase I,II dhe III.* Në "Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë". Tiranë. (f. 319-326).

МИРТО, Људмила. (2008). *Фразеолошки споредби меѓу албанскиот и македонскиот јазик.* XXXIV Научна Конференција на XL меѓународен семинар за македонски јазик, литература и култура (Охрид, 13. - 30. VIII 2007). Скопје.

ПЕЕВ, Коста. Фразеолошки изрази во македонскиот јазик. Во "Македонски јазик" XVIII, 1968, 201-225.

Речник на македонскиот јазик. Скопје 1961-1966 II.

СТОМАТОСКИ, Т. *Белешки за фразеологијата на нашиот јазик.* "Литературен збор", XII, 6, Скопје 1965.

УСИКОВА, Рина. (2008). *Врски меѓу македонскиот јазик и други балкански јазици.* (7-14). Në XXXIV Научна Конференција на XL меѓународен семинар за македонски јазик, литература и култура (Охрид, 13. - 30. VIII 2007). Скопје.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

811.18'255.4:811.18'26'27
811.18'27(497.7)

SFIDAT e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. - Shkup : Agjencia për zbatimin e gjuhës e RMV-së, 2020. - 106 стр. :
илустр. ; 25

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон главите

ISBN 978-608-66482-3-7

а) Преводи на албански јазик - Примена на стандардниот јазик б) Албански јазик - Употреба - Македонија COBISS.MK-ID 112215818

ISBN 978-608-66482-3-7